| | | |
|---|---|---|
| | Përmbajtja | 2-2 |
| | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | 2-2 |
| **I** | 1.Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit | 2-2 |
| | 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | 2-3 |
| | 3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 3-4 |
| **II** | **HYRJE** | 4-4 |
| | 1.Objektivat dhe qëllimi | 4-5 |
| | 2.Identifikimi i çështjes | 5-5 |
| | 3.Përgjegjësitë e strukturave të Agjencisë Rajonale Fier Vlorë Gjirokastër | 5-5 |
| | 4.Përgjegjësitë e audituesve | 5-6 |
| | 5.Kriteret e vlerësimit | 6-6 |
| | 6.Standardet e Auditimit | 6-6 |
| | 7.Metodat e auditimit | 6-7 |
| | 8. Dokumentimi i auditimit | 7-7 |
| **III** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** | 7-7 |
| 1 | Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim | 7-7 |
| 2 | Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit. | 7-96 |
| Pika 1 | 1.Mbi hartimin dhe Zbatimin e buxhetit të shtetit zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit (PBA) | 7-15 |
| Pika 2 | 2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin , ruajtjen , dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetar edhe mbajtjen e kontabilitetit konkretisht -Pasqyrat financiarë dhe plotësimin i bilancit dhe anekseve përkatëse sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave për kwtë qwllim.<br>-Inventarizimi i pronës shtetërorë dhe paraqitja e saktë të tyre në pasqyrat financiare. | 15-32<br>32-35 |
| Pika 3 | 3.Auditim i procedurave për dhënie mendimi nga DRM, për lejet mjedisore të Tipit A, B, si dhe vlerësimi i proceduarave me ndikim në mjedis, për (VNM) paraprake dhe të thelluara. | 35-54 |
| Pika 4 | 4. Auditimin inspektimeve, monitorimeve, kontrolleve të kryera nga sektori i Inspektimeve të Mjedisit dhe Ujërave në DRM. | 54-75 |
| Pika 5 | 5.Auditimi i zbatimit të proceduarve për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra deri në ekzekutimin e tyre. | 75-81 |
| Pika 7 | Të tjera gjatë auditimi | 81-96 |
| **IV.** | **REKOMANDIME** | 97-108 |
| **V.** | **ANEKSE** | 108-110 |

**I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

**1.** Organizimi dhe Funksionimi i Agjencisë Rajonale së Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.
**a.** Agjencia Kombëtare e Mjedisit e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në 2 nivele: a) Nivel qendror, përmes Drejtorisë së Përgjithshme; b) Nivel rajonal, nëpërmjet 4 (katër) Agjencive Rajonale të Mjedisit (ARM) për ligjshmërinë në fushën e inspektimit si dhënien e mendimeve për leje të Tipit A, B, mendime për VNM paraprake dhe të Thelluara, ndërsa fondet buxhetore miratohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
**b**. Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të saj për procedurat e monitorimit të subjekteve në mjedis, vlerësimit të kryerjes së inspektimeve në fushën e mjedisit, dhënie mendimi subjekteve për pajisjen me leje mjedisore të Tipit A, B, aktivitetit ekonomiko-financiar dhe përmbushjes së funksioneve ligjore të mbrojtjes së mjedisit.
**c.** Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër me aktet ligjore dhe nënligjorë, për periudhën 01.01.2021-31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.
Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:
-zbatimi i ligjshmërisë së hartimit dhe zbatimit të buxhetit,
-auditimi i procedurave për mendimet e dhëna nga ARM, për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, auditimi i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM paraprake/të thelluara),
-auditimi i planeve të inspektimit, monitorimeve, kontrolleve të kryera nga Sektori i Inspektimeve të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore (Ujërat) në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.
-auditimi i zbatimit të procedurave për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra deri në ekzekutimin e tyre, nga Agjencia Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër.
**d**. Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është në varësi te çështjeve të auditimit, ku janë përdorur veçmas metodat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i transaksioneve me bankë, përdorimi i fondeve buxhetore, shqyrtimi i raporteve të inspektimit, të VNM-ve, verifikimi i dokumentacionit në sistemin E-inspektim.
**e.** Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 32 gjetje dhe ka dhëne 32 rekomandime.
**f. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**
Nga auditimi në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, u konstatuan disa mangësi ku disa më kryesoret janë:
- Sektori i Mjedisit, nuk ka dhënë masë administrative për çdo shkelje të konstatuar në 3 subjekte,
-në inspektimet e kryera nga sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) mungon dokumentacion i duhur ligjor në sistemin e-inspektim online, për 33 subjekte të konstatuara me shkelje,
- nga inspektimet e kryera nga Sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) për 3 subjekte nuk janë hartuar vendimet përfundimtare sipas procesverbaleve të shkeljeve të konstatuara,
- për asnjë vit të periudhës audituese nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër,
**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:
-sektori i inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) për shkeljet e konstatuara të hartojnë vendimet përfundimtare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi,

-Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim më përgjegjësin e Sektorit të Shërbimit dhe Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, dhe paraqitjen e saktë të tyre në pasqyrat financiare të njësisë. Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të aktiveve të institucionit.
-Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për Leje mjedisi Tipi A dhe B, në respektim të kritereve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e të dokumentacionit.
-Për 33 subjekte të konstatuara me shkelje, në sektorin e Burimeve Natyrore Ujëra të merren masa dhe të hartohen autorizimi për kryerjen e inspektimeve ndaj subjekteve dhe në rast konstatim të shkeljeve të merren masa administrative ndaj subjekteve .

**I. 1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

***Opinion mbi përputhshmërinë:***
Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë ~~së~~ Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me: pasqyrat financiare; procedurat e lëshimit të lejeve mjedisore; monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore; inspektimet, etj.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar të përputhshmërisë.
**Baza për opinionin**
Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.
Ne jemi të pavarur nga Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-nr. 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik,. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).
Në besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të modifikuar. Dhënien e opinionit të modifikuar e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve:
-Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, në sistemin e-inspektim online mungon dokumentacion i duhur ligjor për 33 subjekte të konstatuara me shkelje, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 "Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotura, datë 07/4/2003,-Ligjin Nr.111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" 30 "Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre".
-Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, për 3 subjekte nuk janë hartuar vendimet përfundimtare sipas procesverbaleve të shkeljes së konstatuar, në kundërshtim me Ligjit NR.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar si dhe Nenin 23 të Ligjit nr. 9115/2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të ndotur" Neni 42-46.

-Sektori i Mjedisit, për 3 subjekte nuk janë dhënë masë administrative për çdo shkelje të konstatuar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Nenin 65, të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011"Për lejet e mjedisit", Nenin 14 Vlerat 26 kufi të shkarkimeve.
-Në 43 praktika për leje mjedisi Tipi A/B, rezulton se janë konstatuar mangësi në dokumentacion, ndërsa mendimet të përcjella Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kanë qenë pozitive, si dhe për 17 aplikime është tejkaluar afati 10 ditor për dhënien e mendimit, veprime në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 dhe me rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit.
-Në 32 raste raporti i posaçëm (procesverbali) nga ana e specialistëve të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, nuk është mbajtur në ditën që është zhvilluar dëgjesa me publikun, por është dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pas 10-20 ditësh nga zhvillimi i procedurës, veprime në kundërshtim me Rregulloren nr.1, datë 03.03.2017, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "Për zbatimin e procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" pika 10.
-Sektori i Inspektimit Mjedisit, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në qarqet Fier Vlorë Gjirokastër, me qëllim identifikimin e dhe veçimin e subjekteve me risk të lartë me ndikim në mjedis;
- Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së, nëse subjekti është aktiv apo jo, në moszbatim të nenit 11 të Ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
-Në pasqyrat financiare të vitit 2022, nuk pasqyrohen të sakta vlera e llogarisë ekonomike 311"Materiale", llogarisë ekonomike 468 "Debitorë të ndryshëm", llogarisë ekonomike 212 "Ndërtime konstruksione", llogarisë ekonomike 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", llogarisë ekonomike 215 "Mjete Transporti", llogarisë ekonomike 218 "Inventar ekonomik", veprime që bien në kundërshtim me kërkesat e UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".
-Për asnjë vit të periudhës audituese nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30.
Nga auditimi i veprimeve me bankë, rezultuan disa shkelje dhe parregullsi me kuadrin rregullator ligjor përkatës në vlerë 860,524 lekë si: llogaritje e gabuar e shtesës mbi pagë, pagesa për gjobë për deklarim të vonuar të tatimit të mbajtur në burim, pagesë për kamatë vonesë të faturave të energjisë elektrike, shpenzime udhëtimi pa dokumentacion financiar, shkelje të legjislacionit të prokurimeve publike për blerjet me vlerë të vogël.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr.108/1 datë 29.01.2024, "*Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie mbi veprimtarinë* e *Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër,* për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1.V.B., përgjegjës grupi;
2.Sh. H., anëtar,
3.Xh.K., anëtar.

***Objektivat dhe qëllimi i auditimit*:**

Ky auditim ka si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë së Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për garantimin e mirë menaxhimit të financave publike, me qëllim mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e

tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.
Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse baza ligjore aktualisht në fuqi, politikat e parashikuara dhe praktikat e ndjekura për periudhën 2020 - 2023, funksionojnë të gjitha me synimin e vetëm mbrojtjen e mjedisit në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

***Identifikimi i çështjes***

Nëpërmjet këtij auditimi kërkojmë të identifikojmë zbatimin e dispozitave ligjore në: hartimin dhe zbatimin e buxhetit; të ruajtjes, dokumentimit, qarkullimit të vlerave materiale e monetare si dhe mbajtjes së kontabilitetit; të procedurave për dhënie mendimi nga Agjencia Rajonale të Mjedisit, për lejet mjedisore të Tipit A, B si dhe vlerësimi i proceduarave me ndikim në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara; inspektimeve, monitorimeve, kontrolleve të kryera; zbatimin e proceduarve për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra deri në ekzekutimin e tyre, etj., në veprimtarinë e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër e cila ka si objektiv garantimin dhe mbrojtjen mjedisore në rajonin që mbulon.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**:

Agjencisë Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse e Agjencinë Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, për veprimtarinë duke iu referuar VKM-së nr.568, datë 17.07.2019 **"**Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së; Ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014".
-Dhënie mendimi VNM paraprake dhe të Thelluara, dhënie mendimi për leje mjedisore Tipi A, B.
-Inspektimi i praktikave në fushën e mjedisit dhe Ujërave, si dhe dënimet administrative

***Përgjegjësitë e audituesve:***

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:
-Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100* ), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;
-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300);
-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.
Ne jemi të pavarur e theksuar kjo në ISSAI-n 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 30 "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.
Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv,

profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë.

**Kriteret e vlerësimit:**

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH-së, miratuar me Vendimin të Kryetarit të KLSH nr. 58, datë 08.04.2022; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), "Udhëzuesit e INTOSAI-t"; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik;

Gjithashtu në përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Agjencisë Rajonale të Fier, Vlorë, Gjirokastër e konkretisht disa prej tyre si Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij; Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligji nr. 53/2020 "Për disa ndryshime të Ligjit nr.10431" datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; Ligji nr.10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; VKM-së nr.568, datë 17.07.2019 "Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhri nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së", Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"; Ligji Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit"; Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"; Ligji nr. 111/2012"; Ligji Nr. 9115 dt. 24.07.2003 "Për trajtimin e Ujërave të ndotura", të ndryshuar; Ligji Nr. 8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar"; Ligji Nr. 9103, datë 10.07.2003 "Për mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare" i ndryshuar", etj.

***Standardet e auditimit***

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.07, datë17.01.2024, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre, etj,.

**Metodat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

**a.** *Metoda "Testim hap pas hapi"***:** Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

**b.** *Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efiçencën e veprimeve.

**c.** *Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

**d.** *Metoda e inspektimit fizik:* Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

**e.** *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm.

Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacioni gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.
**f.** *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

**<u>Dokumentimi i auditimit</u>**

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.
Dokumentimi i Auditimit është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren "Për Procedurat e Auditimit", miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 07, datë 17.01.2024 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

## <u>III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</u>

### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Fier, Vlorë, Gjirokastër kryen veprimtarinë e saj referuar VKM-së nr.568, datë17.07.2019 "Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së" dhe ka për objektiv: dhënien e mendimeve për leje të Tipit A, B mendime për VNM paraprake dhe të Thelluara, monitorimin e subjekteve të licencuara, inspektimin në fushën e mjedisit, Ujërave ndaj subjekteve të pajisura me leje mjedisore, ndjekjen në rrugë gjyqësore deri në arkëtimin e detyrimeve të subjekteve ndaj të cilave janë marrë masa administrative me dënime (gjobë) si dhe veprimet financiare.

### 2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1.Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit, (zbatimi i kritereve dhe procedurave të hartimit të nevojave për buxhetin afatmesëm (PBA) dhe buxhetit të shtetit për vitin 2021-2023.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Rregullorja e brendshme e institucionit.
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.
-Dokumentacioni i PBA-ve të miratuara gjatë periudhës objekt auditimi.
-Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit.
-Realizimi i shpenzimeve me planifikimet.
-Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit;

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:***

**A.** Kërkesat buxhetore **PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025** nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk janë dërguar në Ministrinë përgjegjëse për financat, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kundërshtim me Nenin 24, 27 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e

Shqipërisë", i ndryshuar; me Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afat mesëm", pika 2.3. Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Qeverisjes Qendrore, pika 4; me Nenin 27 pika 1 të Udhëzimit plotësues nr.28, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023" si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 9, datë 28.02.2022 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025", pikat 4 dhe 9, përgjegjës i së cilës është struktura menaxheriale e institucionit.
-Kërkesa buxhetore **PBA 2022-2024** është dërguar pranë Drejtorisë së Financave së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresë nr. 3588 prot, datë 11.10.2021 së bashku me Formularët e Projekt Investimeve 2022-2024, hartuar nga Komisioni i hartimit të PBA 2020-2022 (pa urdhër të NA).
-Kërkesat buxhetore për PBA 2022-2024 nuk janë dërguar në mënyrë elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) në përputhje me dokumentin PBA; nuk janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, si dhe dërguar jashtë afateve ligjore të përcaktuara (40 ditë më vonë), në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit plotësues nr. 8, datë 26.02.2021 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024", pika 4, 9, 10.
Duke qenë se nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk janë hartuar dhe dërguar kërkesat buxhetore PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025 nuk mund të analizojmë dhe krahasojmë kërkesat sipas artikujve ekonomikë për shpenzimet korrente dhe ato kapitale për periudhën e auditimit 2021-2023, mos hartimi i të cilave nuk bën të mundur një para shikueshmëri në alokimet e ardhshme afatmesme (3-vjeçare) për investime dhe shpenzime korrente midis qeverisjes qendrore dhe subjektit.
**<u>Situata:</u>** Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk janë dërguar Kërkesa buxhetore PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025 në Ministrinë përgjegjëse për financat, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kundërshtim me Nenin 24, 27 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" 2.3. -Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Qeverisjes Qendrore; Udhëzimi plotësues nr.28, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023", neni 27 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 28.02.2022 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025", pika 4, 9 e tij.
-Kërkesat buxhetore për PBA 2022-2024 nuk janë dërguar në mënyrë elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) në përputhje me dokumentin PBA; nuk janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, si dhe dërguar jashtë afateve ligjorë të përcaktuara (40 ditë më vonë), në kundërshtim me kërkesat Udhëzimit plotësues nr. 8, datë 26.02.2021 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024", pika 4, 9, 10 si dhe me Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" pika 2.5. Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit.
**<u>Ndikimi/Efekti</u>:** Mosnjohja e rëndësisë për hartimin dhe dërgimin e dokumentit PBA në ministrinë përgjegjëse për financat nuk lejon një para shikueshmëri në alokimet e ardhshme të burimeve gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare), duke ndikuar në kombinimin e përshtatshëm midis alokimeve për investime dhe shpenzime korrente midis qeverisjes qendrore dhe subjektit.
**<u>Shkaku:</u>** Mos njohja e ligjshmërisë nga organet drejtuese.
**<u>Rëndësia</u>:** E lartë

**B. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe plani përfundimtar.**

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar; UMF nr. 2,

datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe në ligjet vjetore të buxhetit dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financave përkatësisht sipas viteve.

**Viti 2021,** Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në Ligjin nr. 137/2020 "*Për buxhetin e vitit 2021*", sipas shkresës nr.1978 prot, datë 18.03.2021 së Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit së MTM-së (Kodi i institucionit 1026069) ku ka dërguar plan buxhetin e vitit 2021 në limit vjetor dhe mujor. Gjatë vitit buxheti ka pësuar ndryshime në zbatim të akteve normative, si më poshtë:

Buxheti i vitit 2021 Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër *(*000/lekë*)*

| Emërtimi | Plani fillestar i miratuar 2021 | Fondi risshpërnd. 2021 | Fondi risshpërnd. 2021 | Fondi risshpërnd. 2021 | Plani përfundimtar i rishikuar | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shk. nr.1978 dt.18.3.2021 MTM | Shk.nr. 3785/1 prot. dt.21.6.2021 MTM | A.N. nr.26 dt. 22.06.2021 | A.N.nr.34 dt. 3.12.2021 | | (Plani rishikuar/ Planit Fillestar) |
| **Shpenzime (A)+(B)** | **41,200** | **624** | **-3,000** | **-6,000** | **32,824** | **-8,376** |
| Paga | 34,500 | | -3,000 | -5,500 | **26,000** | **-8,500** |
| Sigurime | 5,700 | | | -500 | **5,200** | **-500** |
| Shërbime | 1,000 | 624 | | | **1,624** | **624** |
| Transferta | 0 | | | | **0** | **0** |
| Shp.Operative **(A)** | **41,200** | **624** | **-3,000** | **-6,000** | **32,824** | **-8,376** |
| Investime | | | | | | |
| **Shpenzime kapitale (B)**<br>**Nr. Punonjës** | **48** | | | | | |

*Burimi i të dhënave: Sektori Shërbimit dhe Financës* ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, përpunuar nga G.A.

Nga shqyrtimi i të dhënave del se plan buxheti i vitit 2021 është 41,200 mijë lekë dhe 48 numri gjithsej i punonjësve.

- Buxheti në planin vjetor në fillim të vitit 2021 është 41,200 mijë dhe fondi i rishpërndarë në fund të vitit është 32,824 mijë lekë me një ndryshim në pakësim prej 8,376 mijë lekë.
- Plani fillestar ka ndryshuar me një vlerë në zbritje me 8,376 mijë lekë (duke zbritur rreth 25% shpenzimet për paga dhe rreth 9% shpenzimet për sigurime shoqërore), krahasuar me planin përfundimtar, dhe kjo si rezultat i vendeve të lira të punës.

Buxheti i akorduar nga MTM për vitin 2021 në shumën 32,824 mijë lekë, rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit.

Me shkresë nr.3785/1 prot., datë 21.06.2021 të MTM-së është miratuar kërkesa Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për shtesë fondi në llog. ek. 602 në shumën 623,910 lekë për riparimin e një mjeti transporti të marrë nga ISHMPUT Durrës nga procesi i transferimit të aseteve në vitin 2020.

- Kërkesa për shtesë të fondit të shpenzimeve për 624 mijë lekë nuk është e argumentuar nga specialistë të fushës, nuk ka një preventiv punimesh me zëra dhe kosto përkatëse, në kundërshtim me pikën 74, 48 të Udhëzimit nr.2, datë 06. 02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

**Viti 2022,** Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur Ligjin 115/2021 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2022"; UMF nr. 1, datë 10.01.2022 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022*"; sipas shkresës nr.547 prot., datë 22.03.2022 së Drejtorisë së Financës e Buxhetit së MTM-së ku ka dërguar plan buxhetin e vitit 2022 në limit vjetor dhe mujor.

Gjatë vitit buxheti ka pësuar ndryshime në zbatim të akteve normative, ku në vijim paraqiten gjithë ndryshimet që ka pësuar buxheti Agjencisë Rajonale së Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër gjatë vitit 2022 nga zbatimi i akteve normative, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022" si dhe të kërkesave për shtesë fondi në llogarinë e shpenzimeve "602".

Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024, për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër. (000/lekë)

| Emërtimi | Kërkesa PBA | Plani fillestar i | Fondi risshpërnd. 2022 | Fondi risshpërn d. 2022 | Fondi risshpërnd. 2022 | | | Ndryshimi | Ndryshim i |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | 2022-2024 | miratuar 2022 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkr. nr 3588 prot. dt. 11.10.2021 | Shkresa nr.547 dt.22.1.2022 MTM | A.N nr.3. dt.12.3.2022 | A.N. nr.12 dt. 29.07.2022 | Shtesë kërkese me shk.nr.5456/2 prot dt 29.07.2022 | Shkresë Shtator, Dhjetor, | Plani përfundimtar i rishikuar | (Plani rishikuar/ Planit Fillestar) | Plani Rishikuar / Kërkesë Buxhetore ) |
| **Shpenzime (A)+(B)** | **48,042** | **42,700** | **-580** | **-5,600** | **2,000** | **-6,000** | **33,090** | **-9,610** | **-14,952** |
| Paga | 33,552 | 34,500 | -500 | -5,000 | | **-5,000** | **24,000** | **-10,500** | **-9,552** |
| Sigurime | 5,610 | 5,700 | -80 | -600 | | **-1,000** | **4,020** | **-1,680** | **-1,590** |
| Shërbime | 5,110 | 2,500 | | | 2,000 | | **4,500** | **2,000** | **-610** |
| Transferta | | 0 | | | | | **570** | **570** | **570** |
| Shp.Operative **(A)** | **44,272** | **42,700** | **-580** | **-5,600** | **2,000** | **-6,000** | **33,090** | **-9,610** | **-11,182** |
| Investime | 3,770 | | | | | | | | **-3,770** |
| **Shpenzime kapitale (B)** | **3,770** | | | | | | | | |
| **Nr. punonjës** | **48** | | | | | | | | |

*Burimi i të dhënave: Sektori Shërbimit dhe Financës* ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, përpunuar nga G.A.

Nga shqyrtimi i të dhënave del se plani fillestar i buxhetit të vitit 2022 është 42,700 mijë lekë dhe 48 është numri gjithsej i punonjësve të miratuar në strukturë, i cili rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Fier.

-Plani fillestar krahasuar me planin përfundimtar ka ndryshuar me një vlerë në ulje në total me 9,610 mijë lekë (zbritur rreth 30% shpenzimet për paga dhe rreth 29% shpenzimet për sigurime shoqërore si rezultat i 12 vendeve të lira dhe shtuar shpenzime operative 80%).

-Buxheti vjetor 2022 i miratuar rezulton me vlerë në zbritje në total me 14,952 mijë lekë, krahasuar me kërkesat buxhetore.

-Nuk janë miratuar në plan buxhetin e vitit 2022 shpenzimet kapitale në shumën 3,770 mijë lekë, për blerje dhe instalim pajisje laboratorike për analiza fiziko-kimike, biokimike, të cilat do t'i shërbenin ushtrimit e funksionimin normal dhe me efektivitet të aktivitetit të institucionit, të parashikuara këto në PBA 2022-2024.

-Buxheti i akorduar nga MTM-ja për vitin 2022 në shumën 33,090 mijë lekë, rakordon me situacionet mujore /progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit.

-Me shkresë nr.5456/2 prot., datë 29.07.2022 të MTM-së është miratuar shtesë fondi në llog.ek. 602 në shumën 2,000 mijë lekë nga 2,400 mijë lekë që është kërkuar. Për zërin shpenzime operative janë parashikuar të shpenzohen 5,110 mijë lekë, ndërsa plani fillestar është 2,500 mijë lekë, ose në masën 80% të planit fillestar. MTM ka pranuar të rrisë fondin për të përmirësuar ose zgjeruar veprimtarinë e subjektit, por nga ana tjetër alokimi i shtesës së fondit sjell edhe përgjegjësi të shtuara në menaxhimin e financave dhe të raportimit. Nga analiza e të dhënave të kërkesës për shtesë fondi, del se nevojat për të mbuluar kostot e rritura operative nuk janë argumentuar dhe analizuar në mënyrë të mjaftueshme, në kundërshtim me pikën 74, 48 të Udhëzimit nr.2, datë 06. 02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Kërkesat për shtesë fondi sipas zërave, miratuar me shkresë nr.5456/2 prot., datë 29.07.2022 të MTM. (000 /lekë)

| | Karburant "6023" | Taksë Bashkie "6029" | Udhëtim e Dieta"6024" | Pjesë këmbimi"6023" | Vendime gjyqësore "6027" | Siguracion e taksa makine"6023" | Blerje tonera "6020" | Vlerë Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PBA 2022-2024** | **1600** | **0** | **450** | **400** | **0** | **200** | **180** | **2830** |
| Ralizimi deri korrik 2022 | 821 | 0 | 440 | 55 | 57 | 27 | 211 | 1611 |
| **Kërkesa për shtesë** | **750** | **300** | **550** | **500** | **100** | **150** | **50** | **2,400** |
| Shpenzuar 31.12.2022 | 1336 | 135 | 1300 | 343 | 0 | 75 | 384 | 3573 |
| **Vlerë mbetur 31.12.2022** | -235 | -165 | 310 | -212 | -157 | -102 | 123 | -438 |
| **Miratuar Total** | **2,000** | | | | | | | |

Burimi i të dhënave: Sektori Financës, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

Për të gjitha këto lloje shpenzimesh, vlerat negative tregojnë se shpenzimet në fakt në fund të periudhës rezultojnë më pak se plani fillestar i buxhetit. Vlerat pozitive tregojnë se shpenzimet në fakt në fund të periudhës kanë kaluar planin fillestar të buxhetit, pra kërkesat për shtesë fondi nuk kanë qenë të mirë studjuara e të argumentuara sipas zërave të kërkuar.
* Për zërin karburant nuk bëhet një analizë e sasisë së harxhuar dhe parashikim i nevojave për çdo mjet transporti bazuar në lëvizjet sipas parashikimeve të programeve të punës dhe planeve të inspektimit sipas sektorëve përkatës.
*Zëri taksa bashkie nuk ka qenë i parashikuar, në mbyllje të vitit rezulton i realizuar për 165 mijë lekë më pak, krahasuar me kërkesën për shtesë fondi.
*Zëri udhëtime e dieta nuk argumentohet se kujt periudhe i referohen pagesat që do të bëhen dhe sa parashikohen deri në mbyllje të vitit.
*Zëri shpenzime për pjesë këmbimi dhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, i referohet riparimit të 2 automjeteve, pa dokumentacionin e nevojshëm të argumentuar zë për zë dhe të dëshmuar nga specialistë të fushës ose të institucionit. Nga e njëjta shoqëri private është paraqitur një listë me zëra pune për një mjet në vlerën prej 182,500 lekë, ndërsa për mjetin tjetër listë me zëra pune pa vlerë, të pakonfirmuar nga specialistë të institucionit.
*Nuk janë parashikuar shpenzime për vendime gjyqësore. Në mbyllje të vitit rezulton me 57 mijë lekë realizim, kjo sipas Vendimit nr.713, datë 19.11.2020 të Gjykatës Administrative Shkallës Parë Vlorë nga N. M dhe lajmërim për ekzekutim vullnetar nr.33 prot., Nr.1033 Regj. Datë 03.03.2021 nga Dhoma e përmbaruesve gjyqësorë privat Vlorë vitit 2022", në mosrespektim të pikës 126,127 të Udhëzimit plotësues 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022".
*Shpenzimet për siguracion mjetesh transporti nuk janë analizuar e argumentuar fare.
*Shpenzimet për blerje tonera nuk janë analizuar e argumentuar fare.

**Viti 2023** Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësie shpenzues është bërë mbështetur në Ligjin 84/2022 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2023," Udhëzimin plotësues Nr.2, datë 19.01.2023 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023*", sipas shkresës nr.870/1 prot., datë 10.02.2023 së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të MTM-së ku ka dërguar plan buxhetin e vitit 2023 në limit vjetor dhe mujor. Gjatë vitit buxheti nuk ka pësuar ndryshime.

Buxheti i vitit 2023 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2023-2025, për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër (000/lekë)

| Emërtimi | Plani fillestar i miratuar 2023 | Fondi risshpërnd. 2023 | Fondi risshpërnd. 2023 | Plani përfundimtar i rishikuar | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|---|
| | Shkresë nr.870/1 dt.10.2.2023 MTM | Shkresë nr. 2353 dt27.7.2023 | Shkresë nr.23173 dt 22.12.2023 | | (Plani rishikuar/ Planit Fillestar) |
| **Shpenzime (A)+(B)** | **45,000** | **1,200** | **-9,600** | **36,600** | **-8,400** |
| Paga | 36,000 | 1,000 | -8,300 | **28,700** | **-7,300** |
| Sigurime | 6,000 | 200 | -1,300 | **4,900** | **-1,100** |
| Shërbime | 3,000 | | | **3,000** | |
| Transferta | | | | | |
| Shp.Operative **(A)** | **45,000** | **1,200** | **-9,600** | **36,600** | **-8,400** |
| Investime | | | | | |
| **Shpenzime kapitale (B)**<br>**Nr punonjës** | | | | | |

*Burimi i të dhënave: Sektori Financës-* Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.

Nga shqyrtimi i të dhënave del se: Buxheti i akorduar nga MTM-ja për vitin 2023 në shumën 45,000 mijë lekë, i cili rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit.
-Plani fillestar krahasuar me planin përfundimtar ka ndryshuar me një vlerë në ulje në total me -8,400 mijë lekë (zbritur rreth 20% shpenzimet për paga dhe rreth 18% shpenzimet për sigurime shoqërore si rezultat i 15 vendeve të lira).

**C. Realizimi i planit të buxhetit.**

**Viti 2021.** Realizimi i buxhetit të ARM Fier-Vlorë-Gjirokastër për vitin 2021, krahasuar me kërkesat e vitit 2021, të përcjellë nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2021-2023, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2021,Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër (000/ lekë)

| Emërtimi | | Plani fillestar 2021 | Plani rishikuar Dhjetor 2021 | Realizmi 2021 | Realizmi 2021 (%) |
|---|---|---|---|---|---|
| **II Shpenzime (A)+(B)** | | **41,200** | **32,824** | **30,094** | **92%** |
| Shp.Operative (A) | Paga | 34,500 | 26,000 | 24,504 | **94%** |
| | Sigurime | 5,700 | 5,200 | 3,970 | **76%** |
| | Shërbime | 1,000 | 1,624 | 1,620 | **100%** |
| | Transferta | | | | - |
| **Total (A)** | | **41,200** | **32,824** | **30,094** | **92%** |
| Shpenzime kapitale (B) | Investime | | | | |
| **Total (B)** | | | | | |

*Burimi i të dhënave: Sektori Financës-* Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.

Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se për vitin 2021 fillimisht janë alokuar 41,200 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë alokuar 32,824 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore është në vlerën 30,094 mijë lekë ose 92%. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 24,504 mijë lekë, ose 94%, ndërsa shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 3,970 mijë lekë, ose 76%. Mosrealizimi i zërit "Paga" ka ardhur kryesisht nga mosplotësimi i 6 vendeve të lira të punës. Shpenzimet korrente për mallra dhe shërbime janë realizuar në shumën prej 1,620 mijë lekë ose 100 % e buxhetit të rishikuar dhe zënë 5,3% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

**Viti 2022.** Realizimi i buxhetit të ARM Fier për vitin 2022, krahasuar me kërkesat e vitit 2022, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2022-2024, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2022 Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër (000/ lekë)

| Emërtimi | | Kërkesa PBA 2022-2024 | Plani fillestar 2022 | Plani rishikuar Dhjetor 2022 | Realizmi 2022 | Realizmi 2022 (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **II Shpenzime (A)+(B)** | | **48,042** | **42,700** | **33,090** | **30,634** | **93%** |
| Shp.Operative (A) | Paga | 33,552 | 34,500 | 24,000 | 21,930 | **91%** |
| | Sigurime | 5,610 | 5,700 | 4,020 | 3,655 | **91%** |
| | Shërbime | 5,110 | 2,500 | 4,500 | 4,479 | **100%** |
| | Transferta | | | 570 | 570 | **100%** |
| **Total (A)** | | **44,272** | **42,700** | **33.090** | **30,634** | **93%** |
| Shpenzime kapitale (B) | Investime | 3,770 | | | | |
| **Total (B)** | | **3,770** | | | | |

*Burimi i të dhënave: Sektori Shërbimit, zyra financës* Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.

Sipas PBA 2022-2024 të ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, për vitin 2022 në total janë kërkuar 48,042 mijë lekë, nga të cilat janë alokuar 33,090 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve në vlerën 30,634 mijë lekë, ose me 93 %. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 21,930 mijë lekë, ose 91%; shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 3,655 mijë lekë ose 91% të cilat vijnë nga mosplotësimi i 12 vendeve vakande, që sjellin diferenca si në planifikim ashtu dhe në realizim të fondit të pagave dhe të sigurimeve shoqërore. Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 4,479 mijë lekë, ose rreth 100 % dhe zënë rreth 15% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

Shpenzimet për investime janë parashikur në shumën 3,770 mijë lekë, të cilat nuk janë alokuar as me planin fillestar, as gjatë vitit.

**Viti 2023.** Realizimi i buxhetit së Agjencisë Rajonale së Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të vitit 2023, krahasuar me kërkesat e vitit 2023, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të

PBA 2023-2025, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2023, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër (000/lekë)

| Emërtimi | | Plani fillisters 2023 | Plani rishikuar Dhjetor 2023 | Realizmi 2023 | Realizmi 2023 (%) |
|---|---|---|---|---|---|
| **II Shpenzime (A)+(B)** | | **45,000** | **36,600** | **35,820** | **98%** |
| Shp.Operative (A) | Paga | 36,000 | 28,700 | 28,337 | **99%** |
| | Sigurime | 6,000 | 4,900 | 4,730 | **97%** |
| | Shërbime | 3,000 | 3,000 | 2,753 | **92%** |
| | Transferta | | | | |
| **Total (A)** | | **45,000** | **36,600** | **35,820** | **98%** |
| Shpenzime kapitale (B) | Investime | | | | |
| **Total (B)** | | | | | |

*Burimi i të dhënave: Sektori Shërbimit, zyra financës* Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.

Sipas PBA 2023-2025 së Agjencisë Rajonale së Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, për vitin 2023 fillimisht janë alokuar 45,000 mijë lekë dhe buxheti përfundimtar është 36,600 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve në vlerën 35,820 mijë lekë, ose me 98 %. Shpenzimet për pagat janë realizuar në vlerën 28,337 mijë lekë, ose 99%, e cila krahasuar me vitin e mëparshëm rezulton me rritje në vlerën 6,407 mijë lekë ose me 29% më shumë, si rezultat VKM-së së rritjes së pagave, ndërsa shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore realizuar 4,730 mijë lekë ose 97%. Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 2,753 mijë lekë, ose 92 % dhe zënë rreth 8% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

## Zbatimi i buxhetit për shpenzimet:

Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor dhe progresiv për çdo muaj deri në muajin dhjetor të vitit kalendarik. Një kopje e situacionit dërgohet çdo muaj Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit në MTM. Regjistrimi shpenzimeve bëhet sipas Urdhër Pagesës dhe sipas rendit kronologjik.

Për vitet 2021, 2022 dhe 2023, bazuar në situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore llogaria 600, llogaria 601 dhe llogaria 602, paraqitet si më poshtë:

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër (000/lekë)

| Artikulli | Emërtimi | 2021 | | 2022 | | 2023 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt | Plan | Fakt | Plan | Fakt |
| **600** | **Shpenzime paga** | **26,000** | **24,504** | **24,000** | **21,930** | **28,700** | **28,337** |
| **6010** | **Kont. për Sig. shoq dhe shend** | **5,200** | **3,970** | **4,020** | **3,655** | **4,900** | **4,730** |
| **602** | **Shpenzime operative** | **1,624** | **1,620** | **4,500** | **4,479** | **3,000** | **2,753** |
| 60201 | Kancelari. printim | 100 | 80 | 420 | 384 | 300 | 336 |
| 60202 | Materiale pastrimi dezinfektim | 70 | 64 | 60 | 57 | 74 | 37 |
| 60203 | Blerje dokumentacioni | 70 | 72 | 0 | | 0 | |
| 602201 | Energji | 100 | 4 | 600 | 524 | 120 | 183 |
| 602202 | Ujë | 60 | 18 | 60 | 58 | 48 | 8 |
| 602203 | Telefon. internet | 70 | 27 | 70 | 50 | 72 | 83 |
| 602204 | Poste | 60 | 56 | 90 | 80 | 72 | 76 |
| 602301 | Karburant. vaj | 500 | 364 | 1600 | 1,336 | 1,320 | 597 |
| 602330 | Mirëmbajtje mjete transporti | 256 | 688 | 400 | 343 | 252 | 203 |
| 602302 | Siguracion. taksa | 100 | 107 | 50 | 75 | 70 | 77 |
| 60241 | Udhëtim i brendshëm | 100 | 48 | 900 | 1,300 | 500 | 676 |
| 60258 | Mirëmbajtje pajisje | 60 | 50 | 100 | 80 | 72 | 102 |
| 60261 | Qera ambienti | 22 | 22 | | 0 | | |
| 6029 | Te tjera operative | 56 | | | | | |
| 6029001 | Shpenzime tjera | | | | | | 4 |
| 602903 | Shpenzime gjyqësore | | | | 57 | | |
| 602908 | Tatime taksa | | 20 | 150 | 135 | 100 | 371 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 606 | Transferta për buxhetet familjare | | | 570 | 570 | | |
| | **Totali shpenzimeve** | **32,824** | **30,094** | **33,090** | **30,634** | **36,600** | **35,820** |
| | **Realizimi (Fakt/Plan)** | | **92%** | | **93%** | | **98%** |

*Burimi i të dhënave: Sektori Shërbimit, zyra financës* Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër.

***Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore*** shoqërohen me dokument justifikues si listëpagesa e firmosur nga NZ, nga NA dhe firmosur dhe vulosur nga punonjësi Degës së Thesarit. Në strukturë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2021 zënë 95 %, për vitin 2022 zënë 84% dhe për vitin 2023 zënë 92% të totalit të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor përkatës.

***Shpenzimet operative*** shoqërohen me dokument justifikues si urdhër-shpenzimi, faturë blerje, fletëhyrje në magazinë, urdhër prokurimi, kontratë furnizimi, proces verbal, etj. Në strukturë shpenzimet operative për vitin 2021 zënë 5 %, për vitin 2022 zënë 16% dhe për vitin 2023 zënë 8% të totalit të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor përkatës, jo të mjaftueshme duke pasur parasysh aktivitetin dhe shtrirjen në këto qarqe të institucionit.

-Shpenzime për materiale zyre, justifikohen me urdhër shpenzim, faturën e shitësit, fletë hyrje në magazinë, etj.

Shpenzimet korrente në total për këtë institucion, janë realizuar në vitin 2021 dhe vitin 2022 me 100% dhe për vitin 2023 me 92%, ndërsa shpenzime për investime nuk janë planifikuar, përvecse parashikur në kërkesën buxhetore 2021-2023.

***-Shpenzime nga të tretët*** përfshijnë pagesa për energji elektrike, ujë, telefon, internet, shërbim i ruajtjes se sigurisë, etj. Shpenzimet bazohen në urdhër shpenzim, fature shitje, urdhër prokurimi, kontratë shërbimi, etj.

***-Shpenzimet e transportit*** paraqesin shpenzime për blerje karburanti për automjetet e institucionit. Dokument vërtetues urdhër prokurimi, fatura e shitjes, fletë hyrje në magazinë, fletë dalje etj.

- Nga auditimi ka rezultuar mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për tre vitet e audituara, të cilat duhet të dërgohen në MTM. Kjo mungesë e raporteve të monitorimit cënon vlerësimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor. Po ashtu, mungesa e masave korrigjuese për të përmirësuar situatën është në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore"; Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligji 9936, datë 26.6.20208 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 65 Ligji 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 65:

<u>**Situata 1:**</u> **Për vitin 2021** fillimisht janë alokuar 41,200 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë alokuar 32,824 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore është në vlerën 30,094 mijë lekë ose 92%. Kërkesa për shtesë të fondit të shpenzimeve për 624 mijë lekë nuk është e argumentuar, me një preventiv punimesh me zëra dhe kosto përkatëse nga specialistë të fushës, në kundërshtim me pikën 74, 48 të Udhëzimit nr.2, datë 06. 02. 2012 "Për proçedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

-P**ër vitin 2022** në total janë alokuar 48,042 mijë lekë, nga të cilat janë alokuar 33,090 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve në vlerën 30,634 mijë lekë, ose me 93 %. Kërkesa për shtesë fondi të shpenzimeve prej 2,000 mijë lekë nuk është analizuar, argumentuar dhe dokumentuar mjaftueshëm dhe nuk janë të mbështetura mjaftueshëm në nevojat reale, në kundërshtim me pikat 74 dhe 48 të Udhëzimit nr.2, datë 06. 02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

-Shpenzimet për investime janë parashikur në shumën 3,770 mijë lekë, të cilat nuk janë alokuar as me planin fillestar, as gjatë vitit.

**-Për vitin 2023** fillimisht janë alokuar 45,000 mijë lekë dhe buxheti përfundimtar është 36,600

mijë lekë. Realizimi shpenzimeve në vlerën 35,820 mijë lekë, ose me 98 %.
**Situata 2:** Nga auditimi konstatohet se NA dhe NZ, për të tre vitet objekt auditimi, mungojnë raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Agjencisë Rajonale së Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, të cilat dërgohen në MTM. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cënojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe mungesën e marrjes së masave korrigjuese për përmirësimin e situatës, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore".
**Kriteri:** 1.Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat Standarde të përgatitjes së Programeve Buxhetore Afatmesme", kreu 7.
**2.**Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligji Nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 65, si dhe Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore.
**Ndikimi/Efekti**: Mungesa e investimeve të domosdoshme për blerjen e aktiveve të reja apo zgjerimin e një aktivi të qëndrueshëm ndikon në përmbushjen e aktivitetetit dhe qëllimit për të cilin është krijuar njësia.
**Shkaku:** Mosvlerësimi i domosdoshmërisë së miratimit të fondeve për investime në PBA.2. Mosvlerësimi i domosdoshmërisë së miratimit të fondeve për investime në PBA.
**Rëndësia:** E Lartë
*Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi ish drejtori dhe Z.D.V. me detyrë drejtor i komanduar për periudhën nga data 04.05.2022 e në vazhdim; z.P. T. me detyrë P/Sektori Shërbimit dhe Financës.*
***2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe mbajtjen e kontabilitetit konkretisht:***
***-Pasqyrat financiare dhe plotësimi i bilancit dhe anekseve përkatëse sipas udhëzimeve.***
***-Inventarizimi i pronës shtetërore dhe paraqitja e saktë e tyre në pasqyrat financiare.***
Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Dokumentacioni i pasqyrave financiare.
- Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.
- Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.
- Dokumente kontabël.
- Të tjera dokumente mbështetëse.
- Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit të aktiveve.
- Urdhër Nr.54, datë 24.02.2020 i Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM".

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare.***

Hartimi e pasqyrave financiare dhe përgatitja e llogarive vjetore bazohet
- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollin";
- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.8, datë 09.03.2019 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

  - ***Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2022***.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër për vitin 2021, 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm si njësi shpenzuese pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese. Ky subjekt është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Fier me NIPT L....V.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ dhe janë dërguar për vitin 2021 me shkresë përcjellëse nr. 952 prot., datë 30.03.2021; për vitin 2022 me shkresë përcjellëse nr. 868 prot., datë 31.03.2022 Degës së Thesarit Fier, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës së Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë e Turizmit dhe Mjedisit, Institutit të Statistikave pranë qarkut Fier.

-Pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Fier nëpërmjet sistemit C@ts, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" i ndryshuar, pika 3.12. "*Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit*" në lidhje me depozitimin on-line të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës.

***• Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2021, 2022 nga verifikimi i situacionit të shpenzimeve dhe të të ardhurave rezulton të jenë të rakorduara me Degën e Thesarit Fier dhe Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës së MTM-së në total mujor e vjetor, dhe nuk ka diferenca.

***• Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për vlerësimin e Raportimit Financiar për vitin 2022, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi nga grupi u auditimit u bë verifikimi i pasqyrave financiare, nga ku rezultoi se pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) nr. 05, datë 21.02.2022 *"Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"*, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar;
Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);
Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow), sipas metodës direkte;
Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
Format nr. 5 –Shënimet shpjeguese;
*Pasqyrat statistikore:*
Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit;
Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike);
Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto);
Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave .

***• Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier.***

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet vërtetuese, të cilat kanë shërbyer si të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Rregjistrimi i veprimeve kontabile është bërë bazuar në dokumentacionet justifikues të cilat kanë paraqitur me vërtetësi veprimin ose ngjarjen;
-Dokumentet vërtetues, si Urdhër-shpenzimet janë të hartuara sipas formatit të miratuar dhe shoqërohen me dokumente autorizues si urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj;
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- Në këtë institucion, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel".
-Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtja e kontabiliteti të njësisë nuk është mbështetur në dokumente kontabël.
-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke, në exel me vlera, por nuk janë mbajtur ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj, në të cilat regjistrohen të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të marra nga dokumentet bazë të magazinës, të pagave; nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore;
-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese dhe mosmbajtja e tyre është në mosrespektim të kërkesave të kërkesave të Nenit 3, pika 1, të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Kreu II Dispozita të Përgjithshme mbi Dokumentet Kontabël dhe Pasqyrat Financiare: *"Neni 6, Mbajtja e kontabilitetit; Neni 7, Dokumenti kontabël;* Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II 2.1 "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 2.2 Kreu III Paragrafi 43.
**Situata:** Nga verifikimi i bërë në lidhje me mbajtjen e kontabilitetit, ka rezultuar se:
1.Pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Fier nëpërmjet sistemit C@ts, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" i ndryshuar, pika 3.12. "*Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit*" në lidhje me depozitimin on-line të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës.
Nga verifikimi i bërë në lidhje me zbatimin e procedurave të raportimit ka rezultuar se:
2.Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin, në mosrespektim të kërkesave të Nenit 3, pika 1 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, *Kreu II Dispozita të Përgjithshme mbi Dokumentet Kontabël dhe Pasqyrat Financiare Neni 6, Mbajtja e kontabilitetit, Neni 7 Dokumenti kontabël*; Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II 2.1 "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 2.2; Kreu III Paragrafi 43.
-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke në exel me vlera, por nuk janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës, etj, në të cilat regjistohen të gjitha veprimet dhe faktet

ekonomike të marra nga dokumentet bazë të bankës, magazinës; nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore;
-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël, të cilat shërbejnë si bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të marra nga dokumentet vërtetuese.
**Kriteri:** UMF nr.5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" i ndryshuar, pika 3.12; Ligji Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Neni 3 pika 1, Kreu II dhe Neni 6,7; Udhëzimi MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II pika 2.1dhe pika 2.2, **Kreu III** Paragrafi 43.
**Ndikimi/Efekti:** Pasqyrim jo të saktë të situatës financiare.
**Shkaku:** Sektori i Financës nuk ka vepruar referuar procedurave për mbajtjen e kontabilitetit.
**Rëndësia:** E lartë.
**Pasqyra e Pozicionit Financiar.**
**Totali i aktivit** për vitin 2021 është 18,324,094 lekë, për vitin 2022 është 14,671,381 lekë, krahasuar me vitin 2021 rezulton në ulje prej 3,652,713 lekë.
**I. Aktivet Afatshkurtra**
Për vitin 2021 paraqiten në shumën 5,223,876 lekë, për vitin 2022 në shumën 3,700,676 lekë**,** krahasuar me vitin 2021 rezulton me ulje prej 1,523,200 lekë.
Në klasën 3 **"Gjendja e inventarit qarkullues"** të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,507,326 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive, si vijon:
Tabela nr.1: "Inventari qakullues" Lekë

| Referenca e Llogarive | E M Ë R T I M I | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| | **2.Gjendje Inventari qarkullues** | **1,507,326** | **1,507,326** | **-** |
| 31 | Materiale | 61,469 | 61,469 | - |
| 32 | Inventar i imët | 1,445,857 | 1,445,857 | - |

Burimi: ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024).
***-Gjendja e llogarisë 31 "Materiale"*** në mbyllje të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar në vlerën 61,469 lekë, krahasuar me periudhën e mëparshme.
***-Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imët"*** në mbyllje të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar, në vlerën 1,445,857 lekë, krahasuar me periudhën e mëparshme, si rrjedhim llogaria 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" është 0 lekë.
***Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit,*** ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë:
**a) Kur blihen, bëhen hyrje materialet:**
Debitohet klasa 3 "Gjendje inventari qarkullues";
Kreditohet 63 "ndryshimi i gjendjes së inventarit".
**b) Kur bëhen dalje materialet:**
Debitohet 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit";
Kreditohet klasa 3 "Gjendje inventari qarkullues".
-Duke parë pandryshueshmërinë e gjendjes së kësaj llogarie nga grupi i auditimit u krye verifikimi dhe kontrollin i dokumentacionit vërtetues (fletëhyrje dhe fletëdalje), ku rezultoi se gjendja e ***llogarisë 31 "Materiale"*** në mbyllje të vitit 2022 paraqitej në vlerën 560,187 lekë, e cila nuk rezulton e pasqyruar në bilanc, si më poshtë:

Çelje 01.01.2022 (v.2021) 61,469 lekë
Fletë Hyrje (6) deri në 31.12.2022 728,942 lekë

Fletë Dalje (23) deri në 31.12.2022 230,224 lekë

-Nuk është bërë për asnjë vit të periudhës audituese inventarizimi, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 30.

-Në fund të çdo periudhe raportuese nuk ka rakordim dhe as procesverbal të mbajtur midis magazinierit dhe sektorit të financës, nuk mbahet ditari i magazinës, nuk mbahen kartela që tregon gjendjen dhe lëvizjen e çdo artikulli në sasi e në vlerë, duke ndikuar kështu në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar të klasës 3, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

**Situata** Nga analiza e bërë për saktësinë e paraqitjes së llogarisë 31 "Materiale" rezultoi se në mbyllje të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar në vlerën 61,469 lekë, krahasuar me periudhën e mëparshme.

-Nga verifikimi dhe kontrolli i dokumentacionit vërtetues (fletëhyrje dhe fletëdalje) rezultoi se, në mbyllje të vitit 2022 gjendja kontabël e llogarisë 31 "Materiale" paraqitet në vlerën 560,187 lekë, vlerë e cila rakordoi me gjendjen fizike të materialeve gjendje në magazinë, bazuar në kontrollin e ushtruar në magazinën e institucionit, dhe se kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar në bilanc.

-Nuk ka aktrakordim në fund të çdo muaji/viti të mbajtur midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës për gjendjen për çdo zë të këtyre aktiveve, duke ndikuar kështu në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar të klasës 3, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 pika 52, 53.

-Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese në lidhje me këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikat që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimit të tyre, ashtu siç përcaktohet në SKK 4 (Inventarët).

-Nuk ka aktrakordim në fund të çdo muaji/viti të mbajtur midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës për gjendjen për cdo zë të këtyre aktiveve, duke ndikuar kështu në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar të klasës 3, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 pika 52, 53.

-Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese në lidhje me këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikat që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimit të tyre, ashtu siç përcaktohet në SKK 4 (Inventarët).

**Kriteri:** UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30; UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 52,53,73,74.

**Ndikimi/Efekti:** Pasqyrim jo të drejtë të gjendjes së klasës 3.

**Shkaku:** Sektori i Financës nuk ka vepruar referuar procedurave ligjore kryerjes së inventarizimit dhe rakordimit me magazinën.

**Rëndësia:** E lartë

Klasa 4 **"Llogari të arkëtueshme"** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,193,350 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është 3,364,704 lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm kemi pakësim, si rezultat i mospasjes së detyrimeve ndaj furnitorëve.

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

Tabela nr.2: " Llogari të arkëtueshme " Lekë

| Referenca e Llogarive | E M Ë R T I M I | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca (2022-2021) |
|---|---|---|---|---|
| | **3.Llogari te Arketueshme** | **2,193,350** | **3,364,704** | -1,171,354 |
| 4342 | Operacione me shtetin (Të drejta) | 2,193,350 | 3,364,704 | -1,171,354 |

Burimi: Agjencia Rajonale Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër; përpunuar nga grupi i auditimit (2024).

- *Gjendja e **llogarisë 4342 "Operacione me shtetin, të drejta" (debitorë)*** më 31.12.2022 paraqitet në vlerën në vlerën 2,193,350 lekë dhe përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021. Nga analiza e llogarisë 4342 "Operacione me shtetin, të drejta" për vitin 2022 është e analizuar si vijon:

1-detyrimet për paga ndaj personelit, të pasqyruara në llogarinë 42 "Personeli e llogari të lidhura me to", në vlerën 1,723,221 lekë.
2-sigurime shoqërore të pasqyruara në llogarinë 435 "Sigurime shoqërore", në vlerën 296,450 lekë.
3-sigurime shëndetësore të pasqyruara në llogarinë 436 "Sigurime shëndetësore", në vlerën 60,354 lekë.
4-detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa të pasqyruara në llogarinë 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa", në vlerën 113,325 lekë.
5-detyrime ndaj furnitorëve , të pasqyruara në llogarinë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", paraqiten në vlerën 0 lekë.
Vlera totale e llogarisë 4342 "*Te tjera operacione me shtetin*"(Të drejta) për shumën 2,193,350 lekë në aktiv të bilancit është e njëjtë me llogarinë kundër parti në pasiv të bilancit, në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".
***- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"*** Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" del se, në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 është 0 lekë. Nga verifikimi i 2bërë dhe nga analizimi e kësaj llogarie rezulton se në mbyllje të bilancit vjetor 2020 është 83,180 lekë dhe paraqet detyrimin e dëmit ekonomik lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018 dhe i përket 2 ish punonjësve (2x 41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para periudhës 2018 dhe konfirmohet se janë detyrime të pa likuiduara edhe gjatë periudhës së auditimit. Si rrjedhim vlera e detyrimit nga të tretët rezulton e hequr padrejtësisht nga kontabiliteti i njësisë dhe duhet pasqyruar në periudhën në vijim. Veprimi *në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 32.*
**Situata:** Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" del se, në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 është 0 lekë. Nga verifikimi i bërë dhe nga analizimi e kësaj llogarie rezulton se në mbyllje të bilancit vjetor 2020 është 83,180 lekë dhe paraqet detyrimin e dëmit ekonomik lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018 dhe i përket 2 ish punonjësve (2x41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para periudhës 2018 dhe konfirmohen se janë detyrime të pa likuiduara edhe gjatë periudhës së auditimit. Si rrjedhim vlera e detyrimit nga të tretët rezulton e hequr padrejtësisht nga kontabiliteti i njësisë dhe duhet pasqyruar në periudhën në vijim. Veprimi *në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 32.*
**Kriteri:** UMFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika *32.*
**Ndikimi/Efekti:** Mos funksionimi llogarisë 468, përbën risk lidhur me saktësinë dhe ndikon në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e detyrimet e lindura të konstatuara.
**Shkaku:** Moszbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.
**Rëndësia:** E lartë
**II Aktivet Afatgjata materiale (AAM)**
Formati nr.1 **Aktivet Afatgjata.** Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 13,100,218 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,970,705 lekë, rezulton me ulje prej 2,129,513 lekë, si rezultat i ndikimit të vlerës së amortizimit të AAGJ materiale. "Aktivet

Afatgjata" zënë rreth 75% të totalit të aktivit, krahasuar me vitin 2021 që zinin 71%. Në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.3 : "AAM" Lekë

| ref e llogarisë | Emërtimi | Viti 2022 | Vti 2021 | Diferenca (22-21) |
|---|---|---|---|---|
| | **2.Aktive Afatgjata materiale** | **10,970,705** | **13,100,218** | **(2,129,513)** |
| 212 | Ndërtesa e Konstruksione | 4,460,880 | 4,695,663 | **(234,783)** |
| 214 | Instalime teknike, makineri e paisje | 2,253,643 | 2,894,553 | **(640,910)** |
| 215 | Mjete Transporti | 3,130,340 | 3,912,925 | **(782,585)** |
| 218 | Inventar ekonomik | 1,125,842 | 1,597,077 | **(471,235)** |

Burimi: ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024)

***Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtime konstruksione"*** në 31.12.2022 në mbyllje të vitit 2021, paraqitet në vlerën neto 4,695,633 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 4,460,880 lekë, pra rezulton me zbritje prej 234,783 lekë. Për vitin 2022 nuk janë bërë shtesa, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit (me normën 5%) në vlerë 5,051,730 lekë. Vlera e ndërtesave në kosto historike përbëhet nga:

- Zyra dykatëshe DSHP Fier 3,371,483 lekë kalojnë në ARM Fier
- Magazina e parkut 488,441 lekë kalojnë në ARM Fier
- Zyra DSHP Lushnje 3,605,596 lekë kalojnë në IKMT
- Sektori Qendër, Lushnje 52,800 lekë kalojnë në IKMT
- Zyra DSHP Ballsh 1,994,290 lekë kalojnë në IKMT

Gjithsej 9,512,610 lekë dhe në Vlerë Neto 4,460,880 lekë.

Nga analiza e vlerës së kësaj llogarie rezulton se nuk është pasqyruar realisht vlera e aktiveve në pronësi të subjektit pasi:

a) Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtime e konstruksione" përfshihen tre godina në vlerë 5,652,686 lekë, të cilat duhet t'i kishin kaluar IKMT-së, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së "*Kalim në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM*". Në zbatim të tij nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit ka dalë Urdhër nr. 244 datë 05.05.2020 të "Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të automjeteve, inventarit ekonomik si dhe të gjithë arkivën e institucionit" dhe sipas procesverbalit nr.877 prot., datë 06.07.2020 është bërë dorëzimi i 5 godinave (në administrim të ISHMPUT Fier) në kosto historike 9,512,610 lekë, tek Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër. Sipas shpjegimeve nga ana e vet subjektit janë marrë në dorëzim të gjitha godinat, sepse në korrik 2020, periudhë kur nisi funksionimin e saj, ishin shpërbërë institucionet e përfshira në ristrukturim dhe nuk kishin drejtues, vulat e tyre qenë dorëzuar dhe komisioni i dorëzimit nuk kishte të drejtën e kompetencën ligjore të dorëzimit të tyre jashtë institucionit.

Nga ana e Agjencisë Rajonale së Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër janë bërë kërkesa për kalimin e 3 godinave, sipas Urdhrit të Ministrit të MTM-së, konkretisht:

- Drejtuar IKMT-së me nr. 620 prot., datë 26.01.2021, për të cilën nuk ka përgjigje.
- Nëpërmjet email-it zyrtar drejtuar MTM-së, datë 29.05.2023 përgjigja e së cilës është se: *kalimi i godinave pranë IKMT-së ka qenë vetëm për efekt përdorimi dhe jo kalim në inventarë dhe vlerë kontabël dhe se në bilancin e përgjithshëm të MTM-së këto godina rezultojnë në inventarin dhe llog ek.212 të ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër*.

b) Në lidhje me këtë llogari, nga grupi i auditimit u kërkuan dhe u verifikuan dhe titujt e pronësisë të këtyre elementëve, për t'u siguruar në lidhje më kushtin e aktiveve, që është zotërimi ekonomik i tyre, ku rezultoi se nuk ka Certifikatë për vërtetim pronësie e për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK). Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu (VI) "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme" dhe

veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" me ndryshime, Kreu (III), pika 5 dhe Kreu (II), pika (16).

**Situata:** Nga analizimi i llogarisë 212 "Ndërtime konstruksione" rezultoi se, përbëhet nga vlera e 5 godinave në kosto historike në total për 9,512,610 lekë marrë nga ISHMPUT Fier nga procesi i ristrukturimit sipas Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së "Kalim në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM" dhe se nuk është pasqyruar realisht vlera e aktiveve në pronësi të subjektit pasi:

a) Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtime e konstruksione" përfshihen tre godina në kosto historike në vlerë 5,652,686 lekë, të cilat duhet t'i kishin kaluar IKMT-së, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së. Nga ana e Agjenicisë Rajonale së Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër janë bërë kërkesa për kalimin e 3 godinave, referuar Urdhrit të Ministrit të MTM-së, por nuk është insistuar më për sqarimin me ministrinë përgjegjëse nga ajo varet MTM, në lidhje me zbatimin e Urdhrit të Ministrit të MTM-së Nr.54 datë 24.02.2020, në mosrespektimin me UMF nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu (II), pika (16): Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik, pika 16.*

b) Nga verifikimi i titujve të pronësisë të këtyre aktiveve, rezultoi se nuk ka Certifikata për vërtetim pronësie e për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK).

**Kriteri:** UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu (II), pika (16): Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik pika 16; urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së "Kalim në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM-së".

**Ndikimi/Efekti:** Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të drejtë për llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione".

**Shkaku:** Mos sistemi i strukturës drejtuese në lidhje me zbatimin e urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së.

**Rëndësia:** E lartë

*Gjendja e* ***Llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"*** në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 2,894,553 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 2,253,643 lekë, pra rezulton me zbritje prej 640,910 lekë.

Nga analiza e vlerës së kësaj llogarie, konstatohet se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv pasi:

- Vlera kontabël e këtij zëri në aktiv të bilancit paraqitet më pak në shumën 50,969 lekë, diferencë që vjen nga paraqitja gabim në çelje në kosto historike e vlerës së këtij zëri(më shumë për 110,304 lekë) në Formatin 7/b, "Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Vlerë neto)", krahasuar me paraqitjen e tij në Formatin 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Kosto historike)" dhe e përdorimit gabim të normës së amortizimit (llogaritur më shumë në total për 161,273 lekë). Nga krahasimi edhe me bilancin e vitit të mëparshëm del se gabimi është në paraqitjen e këtij zëri aktivi në Formatin 7/b, gjë e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit. E detajuar paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.4 : Llog. ek. "214" Lekë

| "214" | Kosto hist | Am. Akum | Tep.Neto | Shtesa 2022 | Am Vjet | N/Am % | Am.Akum | Tep Neto |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sipas Formati 7/a | 5,777,683 | 2,883,130 | 2,894,553 | 110,304 | 589,941 | 20% | 3,473,071 | **2,414,916** |
| Sipas Form 7/b | 5,887,987 | 2,883,130 | 3,004,857 | 110,304 | 751,214 | 25% | 3,634,344 | 2,363,947 |
| Ndryshimet | 110,304 | - | 110,304 | - | 161,273 | | 161,273 | (50,969) |

Burimi: ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024)

- Në përllogaritjen e amortizimit vjetor të zërit "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune", rezulton se subjekti ka përdorur normën 25% dhe jo normën 20%, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" pika 36.
-Nuk është llogaritur amortizimi për shtesat e vitit 2022 me vlerë 110,304 lekë (dy aparate të matjes së trashësisë së qeseve plastike, amortizimi në vlerë 11,030 lekë) marrë me Urdhër të brendshëm nr.155, datë 12.07.2022 të Drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare së Mjedisit.
- Procesverbali marrjes në dorëzim është hartuar dhe firmosur nga vet drejtori z. D.V., dhe jo nga komisioni i marrjes në dorëzim, në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "*Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara: 42 dhe 43.*
-Gjithashtu një pjesë e aktiveve të regjistruar në këtë llogari janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë (507,233 lekë nga DRM Vlorë+892,513 lekë nga ISHMPUT Fier), duke mos iu referuar nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik, për të cilat norma e amortizimit 25% është përllogaritur drejt, por jo në llogarinë 218 "Inventar ekonomik", pra pa ndikim material në pasqyrat financiare.

Tabelë nr. 5 për pajisje kompjuterike, përfshirë gabim në llog.214 që duhet të kalojnë në llog.218 lekë

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Cmimi | Sipas të dhënave kontabile | | Sipas të dhenave të inventarit | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sasia | Vlera | Sasia | Vlera |
| 1 | Printer skaner 2 | copë | 27,840 | 1 | 27,840 | 1 | 27,840 |
| 2 | Printer | copë | 17,550 | 1 | 17,550 | 1 | 17,550 |
| 3 | Printer + skaner | copë | 23,934 | 1 | 23,934 | 1 | 23,934 |
| 4 | Kompjuter hp 400pc | copë | 94,461 | 1 | 94,461 | 1 | 94,461 |
| 5 | Kompjuter hp pc | copë | 61,600 | 1 | 61,600 | 1 | 61,600 |
| 6 | Kompjuter copmpakt | copë | 65,424 | 2 | 130,848 | 2 | 130,848 |
| 7 | Kompjuter kompakt | copë | 151,000 | 1 | 151,000 | 1 | 151,000 |
| 8 | Printer | copë | 42,561 | 1 | 42,561 | 1 | 42,561 |
| 9 | Faks printer | copë | 22,029 | 1 | 22,029 | 1 | 22,029 |
| 10 | Kompjuter | copë | 66,590 | 2 | 133,180 | 2 | 133,180 |
| 11 | Kompjuter HP pc printer | copë | 231,581 | 3 | 694,743 | 3 | 694,743 |
| | **TOTALI** | | | | | | **1,399,746** |

Burimi: Zyra Finacës ARM Fier.

**Situata:** -Nga analiza e vlerës së këtij zëri të aktivit rezulton se vlera kontabël në aktiv të bilancit paraqitet më pak në total në shumën 50,969 lekë, diferencë që vjen nga paraqitja gabim në çelje në kosto historike e vlerës së këtij zëri (paraqitur më shumë për 110.304 lekë) në Formatin 7/b, "Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Vlerë neto)", në krahasim me paraqitjen e tij në Formatin 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Kosto historike)" si dhe e përdorimit gabim të normës së amortizimit (në shumën totale 161,273 lekë), gjë e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" pika 36. E analizuar sipas tabelës nr.4.
- Nuk është llogaritur amortizimi (11,030 lekë) për shtesat e vitit 2022 me vlerë 110,304 lekë, marrë aktive pa pagesë nga transferimet e brendshme, me Urdhër të brendshëm nr.155, datë 12.07.2022 të Drejtorit të përgjithshëm të AKM-së.
-Një pjesë e aktiveve të regjistruar në këtë llogari janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë, të cilat duhet të kalojnë në llogarinë 218 "Inventar ekonomik", pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është përllogaritur drejt me normën 25 % dhe jo 20%, duke mos iu referuar kështu nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik.
-Një pjesë e aktiveve të regjistruar në këtë llogari janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë, të cilat duhet të kalojnë në llogarinë 218 "Inventar ekonomik", pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është përllogaritur drejt me normën 25 % dhe jo 20%, duke mos iu referuar kështu nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik.

**Kriteri:** UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" pika 36; UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pikat 42,43,50.
**Ndikimi/Efekti:** Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të drejtë për llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune".
**Shkaku:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore.
**Rëndësia:** E lartë
*Gjendja e* ***llogarisë 215 "Mjete transporti"*** në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 3,912,925 lekë 2,894,553 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 3,130,340 lekë, pra rezulton me zbritje prej 782,585 lekë, si rezultat i vlerës së amortizimit. Për çdo element të kësaj llogarie është përdorur norma e amortizimit 20%, mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018.
Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se në llogarinë 215 "Mjete transporti" janë të evidentuara vlerat e 5 mjeteve të transportit, të marrë nga ISHMPUT Fier, jo në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së *"Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM*", përkatësisht:

Tabela nr.6 : llog.215 "Mjete transporti" Lekë

| Destinacioni | Emërtimi mjetit | Ngjyra | Targa | Cmimi | Origjina e mjetit |
|---|---|---|---|---|---|
| ARM Fier | Hynday Tuscon | Bardhë | A...S | 2,871,938 | ISHMPUT Durrës |
| ARM Fier | Land Rovere defender | Bardhë | A...E | 4,406,510 | ISHMPUT Fier |
| ARM Fier | Land Rover discovery | Jeshil | TR...H | 3,391,347 | ISHMPUT Fier |
| ARM Fier | Toyota Land Cruiser | Gri | TR...A | 3,977,160 | ISHMPUT Gjirokastër |
| ARM Fier | Mitsubish Pajero | Blu | TR...J | 3,002,069 | ISHMPUT Vlorë |
| | **Total** | | | **17,651,524** | |

Burimi: ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit.
a) Urdhri Nr.54, datë 24.02.2020 i Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit përcakton se automjeti me targë TR..H tip Land Rover defender, jeshile marrë nga Ishmput Fier me vlerë 3,391,347 lekë, kalon në pronësi të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër. Më pas, sipas procesverbalit datë 02.12.2020, ky automjet ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë (ADZM), jo konform rregullave dhe ligjshmërisë së lëvizjes së aktiveve, pasi në dokumentacionin e paraqitur rezulton se:
- nuk ka të dokumentuar dhe administruar urdhër nga titullari i organit qendror për t'i kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë;
- Procesverbali i dorëzimit (nr.prot s'ka), datë 02.12.2020 miratuar nga ish drejtori z. A. V. i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk përcakton gjendjen teknike të automjetit dhe nuk është nënshkruar nga dy prej tre anëtarëve të komisionit të dorëzimit: z.P.T. (firmosur), z.B.F. (pa firmosur) dhe z.E.B. (pa firmosur) dhe pa nënshkruar nga dy prej tre anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të ADZM-së Divjakë: z. S.K. (firmosur), z. F. P. (pa firmosur) dhe z. D.N. (pa firmosur), në kundërshtim me pikat 36,*42,43* të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- Automjeti rezulton në kontabilitetin e njësisë dhe nuk është bërë dalje nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër dhe në praktikën e lëvizjes së automjetit nuk rezulton të ketë fletëhyrje nga ADZM Divjakë. Sipas shpjegimeve të subjektit kalimi i mjetit bazohej tek po i njëjti Urdhër me Nr.54, datë 24.02.2020 i Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, por bashkëlidhur ishte tabela ku cilësohej dhe gjendja jo e mirë e tij, ndërsa i kalonte **AKZM**-së, pra ndryshe nga urdhri në fillim që i kalonte Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër. Nga grupi i auditimit u kërkua dokumentacioni i plotë dhe zyrtar me ndryshimet e kalimit të automjetit, i cili nuk na u konfirmua deri në përfundim të auditimit. Veprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ***pika 39, 55, 56***.
b) Në llogarinë 215 "Mjete transporti" nuk është shtuar vlera për pjesë këmbimi-motorr për automjetin A...NS, që rezulton nga shërbimi i përgjithshëm i kryer në vitin 2021, i kryer në vitin 2021 në shumën 362,400 lekë, sipas Faturës tatimore nr.33 datë 19.08.2021 dhe

Fletëhyrjes nr.10 datë 19.08.2022. Bazuar në periudhën e kryerjes së shërbimit rezulton se vlera e amortizimit të llogaritur del 102,680 lekë (për vitin 2021 në shumën 30,200 lekë dhe për vitin 2022 është në shumën 72,480 lekë), pra vlera kontabël e tij del 259,720 lekë (362,400 lekë-102,680 lekë), veprime këto në kundërshtim me Skk Nr. 5 – Aktivet Afatgjata Materiale Dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale - Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja, paragrafi 4 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, "Aktivet afat gjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa *"b"*.

**<u>Situata:</u>** Nga analiza e vlerës së llogarisë 215 "Mjete Transporti" rezultoi se, në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë e aktivit për automjetin i kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, në mos respektim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

-Nuk ka të dokumentuar dhe administruar urdhër nga titullari i organit qendror për t'i kaluar Administratës së Zonave të Mbrojtura Divjakë. Procesverbali i dorëzimit (nr. prot s'ka), datë 02.12.2020 miratuar nga ish drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk është i konfirmuar nga të gjithë anëtarët e komisionit të të dy njësive (dorëzuese dhe marrëse), *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 36,42,43.*

Po i njëjti Urdhër përcaktonte fillimisht kalimin e automjetit tek Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër dhe më pas kaluar tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), ndërsa në fakt rezulton që ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë (ADZM), duke mos lënë gjurmët e auditimit, në kundërshtim *me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 39,55,56.*

-Nuk është shtuar vlera për pjesë këmbimi-motor për automjetin A...NS, që rezulton nga shërbimi i përgjithshëm i kryer në vitin 2021, në shumën 362,400 lekë. Bazuar në periudhën e kryerjes së shërbimit rezulton se vlera e amortizimit të llogaritur del 102,680 lekë, veprime në kundërshtim me *Skk Nr. 5 – Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale - Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja, paragrafi 4*; *UMF nr. 8, datë 9.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 Klasa 2, "Aktivet afat gjata ", përbërja dhe trajtimi kontabël, germa 'b'.*

**<u>Kriteri:</u>** UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 36,42,43 dhe pikat 39,55,56; Skk Nr. 5 – Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale - Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja, paragrafi 4; UMF nr. 8, datë 9.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 11, aneksi 1,pika 2 Klasa 2, "Aktivet afat gjata ", përbërja dhe trajtimi kontabël, gërma "b"; Urdhri Nr.54, datë 24.02.2020 i Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>** Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 215 "Mjete transporti" .

**<u>Shkaku:</u>** Moszbatimi i kërkesave ligjore.

**<u>Rëndësia:</u>** E lartë.

*Gjendja e* ***llogarisë 218 "Inventar ekonomik"*** në 31.12.2022 në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën neto 1,597,077 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën neto 1,125,842 lekë, pra rezulton me zbritje prej 471,235 lekë. Për çdo element të kësaj llogarie është përdorur norma e amortizimit 20%, mbi vlerën e mbetur.

Nga analiza e vlerës së llogarisë 218 "Inventar ekonomik" konstatohet se në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv pasi:

a) Kostoja historike e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në bilanc të vitit 2022 në Pasqyrën Statistikore Formati nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Vlera Neto) paraqitet

në vlerën 10,445,958 lekë, ndërsa në Pasqyrën Statistikore në formatin 7/b Gjendja dhe Ndryshimet AAGJ (Koso historike) paraqitet në vlerën 10,335,654 lekë dhe se krahasuar me paraqitjen në bilancin e vitit 2021 rezulton në vlerën 10,445,958 lekë, pra me ndryshim më pak në vlerën 110,304 lekë.

Tabela nr.7 : "218" "Inventar ekonomik" Lekë

| | | **Kosto Historike** | | |
|---|---|---|---|---|
| **Llog.218** | Bilanci viti 2021 | Sipas Bilancit Formati 7/b | Sipas Bilancit Formati 7/a | Ndryshimi |
| | 10,445,958 | 10,335,654 | 10,445,958 | **-110,304** |

Burimi: ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në shtesa, pikësime, të cilat ndryshojnë vlerën e aktivit dhe janë pasqyruar në bilanc në formatin nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata*:*

b) shtesat e aktivit rezultojnë nga transferime brenda sistemit në shumën 68,040 lekë (2 copë tabletë lenove në shumën 68,040 lekë) me fletëhyrje datë 14.04.2022, me Urdhër Nr.145, datë 14.04.2022 të Ministrit të MTM. Procesverbali marrjes në dorëzim pa nr. prot, datë 27.04.2022 nuk është kryer nga komisioni i marrjes në dorëzim së Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, por nga ish drejtori z. A. V. dhe dorëzuesi znj. B. B. në cilësinë dorëzues nga AKM (jo me *komision dorëzimi), dhe me fletëdalje nr.2, datë 27.04.2022 të saj, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 42,43.*

c) Janë paraqitur pakësimi në vlerën 241,920 lekë (si pasojë e vjedhjes së 3 copë kasaforta) te ish zyrat e pyjores Mallakastër dhe me Vendim të Prokurorisë për pezullim të hetimeve drejtuar Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër me nr.16767/1 prot, datë 24.11.2023 mbi denoncimin e bërë në datë 28.10.2022 nga p/financës z. P.T. është pushuar çështja, dhe është çregjistruar nga kontabiliteti, më parë se nga data e daljes e Vendimit të pezullimit të hetimit (2023), pa bërë dalje, në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 pika 32*;* UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 39.

d) Një pjesë të aktiveve të regjistruar në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë që i përkasin llog.218 "Inventar ekonomik" të cilat janë përllogaritur drejt me 25%, por jo në llogarinë 218 " Inventar ekonomik". Gjithashtu në këtë zë aktivi rezultojnë pajisje kompjuterike në vlerën prej 3,328,098 lekë, për të cilat nuk është zbatuar norma e amortizimit 25%, por janë llogaritur në grup me 20%, veprime këto në mos respektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, "Aktivet Afatgjata" 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 2 i AAGJ , pika "f".

e)Vlera prej 702,834 lekë inventar ekonomik marrë nga ISHMPUT Fier nga ristrukturimi në vitin 2020 ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë (ADZM), dhe rezulton në kontabilitetin e njësisë.

-Procesverbali i dorëzimit nr. prot s'ka, datë 28.10.2020, i pa firmosur nga një prej tre anëtarëve të komisionit të dorëzimit dhe firmosur nga të dy anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, të caktuar në këtë procesverbal. Në dokumentacionin e paraqitur mungon urdhri i titullarit të njësisë për kalimin e këtyre aktiveve në ADZM Divjakë; aktmarrëveshja e dy institucioneve për kalimin e këtyre aktiveve; nuk ka fletëdalje të ARM-së dhe fletëhyrje të ADZM-së. Procedura e ndjekur në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 34 39, 55, konkretisht:*

f) Vlera prej 66,590 lekë i përket një radio moto rola Rading – GR 500 66590, e cila me procesverbal nr .prot s'ka, datë 27.10.2020, konfirmuar nga ish drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë dhe rezulton i pa firmosur nga dy prej tre anëtarëve të komisionit të dorëzimit dhe i pa firmosur nga asnjë anëtar i komisionit marrjes në dorëzim së ADZM Divjakë të cilësuar në këtë procesverbal; aktivi rezulton në kontabilitetin e njësisë dhe nuk rezulton të jetë përpiluar

fletëdalje nga ARM Fier dhe fletëhyrje e njësisë marrëse, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 34. 39,43,55.*

**Situata:** Nga analizimi i vlerës së llogarisë 218 "Inventar ekonomik" rezulton të jetë paraqitur me vlerë më pak për 110,304 lekë. (sipas Tabela nr.9 : "218" "Inventar ekonomik").

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në shtesa, pakësimi, të cilat ndryshojnë vlerën e aktivit dhe janë pasqyruar në bilanc në formatin nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë:

b) shtesat e aktivit rezultojnë nga transferime brenda sistemit në shumën 68,040 lekë, por nuk janë marrë nga komisioni i marrjes në dorëzim, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 42,43.*

c) Pakësime në vlerën 241,920 lekë dhe janë çregjistruar nga kontabiliteti, më parë se nga data e bërjes dalje të këtij aktivi, në kundërshtim me Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 32; *UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 39.*

-Amortizimi për këtë klasë llogarie bëhet në grup dhe jo për çdo zë më vete dhe nuk detajohet amortizimi nga shtesat e pakësimit në vitin 2022.

-Nga llogaria 218 "Inventar ekonomik" janë transferuar (pa pagesë) aktive në shumën 769,424 lekë tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, të cilat sipas listës rezultojnë në kontabilitetin e njësisë, nuk janë bërë dalje, në kundërshtim *me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 3 kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pikat 34, 39,43,55, konkretisht:*

a) Vlera prej 769,424 lekë inventar ekonomik nuk është bërë me procesverbal të rregullt dorëzimi, ku të jenë nënshkruar nga të dy komisionet e njësive, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 42, 43.*

-Një pjesë të aktiveve të regjistruar në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë të cilat janë përllogaritur drejt me 25%, por jo në llogarinë 218 "inventar ekonomik". Gjithashtu në këtë zë të aktivit rezultojnë pajisje kompjuterike në vlerën prej 3,328,098 lekë, për të cilat nuk është zbatuar norma e amortizimit 25%, por janë llogaritur në grup me 20%, në mosrespektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 36.

**Kriteri:** *me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 42,43,39,34,36,55;* Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 32;

**Ndikimi/Efekti**: Pasqyrat financiare nuk paraqesin informacion të saktë për llogarinë 218 "Inventar ekonomik".

**Shkaku:** Moszbatimi i kërkesave ligjore.

**Rëndësia**: E lartë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1554 prot., datë 06.06.2024 nga Z. P. T. me detyrë Përgjegjës Financës konceptuar nga Z. D. V. me detyrë drejtor i komanduar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

-Plotësimi i bilancit dhe aneksesve të vitit 2021.2022, janë kryer sipas udhëzimeve përkatëse me asistencë të specialistëve të drejtorisë ekonomike të MTM-së dhe vërejtjet e grupit të auditimit të KLSH-së i kemi pasqyruar në bilancin 2023 si dhe po përfundojmë inventarët.

-Për automjetin me targë TR...H, janë bërë të gjitha veprimet hyrje-dalje me Zonat e Mbrojtura Divjakë. Në lidhje me kalimin e objekteve Lushnjë dhe Ballsh vijojnë komunikimi me IKMT Fier.

Kontrata e qerasë për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 me z. S.R. në cilësinë qiradhënës, për ambient pune në Gjirokastër, ku tatimi i mbajtur në burim i mbahet qiramarrësit. Kjo kontratë për neglizhencë të protokollit u mbajt pa firmën e z. S.R.. Personalisht kam kontaktuar me z S.R. dhe është nënshkruar deklaratë noteriale nr. 1779, datë 31.05.2024 ku rezulton të jetë firmosur edhe kontrata e vitit 2020. Gjobat nga mosdeklarimi i rregullt për tatimin e mbajtur në burim, janë aplikuar si shkak i mosdijes nga ana ime.
Në lidhje me sasinë e karburantit të harxhuar për 1772 litra naftë në vlerë 420,794 lekë, mendoj se institucioni ka funksionuar dhe dokumentacioni vërtetues është paraqitur me vonesë.
Faturat e energjisë elektrike janë kryer me vonesë. Pasi nuk kanë ardhur me postë dhe se fondet për shpenzime në vitin 2021 janë përdorur për mirëmbajtje automjeti.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Paraqitja dhe raportimi financiar i bilancot të vitit 2022 është hartuar ne kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".*

*-Inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike nuk është realizuar për asnjë vit inventarizimi, në kundërshtim me pikën nr. 73,74, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Ligji nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" neni 15; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30.*

*-Kalimi i automjetit me targë TR...H, është në mos respektim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Nuk ka të dokumentuar dhe administruar urdhër nga titullari i organit qendror për t'i kaluar Administratës së Zonave të Mbrojtura Divjakë. Procesverbali i dorëzimit nuk është i konfirmuar nga të gjithë anëtarët e komisionit të të dy njësive (dorëzuese dhe marrëse), në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 36,42,43. Po i njëjti Urdhër përcaktonte fillimisht kalimin e automjetit tek Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër dhe më pas kaluar tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), ndërsa në fakt rezulton që ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë (ADZM), duke mos lënë gjurmët e auditimit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 39,55,56.*

*- Mospagesa korrekte e faturës së energjisë elektrike në afatin e duhur dhe vlerën e e saj është në mosrespektim me pikën 151 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", dhe në Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023",*

***4.** Kontrata e qiramarrjes me nr.1036 prot., datë 28.07.2020 për një ambient, mjedis pune në Bashkinë Gjirokastër, nuk përmbush elementët ligjorë të një kontrate të vlefshme, pasi nuk është nënshkruar nga pala qiradhënëse, në kushte të mosrespektimit të nenit 801 të Kodit Civil. Gjithashtu likuiduar edhe tatim i mbajtur në burim, ndërsa neni 11 i kontratës e përcakton si detyrim të palës qiradhënëse. Kjo kontratë e risjellë nga ju është firmosur nga pala qiradhënëse me Deklaratë noteriale Nr Rep. 1779, Nr.kol 1017 datë 31.05.2024, jashtë periudhës 2020 dhe pagesës nga ana juaj.*

*-Sasia e karburantit të harxhuar për 1772 litra naftë është e pajustifikuar me dokumentacion vërtetues, fletudhëtim, në kundërshtim me pikën 36 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Dokumentat e bashkëlidhur nuk është bindës dhe vërtetuar, pasi nga grupi i auditimit është insistuar deri ditën e fundit të auditimit për paraqitjen e dokumentacionit shoqërues, dhe se nuk e kishit, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1560 prot., datë 07.06.2024 nga Z. D. V. me detyrë drejtor i komanduar, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me rekomandimin për inventarizimin e pronës, shpjegon se detyra e drejtorit është ngritja e grupeve të punës, të cilat janë ngritur.

Përsa i takon rekomandimit për trajnimin e punonjësve shpjegoj se cdo punonjës mund të ndjekë trajnimet që ofron APSA.

Në lidhje me harxhimin e karburantit, është risjellë procedura e karburantit. Gjithashtu vë në dijeni se jam komanduar si drejtor prej datës 04.05.2022.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojme se: Nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur dokumenta të tjera plotësuese, të cilat të argmentojnë dhe vërtetojnë pretendimet mbi rekomandimet e lëna, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

## Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Tabelë nr. 9 Pasivet

| Referenca e Llogarive | E M Ë R T I M I | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| B | P A S I V E T(DETYRIMET) | | | |
| | I.Pasivet Afat shkurtra | 2,193,350 | 3,716,550 | -1,523,200 |
| | II.Pasivet Afat gjata | - | - | |
| C | AKTIVET NETO/FONDET | 12,478,031 | 14,607,544 | -2,129,513 |

Burimi: ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024).

### Pasivet Afatshkurtra

Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,193,350 lekë 716,550 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 118,790,646 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

-*Gjendja e llogarisë* ***42 "Detyrime ndaj personelit"*** paraqitet në vlerën kontabël 1,723,221 lekë përfaqëson detyrimet e njësisë në lidhje me pagat dhe shpërblimet e punonjësve, janë detyrimet që i përkasin muajit dhjetor 2022, e do të paguhen në fillim të muajit pasardhës.

-Gjendja e llogarisë ***431 "Detyrime ndaj shtetit tatim taksa"*** paraqitet në vlerën kontabël 113,325 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit pasardhës.

-Gjendja e llogarisë ***435 "Sigurime shoqërore"*** paraqitet në vlerën kontabël 296,450 lekë, janë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor 2022 që do të paguhen në Janar të vitit pasardhës.

-Gjendja e llogarisë ***436 "Sigurime shëndetësore"*** paraqitet në vlerën kontabël 60,354 lekë, janë detyrimet për kontributin e sigurimeve shëndetësore për muajin dhjetor 2019 që do të paguhen në Janar të vitit pasardhës.

Krahasuar me listë pagesat e muajit dhjetor të vitit 2022 dhe me evidencën e shpenzimeve të muajit janar të vitit 2023, vlerat e llogarive 42, 431, 435, 436 rakordojnë dhe janë të njëjta me përmbledhësen e listë pagesave dhe evidencën e shpenzimeve.

### C. Fondet Neto

Tabela nr.10 "Fondet neto" Lekë

| Referenca e Llogarive | E M Ë R T I M I | Viti 2022 | Viti 2021 | Diferenca 22-21 |
|---|---|---|---|---|
| 103 | **Fondi neto** | 12,478,031 | 14,607,544 | (2,129,513) |
| 101 | Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 12,478,031 | 14,607.544 | (2,129,513) |

Burimi:ARMFier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024)

*Llogaria 101* ***"Teprica (Fondi i akumuluar) deficiti i akumuluar",*** tregon lëvizjet e aktiveve afatgjata: shtesa, blerje, nxjerrje jashtë përdorimit, konsumi si dhe ndryshimin e gjendjes (llogaria 603). Kjo llogari është e pasqyruar në pasqyrën e Pozicionit Financiar (si edhe në Formatin 4 Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me Kosto Historike dhe Vlerë neto. Në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,478,031 lekë, krahasuar më një vit më parë është ulur me 2,129,513 lekë.

**a. Pasqyra e Performancës Financiare (F2)**

Pasqyra e performancë Financiare përfshin të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës kontabël.

Kjo pasqyrë për njohjen ë elementëve të të ardhurave dhe shpenzimeve është mbështetur në kërkesat e pikës 8 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, konkretisht:

- Shpenzimet janë njohur në çastin e ndodhjes së tyre dhe
- Të ardhurat në çastin e arkëtimit të tyre, pra me bazë cash.

Të ardhurat nga Granti korrent i brendshëm paraqiten në shumën 31,806,184 lekë përgjatë vitit 2022 dhe përfaqësojnë të hyra nga buxheti i shtetit të transferuar nga MFE dhe MTM, konfirmuar rakorduar me degën e thesarit.

Tabela nr.11: "Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare" Lekë

| Ref e llog | Emërtimi | 2022 | 2021 | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| A | Të Ardhurat | 31,806,184 | 33,438,241 | (1,632,057) |
| 720 | Nga buxheti për NJQP(Qendrore) | 29,612,834 | 30,073,534 | (460,700) |
| 7206 | Financim pritshëm nga buxheti | 2,193,350 | 3,364,707 | (1,171,357) |

Burimi: ARMFier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024)

- *Gjendja e* ***llog. 7206*** *"Financim i pritshëm nga buxheti",* në vlerën prej 2,193,350 lekë përbëhet nga vlera e detyrimeve nga vlera e detyrimeve të dhjetorit të pa likuiduara për shpenzime personeli për paga (600) prej 1,723,221 lekë, për kontribute Sigurimeve shoqërore e shëndetësore prej 356,804 lekë, për tatimin ndaj të ardhurave në vlerën 113,325 lekë.

Po kështu shumat e paraqitura në gjendjet e llogarive të shpenzimeve të konstatuara sipas natyrës të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuara në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor në akt- rakordimit e me degën e thesarit plus detyrimet e mbetura të palikujduara në fund të vitit ushtrimor minus detyrimet likuiduara për vitin paraardhës.

**Zëri Shpenzime**

Tabela nr. 12 "Shpenzimet në Pasqyrën e Përfomancës të ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër" Lekë

| Ref llog | Emërtimi | 2022 | 2021 | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| **B** | **SHPENZIMET** | **31,806,184** | **33,438,241** | **-1,632,057** |
| **600** | **I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE** | **21,930,340** | **26,541,558** | **-4,611,218** |
| 6001 | Paga, personel I përhershëm | 21,149,562 | 26,541,558 | |
| 6002 | Paga personel I përkohshëm | 780,778 | | |
| 6003 | Shpërblime | | | |
| 6009 | Shpenzime te tjera për personelin | | | |
| **601** | **II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE** | **3,655,474** | **4,309,994** | **-654,520** |
| 6010 | Kontributi I Sigurimeve Shoqërore | 3,283,373 | 4,309,994 | |
| 6011 | Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore | 372,101 | | |
| **602** | **III.BLERJE MALLRA E SHERBIME** | **5,650,370** | **2,525,220** | **3,125,150** |
| 6020 | Materiale zyre e te përgjithshme | 540,942 | 79,766 | **461,176** |
| 6021 | Materiale dhe shërbime speciale (Posta) | 483,942 | 64,390 | **419,552** |
| 6022 | Shërbime nga te trete | 157,000 | 72,000 | **85,000** |
| 6023 | Shpenzime transporti | 912,632 | 105,417 | **807,215** |
| 6024 | Shpenzime udhëtimi | 1,612,000 | 1,158,772 | **453,228** |
| 6025 | Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme | 1,500,900 | 48,000 | **1,452,900** |
| 6026 | Shpenzime për qiramarrje | 251354 | 49,000 | **202,354** |
| 6027 | Shpenzime për detyrime për kompensime legale | | 22,910 | **-22,910** |
| 6028 | Shpenzime të lidhurame huamarrje | | 904,965 | **-904,965** |
| 6029 | Shpenzime te tjera operative | 191,600 | 20,000 | **171,600** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 603 | **IV.SUBVECIONE** | | | **0** |
| | **V.TRANSFERIME KORRENTE** | | | **0** |
| **606** | **3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë** | **570,000** | | **570,000** |
| 6060 | Transfertë te paguara nga ISSH e ISKSH | 570,000 | | **570,000** |
| | **VI.SHPENZIME FINANCIARE** | - | - | - |
| | ***IX.SHPENZIME TE TJERA (INVESTIME)*** | **0** | **0** | **0** |

Burimi:ARMFier/Vlorë/Gjirokastër; Përpunuar nga grupi i auditimit (2024)

Shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare ARM Fier gjatë vitit 2022 janë në shumën 31,806,184 lekë, ku të ndara sipas kategorive paraqiten si më poshtë:

*Llogaritë e klasës **600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"*** në shumën 21,930,340 lekë përbëhen nga:

- *Llogaria **6001"Pagat, Personel i përhershëm"*** në shumën 21,149,562 lekë. Për këtë kategori, gjatë vitit 2022 është bërë dhe rakordomi me Degën e thesarit.
- *Llogaria **6002 "Pagat Personel i përkohshëm**"* në shumën 780,778 lekë. Për këtë kategori pagash janë bërë dhe rakordimet me Degën e thesarit.

*Llogaria **601 "Kontribute për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore**"* paraqitet në shumën 3,655,474 lekë, e cila është llogaritur në përputhje me kërkesat e akteve ligjore ne fuqi.

*Llogaria **602 "Mallra dhe shërbime të tjera"*** paraqitet në shumën 5,650,370 lekë,

Peshën specifike më të lartë në shpenzime e zë zëri "shpenzime udhëtimi", rreth 29% të totalit të shpenzime në fakt, dhe zëri " Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme", rreth 27% të totalit të shpenzime në fakt, i cili përfshin shpenzime për "Mirëmbajtje e zakonshme për mjetet e transportit, kompjuterëve, pajisjeve të zyrës, etj.

Llogaria **606 "Transfertë në buxhetet familjare dhe individët",** paraqitet në shumën 570,000 lekë dhe përfshin shpenzimet dhënë punonjësve sipas VKM nr. 898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës".

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 31,806,184 lekë dhe kuadrin me totalin e shpenzimeve në vlerë 31,806,184 lekë.

**C. Pasqyra e Flukseve Monetare (Cash Flow)**

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike gjatë periudhës, duke mundësuar dhënien e informacionit në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veçmas ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit. Pjesa e papërdorur nga buxheti në shumën 2,455,170 lekë derdhet në bushtin e shtetit. Kjo pasqyrë, nga ana e ARM-së është përgatitur sipas metodës direket dhe rakordon me Degën e thesarit. Gjatë vitit 2022 rezulton se:

***Nga aktiviteti i shfrytëzimit:***

Flukset hyrëse kanë qenë 33,090,000 lekë

Flukset dalëse në shumën (30,634,830) lekë

***e. Pasqyra statistikore nr. 8 "Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave".***

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave" është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 "Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave".

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave" është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 "Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave.

Tabela nr.13 "Pasqyra statistikore nr. 8" Lekë

| Nr | Kategoria | Nr mes | Pranuar të rinj | Larguar gjatë vitit | Gjendja në fund | Fondi i pagave | Ndihma | Kontribute | Tatim mbi të ardhurat |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drejtues | | | | 1 | 645,600 | 10,000 | 167,856 | 37,128 |
| 2 | Spec.arsim të lartë | | | 6 | 30 | 20,503,962 | 520,000 | 3,487,618 | 1,390,872 |
| 6 | Punonjës të përkohshëm | | | | 2 | 780,778 | 40,000 | | |
| | **Shuma** | | | **6** | **33** | **21,930,340** | **570,000** | **3,655,474** | **1,428,000** |

Burimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, Përpunuar nga grupi i auditimit.

**Shënimet shpjeguese**

Pasqyra e Shënimeve Shpjeguese (F5) nuk paraqitet e plotë dhe nuk përmban as kërkesat minimale të plotësimit të saj, në kundërshtim më përcaktimet e aneksit nr. 2 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022.

Mungon informacioni në lidhje me politikat kontabël të përdorura, bazat e vlerësimit të elemente të pasqyrave, shënime specifike mbi elementët siç kërkohet në SKK-të përkatëse.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 9- Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues; neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues.

*Për shkeljet e konstatuara në lidhje me pasqyrat financiare mbajnë përgjegjësi z. P. T. me detyrë P/Sektorit të Shërbimit dhe Financës, z D. V. me detyrë drejtor i komanduar prej datës 04.05.2022 e në vazhdimësi.*

***<u>Inventarizimi i pronës shtetërore dhe paraqitja e saktë e tyre në pasqyrat financiare.</u>***

<u>Me Urdhër Nr.54, datë 24.02.2020</u> të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit "*Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM*" është bërë kalimi në përgjegjësi administrimi i godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të degëve rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Turizmit (ISHMPUT) dhe të drejtorive rajonale (DRM) Fier, Vlorë, Gjirokastër tek Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) Fier, Vlorë, Gjirokastër.

Me Urdhër nr.244, datë 05.05.2020 të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit "*Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të automjeteve, inventarit ekonomik si dhe të gjithë arkivën e institucionit*" janë caktuar personat përgjegjës dorëzues nga ISHMPUT-të përfshirë në procesin e ristrukturimit. Nga titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër me Urdhër nr.2 dhe nr.855 prot., datë 02.07.2020 "Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të automjeteve, inventarit ekonomik dhe të gjithë arkivin e institucionit të ish ISHMPUT-së Dega Rajonale Fier" është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga z.P.T. (kryetar), z.E.B. dhe z.B.F. (anëtar), i cili nuk ka zbatuar në të gjitha rastet rregullat e duhura e të përcaktuara të marrjes në dorëzim të aktiveve, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar pika 36, konkretisht:

1. Nga ISHMPUT Fier me procesverbal nr.877 prot., datë 06.07.2020, janë marrë në dorëzim 5 godinat,1 automjet dhe inventarit ekonomik.
2. Nga ISHMPUT Vlorë, me procesverbal nr. s'ka, datë 15.09.2020 janë marrë në dorëzim 1automjet, ndërsa aktivet e tjera janë marrë sipas fletë inventarëve të kësaj drejtorie, pa mbajtur procesverbal të marrjes në dorëzim.
3. Nga ISHMPUT Gjirokastër, me procesverbal nr.1574 prot., datë 24.09.2020 janë marrë në dorëzim 1automjet, ndërsa aktivet e tjera janë marrë sipas fletë inventarëve të kësaj drejtorie, pa mbajtur procesverbal të marrjes në dorëzim.
4. Nga DRM Fier, aktivet janë marrë në dorëzim sipas fletë inventarëve të kësaj drejtorie, pa mbajtur procesverbal të marrjes në dorëzim.
5. Nga DRM Vlorë me procesverbal nr.1326 prot., datë 03.09.2020 janë marrë në dorëzim inventar ekonomik dhe pajisje zyrash.

6. Nga DRM Gjirokastër me procesverbal nr.1475 prot., datë 17.09.2020 janë marrë në dorëzim inventar ekonomik dhe pajisje zyrash. Në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë:

Tabelë nr.14 Përmbledhëse inventarësh

| Automjete | |
|---|---|
| Origjina e mjetit | Vlera |
| ISHMPUT Durrës | 2,871,938 |
| ISHMPUT Fier | 7,800,357 |
| ISHMPUT Gjirokastër | 3,977,160 |
| ISHMPUT Vlorë | 3,002,069 |
| **TOTAL** | **17,651,524** |

| Godina | | |
|---|---|---|
| Zyra 2 katëshe DSHP Fier | 3,371,483 | Kalim te ARM Fier |
| Magazina e parkut | 488,441 | Kalim te ARM Fier |
| **TOTAL ARM FIER** | **3,859,924** | |
| Zyra DSHP Lushnje | 3,605,596 | Kalim te IKMT |
| Sektori Qendër Lushnje | 52,800 | Kalim te IKMT |
| Zyra DSHP Ballsh | 1,994,290 | Kalim te IKMT |
| **TOTAL IKMT** | **5,652,686** | |
| **TOTAL** | **9,512,610** | |

| Inventar Ek & Instal tek,makin. Pajisje, .pune | | |
|---|---|---|
| Emërtimi | Llog.218 | Llog.214 |
| ISHMPUT Fier | 4,799,041 | |
| DRM Fier | 594,168 | |
| DRM Gjirokastër | 561,286 | |
| DRM Vlorë | 1,024,001 | 507,233 |
| ISHMPUT Gjirokastër | 945,812 | |
| ISHMPUT Vlorë | 2,482,498 | 5,270,450 |
| **TOTAL** | **10,406,806** | **5,777,683** |

Burimi: Szyra e Financës, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër,

Nga titullari i njësisë për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitet 2021, 2022 dhe 2023 janë nxjerrë urdhra për kryerjen e inventarizimit, përkatësisht:

Për vitin 2021 me shkresë nr. 1626 prot., dhe nr.1627 prot, datë 29.04.2021 ka dalë Urdhër i brendshëm nr.10, nr.11, "Për vlerësim asetesh" i ish titullarit z. A. V., në përbërje të cilit janë caktuar 3 persona z. P. T. (kryetar), zj .S. J. dhe zj .A. K. (anëtar). Në urdhër nuk përcaktohet afati i përfundimit të procesit të inventarizimit.

Komisioni i ngritur për këtë qëllim me shkresë nr. 3315 prot., datë 10.09.2021 i ka kërkuar vënien në dispozicion të procedurës së kryer së inventarizimit për vazhdimin e mëtejshëm të vlerësimit të aseteve të institucionit.

Për vitin 2022 me shkresë nr.1660 prot, datë 06.06.2022 ka dalë Urdhër nr.5, "Për kryerjen e inventarizimit" titullari i njësisë z. D. V. ka ngritur komisionin e inventarizimit të aktiveve të vitit 2022 në përbërje të të cilit janë caktuar 5 persona: z.P.T. (kryetar), z.A. B., z. I.M., z. A.H., z.E. Sh. (anëtarë). Në urdhër nuk përcaktohet afati i përfundimit të procesit të inventarizimit.

Për vitin 2023 me shkresë nr. 3178 prot, datë 25.10.2023 ka dalë Urdhër nr.22, "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër" titullari i njësisë z. D. V. ka ngritur komisionin e inventarizimit të aktiveve të vitit 2023 në përbërje të cilit janë caktuar 5 persona: z. A. H. (kryetar), z .A. B., z. I. M., z. K. L., z. A .G. (anëtarë). Në urdhër nuk përcaktohet afati i përfundimit të procesit të inventarizimit. Me shkresë nr.3671 prot., datë 18.12.2023 ka dalë Urdhër i brendshëm nr.28 "Për mbarëvajtjen e procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër" ku urdhërohet p/sektorit të shërbimeve dhe financës të jetë në dispozicion të komisionit të ngritur për këtë qëllim. Gjithashtu p/sektorit të shërbimeve dhe financës urdhërohet për përfundimin e procedurave të daljeve të materialeve në zonën Lushnjë, Vlorë, Gjirokastër si dhe të automjetit tip "Land Rover Defender" me targë TR...H. Në urdhër nuk përcaktohet afati i përfundimit të procesit të inventarizimit dhe NZ nuk është kryetar i komisionit të inventarizimit e vlerësimit të aktiveve në pronësi të institucionit. Procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve e materialeve të vitit 2023 ishte në proces gjatë periudhës së auditimit.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, konstatohet se, nuk është realizuar për asnjë vit inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve të njësisë, në kundërshtim me parashikimin në pikën nr. 73,74, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Ligji nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" neni 15; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30, duke krijuar kështu një risk të lartë në kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, për ata që i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

-Në urdhërat e titullarit të vitit 2023, NZ nuk është caktuar kryetar komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pika 99.

-NZ nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar Kreun III, paragrafi nr. 26, 28 dhe 30.

-Me Urdhër nr. 22 prot, datë 25.10.2023, NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit e Inventarizimit. Komisioni ka në përbërje tëtij z .A.H. (anëtar), z. A.B. (anëtar), z. I.M. (anëtar) të cilët rezultojnë anëtarë të Komisionit të Inventarizimit edhe në vitin paraardhës 2022, veprime në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 84.

-Nga ana e NZ nuk janë përgatitur listat e aktiveve me gjendjen kontabël të tyre dhe t'u jepej komisioneve të inventarizimit, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 81.

-Nga ana e titullarit të njësisë nuk është miratuar rregullore që t'i shërbejë sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të të gjitha aktiveve e objekteve, pajisjeve të ndodhura në zyra, në përdorim të punonjësve, në magazinë që të nxjerrë edhe përgjegjësitë, në kundërshtim me Neni 9,16 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik".

*Për veprime dhe mosveprimet më sipër mbajnë përgjegjësi z.P.T. me detyrë P/Sektorit të Shërbimit dhe Financës, z. D. V. me detyrë drejtor i komanduar prej 04.05.2022 e në vazhdim.*

**Situata:** Komisioni i marrjes në dorëzim i ngritur me Urdhër nr.2 me nr.855 prot., datë 02.07.2020 "Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të automjeteve, inventarit ekonomik dhe të gjithë arkivën e institucionit të ish ISHMPUT-së Dega Rajonale Fier" dhe të DRM-ve nuk ka zbatuar në të gjitha rastet rregullat e përcaktuara të marrjes në dorëzim të aktiveve, konkretisht për ISHMPUT Vlorë, ISHMPUT Gjirokastër dhe DRM Fier, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011* "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, *i ndryshuar pika 36.* Urdhrat e nxjerrë nuk kanë përcaktuar afatin e përfundimit të inventarizimit, si dhe ka pasur parregullsi të tilla si më poshtë:

-Edhe pse nga titullari i njësisë për çdo vit të periudhës audituese 2021-2023, kanë dalë urdhrat për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të njësisë, konstatohet se <u>për asnjë vit nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për</u> ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, duke krijuar kështu një risk të lartë në kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës dhe në evidentimin e nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 25/2018 "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*" neni 15; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar, pikën 73,74; UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" pika 30.

-Në urdhrat e titullarit të vitit 2023, NZ nuk është caktuar kryetar i komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, në kundërshtim *me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pika 99.*

-Me Urdhër nr. 22 prot, datë 25.10.2023, NA ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të inventarizimit ku në përbërje të tij, 3 prej anëtarëve z (A.H, z. A.B, z. I.M) rezultojnë anëtarë të Komisionit të Inventarizimit edhe në vitin paraardhës 2022, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 84.*

-NZ nuk ka mbajtur Regjistrin e Aktiveve, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar Kreun III, paragrafi nr. 26; 28 dhe 30.*

-Nga ana e NZ nuk janë përgatitur listat e aktiveve me gjendjen kontabël të tyre dhe t'u jepej komisioneve të inventarizimit, *në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 81.*
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar neni 9- Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues; neni 12-Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues.
**Kriteri:** Ligji nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin Dhe Pasqyrat Financiare" neni 15; Ligji 10296, datë 08.07.2020 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 9, Neni 12.

***2.3. Mbi auditimin e procedurave për mendimet e dhëna nga ARM, për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, auditim i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM paraprake/ të thelluara).***

Për auditimin e procedurave për dhënie mendimi nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, vlerësimin me ndikim në mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara, si dhe dëgjesat me publikun u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Aplikimet për VNM paraprake/të thelluar;
2. Aplikimet për mjedisi Tipi A/B;
3. Mendimet e ARM-së për VNM paraprake/ të Thelluar;
4. Mendimet e ARM-së për lejet e mjedisit Tipi A/B;
5. Konsultimet me publikun;
6. Ankesat e ardhura në zyrën e informacionit pranë ARM-së.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që;**
Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL" si dhe VKM nr.686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore", Agjencitë Rajonale të Mjedisit japin mendimin e tyre me shkrim Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për aplikimet (Leje mjedisi Tipi A/B, aplikimet për VNM paraprake/të thelluar ) që ndodhen në juridiksionin territorial të tyre.
Referuar formatit për dhënie mendimi për VNM-të, i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr.228 prot., datë 03.02.2016, pika 6 përcakton se; *Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë për kompetencë verifikimin në terren të raporteve të VNM-ve.*
Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në strukturën organizative ka 7 specialistë lejesh mjedisore dhe 1 përgjegjës lejesh mjedisore. Aktualisht, në këtë sektor ka mungesë stafi dhe janë të deleguar nga sektorët e tjerë. Çdo aplikim për leje mjedisi Tipi A/ B dhe aplikimet për VNM paraprake/të thelluar shqyrtohet nga një specialist lejesh mjedisi dhe konfirmohet nga përgjegjësi i sektorit të lejeve të mjedisit.
Subjektet kanë aplikuar për VNM paraprake/të thelluar, nëpërmjet sistemit të lejeve e-Albania. Në rrugë elektronike, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i ka dërguar aplikimet në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. AKM-ja, i ka përcjellë në mënyrë elektronike kërkesat për leje ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastër. Të gjitha kërkesat e subjekteve që kanë ardhur në formë elektronike në ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër ruhen në arkivin e dokumenteve elektronike, gjë që lejon mundësinë e verifikimit të tyre, nëse janë kryer procedurat e përcaktuara në Vendimin Nr.686, datë 29.07.2015"Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore".

- **Aplikimet për VNM paraprake/të thelluar për vitin 2021**

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë, Gjirokastër ka dhënë mendime për VNM paraprake/të thelluar për 219 dosje.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e dhënies së mendimit për subjektet si më poshtë:

Tabelë nr.15, Dhënie mendimi, Viti 2021

| Nr.rendor | Subjekti | Aktiviteti/Veprimtaria | Vendndodhja | Mendimi i ARM Lezhë, Shkodër, Kukës | Verifikimi/Mangësitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | V.A. | Ndërtim objekti magazinë 1 kat (data e ardhjes së aplikimit 08.01.2021) | Fshati Libofshë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.118 prot., datë 14.01.2021) | Verifikimi në terren në datë 11.01.2021. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 2. | B. | Ndërtim i Hec Peshkëpi (data e ardhjes së aplikimit 07.01.2021) | Peshkëpi, bashkia Selenicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.591 prot., datë 21. 01.2021). | Verifikimi në datë 21.01.2021 Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 3. | V. F. | Magazinim frigoriferik dhe magazinim i peshqve (data e ardhjes së aplikimit 13.01.2021) | Njësia administrative Orikum | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 625 prot., datë 26. 01.2021 | Verifikimi në datë 20.01.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 4. | P.e A. | Agroturizëm 2 kate me funksion bujtinë dhe mbarështim shpendësh në Petran Përmet | Bashkia Përmet | Mendim pozitiv (shkresa me nr.782 prot., datë 04. 02.2021 | Verifikimi në datë 03.02.2021 Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 5. | S. C. | Shfrytëzim me karrierë e gurit gëlqeror dhe aktivitetet ndihmëse (VNM e thelluar) | Objekti Kudhës ,bashkia Himarë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.929 prot., datë 19. 02.2021 | Mungon verifikimi në terren. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 6. | S. T. P. | Ndërtimi i impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike me kapacitet të instaluar 3 MË dhe veprave ndihmëse në zonën e karburantit | Njësia administrative Orikum | Mendim pozitiv (shkresa me nr.968 prot., datë 23. 02.2021 | Mungon verifikimi në terren. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 7. | A. S. | Stallë për mbarështimin e shpendëve dhe objektet ndihmëse funksionale | Risili, Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1057 prot., datë 03. 03.2021 | Verifikim në datë 03.03.2021 Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 8. | D. G. | Pikë grumbullimi skrapi dhe demontim makinash | Fshati Belinë, Patos | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1172 prot., datë 17. 03.2021 | Verifikimi në datë 12.03.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 9. | R. 0. | Strukturë hotelerie dhe shërbimi 1-5 kate | Dhërmi | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1502 prot., datë 15.04.2021 (Konc.N. S.) | Verifikimi në datë 09.04.2021. |
| 10. | F.K. | Magazinë për grumbullimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore | Fshati Bubullimë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1608 prot., datë 28. 04.2021 | Verifikimi në datë 27.04.2021. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 11. | S.c. | Shfrytëzim me karrierë e gurit gëlqeror dhe aktivitet ndihmëse | Fshati Kudhës | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 1933 prot., datë 27. 05.2021 (Konc.P. A.) | Verifikimi në datë 27.05.2021 |
| 12. | A. S. Natyral | Shfrytëzim i mineralit gur gëlqeror | Bashkia Dropull, Gjirokastër | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1935 prot., datë 27. 05.2021 | Verifikimi në terren në datë 26.5.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 13. | B. | Instalim i impiantit të magazinimit të skrapit të materialeve plastike dhe metalike | Fshati Marinëz | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2060 prot., datë 03. 06.2021 | Verifikimi në terren në datë 28.05.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 14. | N. | Shfrytëzim i mineralit gëlqeror | Lazarat | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2212 prot., datë 14. 06.2021 | Verifikimi në datë 11.06.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 15. | I.T. | Mol 55 metra në det (data e ardhjes së aplikimit 29.06.2021) | Drimadhes, Dhërmi | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 2719 prot., datë 13. 07.2021 | Mungon verifikimi në terren. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 16. | Gj. | Strukturë me funksion apart.-hotel parkim dhe ambjente ndihmëse nëntokë (data e ardhjes së aplikimit 08.07.2021) | Drimadhes | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2726 prot., datë 13. 07.2021 . | Verifikimi në datë 13.07.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 17. | E.S | Shfrytëzim i inerteve lumore në shtratin e lumit Shushicë (data e ardhjes nga AKM 09.08.2021) | Shtrat i lumit Shushicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3126 prot., datë 18. 08.2021 | Verifikimi në terren në datë 18.08.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 18. | A. G. | Ndërtim industrial magazinë, zyra rrethim | Basshkia Gjirokastër | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3501 prot., datë 04. 10.2021 (Konc.T. Z.) | Verifikimi në datë 04.10.2021 |
| 19. | Sh. H. | Ndërtim i hidrocentraleve mbi lumin Shushicë | Përfshin fshatrat Brataj, Gjorm, Kotë, Drashovicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3502 prot., datë 04. 10.2021 (Konc.N.S.) | Mungon verifikimi në terren |
| 20. | G. C. | Green coast hotel | Palasë, bashkia Himarë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3905 prot., datë 02. 11.2021 (Konc.T. Z.) | Verifikimi në terren në datë 08.10.2021 |
| 21. | Shoqëria koncensionare M. V. | Porti turistik i jahteve Marina Vlorë | Bashkia Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 4396 prot., datë 10 12.2021 | Verifikimi në datë 10.12.2021 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |

- **Aplikimet për VNM paraprake/të thelluar për vitin 2022**

Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër ka dhënë mendime për VNM paraprake/të thelluar për 301 dosje.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e dhënies së mendimit për subjektet si më poshtë:

pë Tabelë nr.16, Dhënie mendimi, Viti 2022

| Nr.rendor | Subjekti | Aktiviteti/Veprimtaria | Vendndodhja | Mendimi i ARM Lezhë, Shkodër, Kukës | Mangësitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | F.B. | Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore (data e ardhjes së aplikimit 05.01.2022) | Fshati Zhupan | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 40 prot., datë 10. 01.2022) | Verifikimi në datë 07.01.2022. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2. | S. t. | Magazinim dhe tregtim artikuj të ndryshëm | Lagjia Karbunarë e poshtme | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 50 prot., datë 10. 01.2022 ) | Verifikimi në datë 10.01.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 3. | Gj. S | Shfrytëzim i zhavorreve në shtratin e lumit Shushicë | Shtrat i lumit Shushicë, Drashovicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.554 prot., datë 23. 02.2022) | Verifikimi në datën 22.02.2022. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 4. | L. | Shpim për furnizim me ujë me përjashtim të shpimit për studimin e stabilitetit të tokës | Kolonjë, Fier | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 557prot., datë 23. 02.2022) | Verifikimi në datë 21.02.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 5. | J. H. | Depot e skrapit të hekurit , përfshirë ato nga automjetet. Instalime për asgjësimin e mbetjeve | Lagjia 18 Tetori ,Bashkia Lushnjë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.948 prot., datë 30.03.2022). | Verifikimi në datë 29.03.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 6. | S.2. | Parku fotovaltaik 2017 | Fshati Povelce, Fier | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1103 prot., datë 12.04.2022) | Verifikimi në datë 12.04.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 7. | E. Z. | Rritja e shpendëve ( VNM e thelluar) | Krutje | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 1121 prot., datë 14. 04.2022) | Mungon verifikimi në terren Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 8. | A. G. | Ndërtim i objektit industrial 1 kat për tu përdorur si pulari | Fshati Drashovicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1132 prot., datë 15. 04.2022 ) | Verifikimi në datë 13.04.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 9. | Q. | Magazinim dhe tregtim artikujt të ndryshëm | Lagjia 'Karbunarë e Poshtme " | Mendim pozitiv (shkresa me nr.319 prot., datë 06. 05.2022 ) | Verifikimi në datë 06.05.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 10. | Sh. | Pikë grumbullimi skrapi dhe demontim makinash | Verbas, bashkia Patos | Mendim pozitiv (shkresa me nr..1551 prot., datë 27. 05.2022 ) | Veifikimi në datë 26.05.2022 Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 11. | D. | Projekti i shfrytëzimit të objektit të gëlqerorëve pllakore, Borsh | Borsh, Sarandë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1624 prot., datë 02. 06.2022 ) | Verifikimi në datë 27.05.2022 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 12. | M.Th. N. | Objekti 2 kate me 1 kat nëntokë , me funksion agroturizmin | Bashkia Dropull, Gjirokastër | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1942 prot., datë 24. 06.2022 ) | Verifikimi në datë 24.06.2022 |
| 13. | E.C. | Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore | Verbas Patos | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2019 prot., datë 01. 07.2022) | Verifikimi në datë 29.06.2022. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 14. | M. F. | Fabrikë uji 1 kat dhe zyra shërbimi 2 kate | Fshati Vermik, bashkia Selenicë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2483 prot., datë 26. 08.2022 (Konc.S.T.) | Verifikimi në datë 25.08.2022. |
| 15. | P. D S. | Hyrja në portin e Sarandës | Bashkia Sarandë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2570 prot., datë 02. 09.2022 (Konc.Jani Vasili) | Verifikimi në datë 31.08.2022 |

- **Aplikimet për VNM paraprake / të thelluar për vitin 2023**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë, Gjirokastër ka dhënë mendime për VNM paraprake/të thelluar për 263 dosje.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e dhënies së mendimit për subjektet si më poshtë:

Tabelë nr.17, Dhënie mendimi, Viti 2023

| Nr. ren dor | Subjekti | Aktiviteti/Veprimtaria | Vendndodhja | Mendimi i ARM Lezhë, Shkodër, Kukës | Mangësitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | M. R. V. | Strukturë akomoduese rezidenciale dhe Marina resort | Zona e portit aktual Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3362 prot., datë 31.10.2023) | Autorizimi në datë 28.10.2023 |
| 2. | E. | Objekti Hotel Port Side | Lagjia Nr.3, bashkia Sarandë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3373 prot., datë 01.11.2023). | Akt verifikim datë 31.10.2022 |
| 3. | B. S. | Shfrytëzim i mineralit gëlqeror të mermerizuar | Brataj, Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3654 prot., datë 22.11.2022). | |
| 4. | Sh. 07 | Shfrytëzim dhe përpunimi i mineralit gur gëlqeror | Bashkia Mallakastër | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3949 prot., datë 16. 12.2022) | |
| 5. | A. I.C. | Shfrytëzim me karrierë gur gëlqeror | Bashkia Mallakastër, njësia administrative Fratar | Mendim pozitiv (shkresa me nr.4036 prot., datë 30. 12.2022) | |
| 6. | D. G. | Objekt banimi dhe shërbimi për akomodime turistike | Luftinjë e sipërme, Memaliaj | Mendim pozitiv (shkresa me nr.35 prot., datë 06. 01.2023) | Verifikimi në terren në datë 05.01.2023 |
| 7. | B.F. | Butrinti Ferm, kompkeks blegtoral | Fshati Cukë, bashkia Sarandë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 382 prot., datë 10.02.2023) | Verifikimi në terren në datë 08.02.2023 |
| 8. | F.V. | Magazinë për grumbullimin , ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore | Novosel, Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr..297 prot., datë 03.02.2023) | Verifikimi në terren në datë 02.02.2023 |
| 9. | O. | Impiant fotovoltaik Orher 2 ME | Njësia administrative Topojë, bashkia Fier | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 872 prot., datë 31.03.2023) | Verifikimi në terren në datë 31.03.2023. |
| 10. | F.K. | Magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh bujqësore | Bashkia Patos, Qarku Fier | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 669 prot., datë 09. 03.2023) | Verifikimi në terren në datë 08.03.2023 |
| 11. | A. I.C. | Shfrytëzim me karrierë i gurit gëlqeror dhe objektet ndihmëse | Njësia Administraitve Fratar, Bashkia Mallakastër | Mendim pozitiv (shkresa me nr.946 prot.., datë 06. 04.2023) . | Verifikimi në terren në datë 06.04.2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12. | E.A.2020 M | Magazinim , grumbullim për produktet bujqësore , fabrikë për prodhimin e vajit të ullirit , grumbullim të mbetjeve jo të rrezikshme të biodegradueshme, përpunim dhe prodhim peletash nga bërthamat e ullirit | Fshati Golem i Madh, bashkia Lushnjë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.992 prot., datë 11. 04.2023) . | Verifikimi në datë 07.04.2023 |
| 13. | D. | Njësi shërbimi 4 kate | Lagjia Loni Dhamo, bashkia Lushnjë | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 1324 prot., datë 05. 05.2023). | Verifikimi në datë 02.05.2023 |
| 14. | M. g. | Terrene sportive dhe ambiente ndihmëse 1 kat | Autostrada "Vlorë-Fier", lagjjia 11 janari | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1352 prot., datë 08. 05.2023) | Verifikimi në datë 03.05.2023 |
| 15. | S. | Strukturë hotelerie 1,2 ,3, dhe 4 kate dhe 2 kate parkim nëntokë | Ksamil, Sarandë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1643 prot., datë 06.06.2023. | Akt kontroll në datë 01.06.2023 |
| 16. | J. k. | Hotel 3 dhe 4 kate me 1 kat nëntokë dhe pishinë | Lagjia "Uji i Ftohtë", bashkia Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.1608 prot., datë 02. 06.2023) | Verifikimi në datë 01.06.2023 |
| 17. | Ll. | Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret | Stan Karbunare, bashkia Lushnjë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2124 prot., datë 05. 07.2023). | Verifikimi në datë 03.07.2023 |
| 18. | O. P. | Magazinim frigoriferik dhe paketim i peshqve | Lagjia Pavarësia, bashkia Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2388 prot., datë 31. 07.2023) . | Verifikimi në datë 28.07.2023 |
| 19. | Dh. K. | Godinë shërbimi dhe banimi 3 kate me 1 kat nëntokë | Fshati Zvërnec | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2867 prot., datë 21. 09.2023) | Veifikimi në datë 14.08.2023. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 20. | R.C. | Magazinë bujqësore | Rruga "Vrion", bashkia Finiq | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2627 prot., datë 29. 08.2023). | Verifikimi në datë 25.08.2023 |
| 21. | E.Gj. | Instalime për rritjen intensive të kafshëve | Fshati Kamcisht, njësia administrativebBu bullimë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2913 prot., datë 26. 09.2023). | Verifikimi në datë 25.09.2023 |
| 22. | M. R. V. | Strukturë akomoduese rezidenciale dhe marina resort ( Blloku 5 dhe blloku 2 ) | Lagjia "Pavarësia", pranë porttit Vlorë | Mendim pozitiv (shkresa me nr.2954 prot., datë 28. 09.2023). | Verifikimi në datë 27.09.2023 . Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 23. | Y. C. S | Shfrytëzim i rezervës ujore për qëllime sanitare | Rruga "Aulona", lagjia 16 prilli | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3037 prot., datë 09. 10.2023) . | Verifikimi në datën 09.10.2023 |
| 24. | A. B. V. | Agroturizëm bujtina 1 deri në 2 kate me podrum dhe objekt ndhmës 1 kat | Fshati Sheq Musalalaj | Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.3019 prot., datë 06. 10..2023) | Verifikimi në datë 06.10.2023. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 25. | M. B. | Për qëllime rekreative turistike pushimi, argëtimi shëndetësore shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje+kënde lojërash, mjedise sportive , vozitje me varkë në liqen, mjedise shplodhëse gabina prej druri, bare- ristorante | Zona e mbrotjur park natyror Syri i Kaltër | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3107 prot., datë 20. 11.2023). | Verifikimi në datë 20.11.2023 |
| 26. | J. V. | Bujtinë me 1,2 dhe 3 kate | Fshati Qeparo | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3493 prot., datë 04. 12.2023) | Verifikimi në datë 01.12.2023. Dokumentit administrativ i mungon siglimi i konceptuesit. |
| 27. | Sh. U.A. | Shesh i ri i pusit në Golemaj | Fshati Golemaj | Mendim pozitiv (shkresa me nr.3357 prot., datë 14. 11.2023). | |
| 28. | T. K. 2000 | Magazinë për ruajtjen e produkteve bujqësore | Fshati Buronjë, bashkia Finiq | Mendim pozitiv (shkresa me nr. 3603 prot., datë 11.12..2023). | Verifikimi në terren në datë 07.12.2023 |

Në çdo aplikim për VNM paraprake/ të thelluar bashkëlidhur gjendet:
-raporti teknik i projektit të propozuar;
-raporti paraprak/ të thelluar i VNM-së;
-akti i regjistrimit të personit fizik/juridik;
-një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit.
-Nga auditimi u konstatua se në ëeb-in e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk është publikuar asnjë raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), nëpërmjet të cilës publiku të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore, kjo në kundërshtim me pikën 1, të Rregullores nr.01, datë 03.03.2017 "Për zbatimin e procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ku përcakton se;*"Për një proces sa më transparent për informimin e publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së dhe marrjen e mendimit nga publiku, punonjësi i autorizuar nga ARM e qarkut përkatës, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për procedurë të VNM-së paraprake, publikon në faqen zyrtare të internetit informacionin e plotë siç ka mbërritur nga zhvilluesi/kërkuesi".*
-Përsa i përket mendimeve, nga specialistët e sektorit të lejeve të mjedisit dhe VNM-ve,mendimi hartohet në një kopje, e cila dërgohet elektronikisht në adresën e drejtuesit të institucionit për tu nënshkruar elektronikisht dhe për tu ngarkuar më tej në sistemin e e-leje. Si pasojë e sulmit kibernetik të ndodhur në Shqipëri në muajin korrik 2022, cdo korrespondencë në formë elektronike (specialistë-titullar institucioni) para kësaj periudhe është fshirë

(konfirmuar me e-mail nga adresa armfier@akm.gov.al në datë 20 shkurt 2024). Nga auditimi rezultoi se nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk është kryer asnjë aplikim për pajisjen me nënshkrim elektronik për specialistët e lejeve të mjedisit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr.9980, "Për Nënshkrimin Elektronik".

**Aplikimet e Lejeve Mjedisore dhe mendimet përkatëse të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër gjatë vitit 2021.**

Mendimet për leje mjedisi Tipi A/B jepen bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.419, datë 25.06.2014 dhe Rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr.120 prot, datë 12.01.2021.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka dërguar një kopje të aplikimit në ARM-në Fier, Vlorë, Gjirokastër, për 598 dosje në total për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, e cila ka dhënë mendimin e saj me shkrim.

Gjatë vitit 2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër ka kryer dhënie mendimi për **222** leje mjedisore Tipi A/B .

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën praktikat si më poshtë:

**1.Subjekti B.(LC-03. )** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant" me vendndodhje në "Lagja 1 Maj", Fier.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresën nr. 4596 prot., datë 29.12.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**Braka**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 28.12.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Çertifikata e mbrojtjes nga zjarri nuk i përket adresës për të cilën subjekti kërkon të pajiset me leje mjedisi.

**2.Subjekti I. T. T.W. F. (LC-7..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Incenerim i mbetjeve urbane jo të rrezikshme". Incenerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim, përveç atij të referuar në pikën 5.1, 5.2.a. Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte me vendndodhje" në Fshatin Mbrostar, Fier.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3113 prot., datë 16.08.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**I.T. T. W. F.**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 12.08.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Procedurës së konsultimit me publikun i ka mbaruar afati (referuar urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM);

2.Mungon leja e përdorimit të ujit (ligji për menaxhimin e integruar të burimeve ujore);

3.Relacioni teknik i mbrojtjes nga zjarri nuk është i firmosur nga specialistë të fushës;

4.Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**3.Subjekti J. -11 ( LC-3.. )** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme" me vendndodhje në Lagja "Afrim i Ri", Fier.

ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër me shkresë nr. 105 prot., datë 13.01.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**J. -11**"sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 23.10.2020.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, mungon pika 1.6 e dokumentit të planifikimit të zonës;

2.Sipas pikës 2 "përshkrimi i instalimit"subjekti nuk ka bashkëngjitur plane, skica të instalimeve;

3. Mungon kopja e mandat-pagesave të kryera (Urdhëri i Ministrit të Mjedisit, nr.163, datë 16.06.2020).

**4.Subjekti Z. K. (LC-3..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin “stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme” me vendndodhje në rrugën "Vasil Talo", Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 106 prot., datë 13.01.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**Z. K.**” sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 23.10.2020.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Në dosje mungon relacioni për dëgjesën me publikun;
2.Subjekti nuk ka dorëzuar vërtetimin për likujdim tarifë vjetore;
3.Subjekti nuk ka dorëzuar raportin e vetmonitorimit;
4. Subjekti nuk ka bashkëngjitur në aplikim kontratatat me dy subjektet që i vetëdeklaron në formularin informues.

**5.Subjekti A.K. (LC-7.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin “Rritje intensive e gjedhit në një instalim” me vendndodhje në Lagja e Stanit, Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2663 prot., datë 07.07.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**A.K.**” sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 07.07.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1. Në dosje mungon relacioni i dëgjesës me publikun;
2. Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
3. Nuk ka leje për përdorimin e ujit;
4. Sipas pikës 2 “Përshkrimi i instalimit” mungojnë skica, planimetri të instalimeve në objekt.

**6.Subjekti L. C. ( LC-6..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin “Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale”. Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar me vendndodhje në Vllahinë, Selenicë, Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2601 prot., datë 02.07.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**L. C.**”sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 23.06.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 2 “Përshkrimi i instalimeve” mungojnë skica, planimetritë e instalimeve të objektit;
2. Mungon kontrata për furnizimin me ujë për proceset e instalimit;
3. Mungon shkresa e Agjencisë Kombëtare e Mjedisit për transferimin e lejes mjedisore;
4.Mungon deklarimi se nuk ka detyrime të papaguara (Urdhri i Ministrit);
5. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**7.Subjekti T. S.(LC-6.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin “Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane. Gaz natyror aromatic ose GLN përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A ose përzierja e aromave”, me vendndodhje Rruga “Fier –Lushnjë”, km.10.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2711 prot., datë 12.07.2021 “Mendim për Leje Mjedisore” ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin “**T. S.**”sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 12.07.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Mungon vetëdeklarimi për shlyerjen e detyrimeve;
2. Mungon vërtetim teknik i projektit;
3. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**8.Subjekti A. S. ( LC-5..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, "Për aktivitetin magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorët e makinave. Lyerja dhe lustrimi i makinave. Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave nqs nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë", me vendndodhje Rruga "Plug", Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1735 prot., datë 11.05.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. S.**". Verifikimi në terren është kryer në datë 09.11.2020.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Dëgjesa me publikun nuk i përfshin të gjitha aktivitetet për të cilën aplikuesi kërkon në formularin e aplikimit;
2. Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
3. Projekti i mbrojtjes nga zjarri nuk është i firmosur nga ekspertë të fushës;
4. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**9.Subjekti E. C. (LC-6..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "magazinim,ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe" me vendndodhje në rruga nacionale "Sarandë-Gjirokastër", km.7.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1955 prot., datë 28.05.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**E. C.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 25.05.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Mungon në aplikim vërtetimi se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet;
2.Sipas pikës 1.6 mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
3.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit"mungojnë skica, planimetri të instalimeve të objektit.
**10.Subjekti V.F. (LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Trajtim dhe magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve" me vendndodhje në rruga nacionale "Vlorë- Himarë", Fushë Dukat.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1014 prot., datë 01.03.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**V.F.**"sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 24.02.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur kontratën me UKT( sic e deklaron në formular) ;
2.Mungon kontrata me subjektin "B.." për pastrimin e mbetjeve dhe ujërave të ndotur;
3.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
4. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**11.Subjekti F. Ch.A. 2019 (LC-9.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Thertore. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve me mënyra të tjera përvec shndërrimit ose incenerimit të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojce" me vendndodhje në Rruga "Fier-Berat".
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3958 prot., datë 05.11.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**F. Ch.A. 2019** " sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 01.11.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;
2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës;
3.Deklarata e paraqitur nga ana e subjektit (se ka shlyer të gjitha detyrimet) është për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant".

**12.Subjekti T. D. (LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Trajtim dhe përpunim i qumështit" me vendndodhje në Konispol, Vlorë.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1580 prot., datë 23.04.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**T. D.**". Verifikimi në terren është kryer në datë 22.04.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1. Raporti i vetmonitorimit nuk është i 6 mujorit të fundit;
2. Mungon shkresa e AKM-së që veprimtaria e subjektit riklasifikohet për leje mjedisi tipi B;
3. Mungon leja e pusit;
4. Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" mungojnë skica dhe planimetri të objektit.

**13. Subjekti V. D. (LC-5.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos" me vendndodhje në Çermë, Proshkë.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1630 prot., datë 29.04.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**V. D.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 28.04.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;

2. Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit " mungojnë planimetria, skica të instalimit.

**14.Subjekti S. ( LC-6..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme. Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave" me vendndodhje Rruga nacionale "Levan–Vlorë".

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresën nr. 2345 prot., datë 17.06.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**S.** "sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 08.06.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Mungon raporti i vetmonitorimit;

2.Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve për pagesat vjetore;

3. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**15.Subjekti S. A. (LC-6..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Përpunim, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ", me vendndodhje Rruga nacionale "Sherisht-Pëshkëpi".

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2519 prot., datë 30.06.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**S. A.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 23.06.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Mungon shkresa e AKM-së që veprimtaria kategorizohet në leje mjedisi Tipi B;

2. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**16.Subjekti A.O. (LC-8..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant" me vendndodhje në fshatin Sheqishtë, Fier.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3696 prot., datë 19.10.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.O.** "sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 19.10.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;

2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës.
**17.Subjekti 2.-2.-L. (LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant" me vendndodhje në Sarandë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 947 prot., datë 22.02.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**2.-2.-L.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 22.02.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Projekti i MKZ nuk është për subjektin aplikues;
2. Mungon një vetëdeklarim i subjektit që nuk ka gjoba të papaguara (Urdhër nr.163, datë 16.06.2020 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit);
3. Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.
**18.Subjekti A.(LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Gaz natyror aromatik ose GLN, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane" me vendndodhje në Lagja "Sheq i Madh", Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1223 prot., datë 25.03.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 12.03.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Raporti mbi sigurinë është për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant", ndërsa subjekti aplikon edhe për aktivitetin "gaz natyror" ;
2.Mungon vetëdeklarimi se subjekti nuk ka gjoba (urdhër nr.163, datë 16.06.2020 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit);
3. Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.
**19.Subjekti A. O. (LC-**5..**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane" me vendndodhje në Sheqishtë, Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1802 prot., datë 18.05.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. O.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 11.05.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Shkresa në aplikim për ndryshimin nga Tipi C në Leje Mjedisi Tipi B nuk është nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
2.Mungon vetëdeklarimi se subjekti nuk ka detyrime financiare;
3.Në pikën 2 "Përshkrimi i instalimit" përshkruhet një subjekt tjetër, ndërsa në aplikim është një subjekt tjetër;
4.Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.

**20.Subjekti D. O. (LC-** 6..**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane" me vendndodhje në Roskovec, Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2351 prot., datë 17.06.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D. O.** " sh.p.k.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Projekti teknologjik në aplikim i përket një subjekti tjetër;
2.Mungon vetëdeklarimi se subjekti nuk ka detyrime financiare (sipas urdhërit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit);

3.Mungon leja ekzistuese e Tipit C në aplikim si dhe faturat bashkëngjitur për tarifat vjetore;
4.Mungon verifikimi në terren.

**21.Subjekti E.G. (LC-** 8.**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave. Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane" me vendndodhje në Gjirokastër.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3989 prot., datë 09.11.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**E.G.**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 08.11.20221.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**1**.Mungon certifikata e pronësisë;
**2**.Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.

**22.Subjekti J. (LC-** 9...**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane" me vendndodhje në fshatin Cukaj i Ri, Lushnjë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3990 prot., datë 09.11.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**J.**" sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 09.11.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;
2.Procesverbali i dëgjesës me publikun nuk ka të gjitha të dhënat si numër ID të banorëve;
3.Kontrata e huapërdorjes është me afat të pacaktuar dhe nuk është në formën e duhur ligjore;
3.Mungon projekti i MKZ;
4.Mungon vërtetimi teknik;
5.Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.

**23.Subjekti K. 2. (LC-** 8..**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përvec incinerimit (5.1a) ose lanfillimit" me vendndodhje në Patos.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3121 prot., datë 17.08.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**K. 2.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 12.08.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Eksperti zjarrfikës nuk e ka regjistruar aktivitetin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit(QKB);
2.Fatura është për vitin 2017, ndërsa aplikimi është në vitin 2022 (nuk ka një vetëdeklarim të subjektit se pagesa është për këtë aplikim (ndërsa në faturë përcaktohet rruga "Konferenca e Pezës", aplikimi është me vendndodhje në Patos);
3.Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;
4.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës.

**24.Subjekti O. (LC-** 0..**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Gaz natyror aromatik ose GNL, përveT rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave. Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane " me vendndodhje në Rrugën "Pelivan Leskaj", Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 4562 prot., datë 23.12.2021 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**O.**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 22.12.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Mungon relacioni i dëgjesës me publikun;
2.Projekti hidroteknik në aplikim i përket subjektit "B.-Oil";
3.Certifikata e sigurisë për zjarrin i përket subjektit "B.-Oil".

**Viti 2022**
**1.Subjekti Xh. (LC-7.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve" me vendndodhje "Lagjia 10 korriku", Rruga "Reshit Osmeni", Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresën nr. 3741 prot., datë 02.12.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**Xh.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 17.11.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit;
2.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
3.Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**2.Subjekti A.S.N.(LC-0..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Nxjerrja e mineraleve, rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim me qiell të hapur dhe nga guroret" me vendndodhje njësia administrative Dropull i Sipërm, Gjirokastër.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 144 prot., datë 19.01.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.S.N.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 13.09.2021.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" subjekti nuk ka bashkëngjitur skica, plane të instalimeve;
2.Subjekti nuk ka bashkëngjitur projektin e MKZ.

**3.Subjekti A. N.(LC-4...)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant. Përzierja e çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos si dhe prodhim i llacit, kollës, gëlqeres" me vendndodhje në rrugën nacionale "Gjirokastër-Kakavijë".
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2253 prot., datë 29.07.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. N.**"sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 22.07.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
2.Subjekti nuk ka bashkëngjitur raportin e mbrojtjes së zjarrit;
3.Subjekti nuk ka bashkëngjitur projekti teknik;
4.Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**4.Subjekti P. (LC-1..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Prodhim dhe fraksionim i produkteve minerale jo metalike" me vendndodhje në fshatin Nivicë, Lukovë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 799 prot., datë 16.03.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**P.**"sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 10.03.2022.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e pronësisë;

2.Në aplikim mungon autorizimi për përdorimin e lëndëve plasëse;
3. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**5.Subjekti I. (LC-6..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat,tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit" me vendndodhje në fshatin Nivicë, Lukovë.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3540 prot., datë 14.11.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**I.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 10.11.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Pika 1.7 e kërkesës për leje mjedisi nuk është plotësuar;
2.Relacioni i dëgjesës me publikun nuk është i plotë .

**6.Subjekti D.-S. (LC-2..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe,por jo në sheshin e ndërtimit përshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos si dhe prodhim i llacit, kollës, gëlqerës" me vendndodhje në Rrugën "Sarandë –Delvinë", km.8.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1027 prot., datë 05.04.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D.-S.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 24.06.2021.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Subjekti ka lidhur kontratë për furnizimin me ujë me një subjekt (J.), i cili në ekstraktin e QKB nuk e ka të rregjistruar aktivitetin e furnizimit me ujë ";
2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës.

**7.Subjekti A.Sh. ( LC-0..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Prodhim i këpucëve" me vendndodhje në " Lagjia 24 Maji", Vlorë.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 361 prot., datë 08.02.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A.Sh.**" sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 04.02.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur në aplikim relacionin e dëgjesës me publikun;
2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
3.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" mungojnë skica,planimetri të objektit;
4.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit.

**8.Subjekti A. Sh.(LC-** 2..**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "**Prodhimi i këpucëve**" me vendndodhje në Fier.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresën nr. 1378 prot., datë 12.05.2022 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. Sh.**"sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 11.05.2022.

**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**

1.Mungon kontrata me subjekte të liçensuara për solventin e përdorur (vetëdeklarim në formularin informues);
2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
3.Subjekti deklaron se përdor ventilarorë me filtra por nuk ka bashkëngjitur fotografi ilustruese.

**Viti 2023**

**1.Subjekti M. ( LC-9..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Përzierja e çimentos ose përdorimi i cimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos si dhe prodhimi

i llacit,kollës dhe gëlqerës. Prodhim dhe fraksionim i produkteve minerale jo metalike". Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3/a pse 7.3/b ose në pika të tjera të kësaj shtojce që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi"me vendndodhje rruga nacionale "Orikum-Dukat" .
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3703 prot., datë 20.12.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**M.**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 19.12.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur relacionin e dëgjesës me publikun;
2.Në formularin informues subjekti përshkruan se ujërat derdhen në gropën septike, por nuk ka fotografi ilustruese.
**2.Subjekti V. (LC-3..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjlës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret" me vendndodhje rruga nacionale "Orikum-Dukat".
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresën nr. 2441 prot., datë 03.08.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**V.**"sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 21.07.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Në dëgjesën me publikun përshkruhet se konsultimi është realizuar si në datën 04.05.2022 dhe 04.05.2023 (nuk ka një vetëdeklarim për vitin kur është realizuar konsultimi);
2.Në aplikim mungon VNM paraprake;
3.Subjekti ka bashkëngjitur në aplikim faturën ( fatura është 10.000 lekë, ndërkohë që duhet të ishte 30.000 lekë);
3.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" mungojnë skica, planimetri të instalimit;
4. Dhënia e mendimit nga ARM-ja është tejkaluar afati i përcaktuar.

**3.Subjekti D.( LC-0..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Rritje intensive e gjedhit në një instalim" në vendndodhje në fshatin Verbas, Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1009 prot., datë 12.04.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**D.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 11.04.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur kopje të VNM;
2.Disa nga banorët që kanë firmosur në dëgjesës me publikun nuk kanë deklaruar numrin e ID (e domosdoshme në procedurën e dëgjesës me publikun);
3.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" mungojnë skica, planimetri të instalimit;
4.Subjekti nuk ka bashkëngjitur në aplikim kontratën për grumbullimin e mbetjeve.

**4.Subjekti P. ( LC-2..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Nxjerrja e mineraleve, rërës, argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret. Prodhim dhe franksionim i produkteve minerale jo metalike" në vendndodhje në fshatin Nivicë, Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 1857 prot., datë 15.06.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**P.**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 15.06.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Në formularin e dëgjesës me publikun, banorët nuk kanë vetëdeklaruar distancën nga objekti;
2.Certifikatë për mbrojtjen e zjarrit i ka kaluar afati;
3.Deklarata mjedisore (që është në aplikim) nuk është e firmosur nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit;
4.Subjekti nuk ka bashkëngjitur lejen për përdorimin e lëndëve plasëse .

**5.Subjekti E. C. (LC-9.)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Magazinim, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe të çimentos në masë të madhe të çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe" në vendndodhje në rrugën nacionale "Sarandë-Gjirokastër".
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 367 prot., datë 09.02.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**E. C.** " sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 08.02.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Në ekstraktin e QKB-së, subjekti nuk ka të parashikuar veprimtarinë për të cilën kërkon të pajiset me leje mjedisi;
2.Në aplikim mungon relacioni i dëgjesës me publikun;
3.Vërtetimi hipotekor është për servis dhe lavazh dhe jo për veprimtarinë për të cilën kërkon të pajiset me leje mjedisi;
4.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
5.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" mungon skica, planimetri të instalimit.

**6.Subjekti G.7. (LC-8..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart", me vendndodhje në Marinëz.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 407 prot., datë 14.02.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**G.7.**" sh.p.k.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur kontratën e qirasë me bashkinë Roskovec;
2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
3.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" nuk është përshkruar proceset për mbetjet jo të rrezikshme;
4.Mungon kontrata me subjekte të licensuara për transportimin e mbetjeve të rrezikshme;
5.Formulari informues nuk është i firmosur nga përfaqësuesi ligjor.
**7.Subjekti H.2.. ( LC-5..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhim i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos si dhe prodhim i llacit, kollës, gëlqeres" me vendndodhje në lagjia "Qazim Pali", Borsh.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2762 prot., datë 11.09.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**H.2..**" sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 30.05.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Certifikatë e pronësisë është për tokë arë;
2.Subjekti nuk ka bashkëngjitur lejen për përdorimin e ujit teknologjik;
3.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës.
**8.Subjekti T. C. ( LC-4..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Veprimtaritë e lyerjes,veshjes, të aplikuara më sipërfaqe druri dhe prodhim i mobiljeve"me vendndodhje në Lagja "Kushtrimi", Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2712 prot., datë 04.09.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**T. C.**" sh.p.k.Verifikimi në terren është kryer në datë 30.08.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
2.Certifikata e pronësisë (në aplikim)nuk është origjinale;

3.Në formularin informues, përshkruhet se subjekti ka lidhur kontratë me subjekte të licensuara për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve, në aplikim nuk është paraqitur dokumenti vërtetues.

**9.Subjekti I. ( LC-7..)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit.Instalime me djegie" me vendndodhje rruga nacionale "Orikum", Vlorë.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 3174 prot., datë 25.10.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**I.**" sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 24.10.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës.
2.Në aplikim mungon kopja e VNM;
3.Mungon kontrata për furnizimin me lëndë të parë;
4.Mungon dëgjesa me publikun;
5.Mungon kontrata për grumbullimin e mbetjeve që prodhohen nga kompania gjatë veprimtarisë.
**10.Subjekti A. C.** (LC- 1..) ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për tu pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Prodhim i letrës dhe/ose i kartonit" me vendndodhje në Drizë, Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresën nr. 2413 prot., datë 01.08.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**A. C.**"sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 11.07.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues mungon dokumenti i planifikimit të zonës;
2.Sipas pikës 2 "Përshkrimi i instalimit" nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi, produktet dhe operacionet e instalimit;
3.Subjekti deklaron se do të përdorë filtra për të reduktuar emëtimet, por nuk ka bashkëngjitur fotografi ilustruese;
4.Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.

**11.Subjekti E.N. G. (LC-**3..**)** ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me Leje Mjedisi Tipi B, për aktivitetin "Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror" me vendndodhje në Frakull, Fier.
ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër me shkresë nr. 2451 prot., datë 04.08.2023 "Mendim për Leje Mjedisore" ka dhënë mendim pozitiv drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për subjektin "**E.N. G.** "sh.p.k. Verifikimi në terren është kryer në datë 03.08.2023.
**Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi:**
**1**.Subjekti nuk e ka të regjistruar vendndodhjen e aktivitetit në QKB;
2.Është tejkaluar afati për dhënien e mendimit drejtuar AKM.
Modeli tip i dhënies së mendimit për leje mjedisi Tipi A/B është miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit , ku në pikën 6 citohet "*Agjencia Rajonale e Mjedisit… pas shqyrtimit të dosjes elektronike dhe /ose verifikimit në terren për aktivitetin….. jep mendimin e saj pozitiv /negativ në lidhje me aplikimin*".
-Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.01.2021-31.12.2023, dosjet e përzgjedhura për dhënie mendimi për leje mjedisi tipi A/ B rezultojnë të jenë me mangësi në dokumentacion, veprime këto që bien ndesh me VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me pikën 5 dhe 9 , kreun VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr.120 prot. datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" ku përcaktohet se;
*Detyrat funksionale të specialistit /inspektorit të sektorit:*
*-rishikimin e dokumentacionit mbështetës të kërkesës për lejet mjedisore;*

*-kërkon informacion shtesë nëse del e nevojshme gjatë aplikimit.*
-Gjithashtu, u konstatua se mendimet përkatëse të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër kanë qenë pozitive si dhe nuk është kryer verifikimi në terren i disa operatorëve që ri-aplikojnë për leje mjedisi Tipi A/B, për të vërtetuar saktësinë e deklarimeve të subjektit në formularin informues**.**
-Nga auditimi rezultoi se nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë,Gjirokastër nuk është koordinuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për vendimet e marra nga Ministri i Mjedisit, kjo në kundërshtim me pikën 5 dhe 9 të kreut VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr. 120 prot., datë 12.01.2021(stafi i ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër është njoftuar për rregulloren e mësipërme në datën 30 mars 2021)**,** ku përcakton se;
*-Mban dhe përditëson regjistrin me të dhënat për lejet që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre;*
*-Mban lidhje me QKB-në duke koordinuar përgjigjet në kohë për aplikimet e marra.*
-Nga auditimi rezulton se afati për dhënien e mendimit drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për lejet e mjedisit Tipi A dhe B është tejkaluar, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", pika 4/b.

- **Konsultimet me publikun**

Në bazë të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 " Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", kreu VI Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të delegojë ARM për të marrë pjesë në procedurën e konsultimit me publikun.Subjekti kur aplikon për t'u pajisur me leje mjedisi Tipi A/B duhet të dorëzojë edhe relacionin edëgjesës me publikun në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë,Gjirokastër ka realizuar **154** dëgjesa me publikun.
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e konsultimeve si më poshtë;
Për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë,Gjirokastër ka realizuar **152** dëgjesa me publikun.
Ndërsa për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë,Gjirokastër ka realizuar **79** dëgjesa me publikun.
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e konsultimeve si më poshtë;
**Çdo praktikë konsultimi me publikun ka bashkëlidhur;**
-Akt verifikimin e mbajtur nga ana e specialistëve të ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër;
-Delegimin e konsultimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
Në akt verifikimet e mbajtura nga ana e specialistëve është përshkruar që pjesëmarrësit në konsultimet nuk kanë patur ankesa/shqetësime për instalimin për të cilën është kryer konsultimi.
-Nga auditimi u konstatua se njoftimi në ëeb-in e ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastër përmban të dhëna si; data e takimit, subjekti,vendi i takimit.
Për sa më lart, njoftimi i dëgjesës me publikun në website http://drmfier.akm.gov.al/ nuk përmban informacionin si " Lloji e instalimit/veprimtarisë" , kriter i rëndësishëm për ecurinë e dëgjesës, veprime që bien në kundërshtim me Vendimin Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B , për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet

kompetente deri në lëshimin e tyre” Kreu VI “ Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të Tipit A dhe B", pika 11, ku përcaktohet se;

*Njoftimi duhet të shoqërohet me:*

*a) llojin e instalimit/veprimtarisë;*

*b) emrin e personit fizik/juridik;*

*c) adresën e vendndodhjes së instalimit;*

*ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi;*

*dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjesës me publikun.*

-Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se raporti i posacëm (procesverbali)nga ana e specialistëve të ARM-së nuk është regjistruar në sekretari në ditën që është zhvilluar dëgjesa më publikun, por është regjistruar pas 10-20 ditësh nga zhvillimi i procedurës, kjo në kundërshtim me Rregulloren nr.1, datë 03.03.2017 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit “Për zbatimin e procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore” pika 10, përcakton se “*Përfaqësuesit e ARM në mënyrë të pavarur mbajnë shënim diskutimet e plota të seancës dhe së bashku me foto përgatitet raporti dhe i dërgohet AKM brenda 5 ditëve nga mbajtja e seancës dëgjimore*”.

- **Ankesat që janë depozituar në sektorin e administrimit të të dhënave dhe përpunimit të informacionit.**

Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër janë trajtuar ankesat që kanë ardhur dorazi dhe me postë.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën ankesat si më poshtë;

**1.** Ankesa e qytetares I. T.,e cila ankohet për ndotjen e shkaktuar nga një baxho (A. T.). Ankesa është depozituar në zyrën e informacionit në ARM, në datë 24.08.2023.

Nga ana e ARM, ankesa është përcjellë për kompetencë në bashkinë Lushnjë(në datë 06.09.2023).

Nga grupi i auditimit u konstatua se për shkak se subjekti ushtron aktivitetin e trajtimit dhe përpunimit të qumështit (ID 7.7/e, sipas shtojcës "Për lejet e Mjedisit"), Agjencia Rajonale e Mjedisit e ka patur si kompetencë verifikimin e ankesës dhe nuk duhej ta përcillte për verifikim një institucioni tjetër.

**2.**Ankesa e qytetares E. C., e cila ankohet për aroma të pakëndshme nga një subjekt restorant. Ankesa është depozituar në datë 17.10.2023 pranë zyrës së informacionit në ARM.

Nga ana e ARM, ankesa është përcjellë për kompetencë bashkisë Fier( në datë 19.10.2023).

**3.**Ankesë e qytetares M. K., për antenat televizive. Ankesa është depozituar në zyrat e informacionit të ARM.Është protokolluar në datë 30.10.2023. Në dosje nuk ka kthim përgjigje.

**4.**Ankesë e qytetarit I. P., datë 02.11.2023, i cili ankohet për ndotjen e mjedisit , ku citon ndër të tjera "*aroma të pakëndshme nga ferrat që kanë mbuluar mjedisin dhe një kanal i bërë nga bashkia në ndarje të tokave bujqësore*". Nga ana e ARM-së është përcjellë shkresë për kompetencë në IKMT Fier, bashkisë Fier, Inspektoratin Qëndror , dërguar më datë 07.11.2023.

Për sa më lart, nga auditimi u konstatua se ankesat e kryera nga qytetarët për trajtimin e tyre nuk i janë dërguar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit , sipas Urdhërit nr. 29, datë 30.08.2023 të Inspektorit të Përgjithshëm “ Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushë inspektuese të mjedisit për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit”, pika 1 përcakton se "*Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit të ushtrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore në përputhje me legjislacionin për parandalimin, mbrojtjen dhe mbikëqyrjen dhe inspektimin në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotja , dëmtime apo ndërhyrje, vetëm për rastet kur konstatohen veprimtari të kundërligjshme të cfarëdo lloji".*

Përsa i përket ankesës së qytetares I. T. ndaj subjektit që ushtron aktivitetin baxho, mungon inspektimi/verifikimi nga ARM i subjektit (A. T.). Theksojmë se ky aktivitet është pjesë e listës

për t'u pajisur me leje mjedisi dhe kjo ankesë duhej trajtuar nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër dhe jo ti delegohej një institucioni tjetër.
Për sa është trajtuar në akt konstatimin nr.3 është paraqitur observacioni me shkresë nr. 979 prot., datë 09.04.2024 nga specialistët e lejeve të mjedisit dhe VNM ku janë shprehur si më poshtë;
Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.108/5, datë 10.06.2024 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga Znj. F. Z. dhe Z.T. Z., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
**Pretendimi i subjektit:**
Lidhur më gjetjen e grupit të auditimit që:
-lejet e mjedisit të tipit A dhe B janë gjetur me mangësi në dokumentacion, sqarojmë se është kompetencë e AKM-së, shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimit për lejet e mjedisit të Tipit A/B ;
-për ri-aplikimet e lejeve të mjedisit nuk është bërë verifikimi në terren, sqarojmë se nuk ka patur ndryshime në instalim.
**Qëndrimi i grupit të auditimit:**
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pretendimet e mësipërme janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme me nr.120 prot., datë 12.01.2021 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale, kreu II.V, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.
**1. Situata:** Nga auditimi rezultoi se, specialistët e sektorit të lejeve të mjedisit dhe VNM-ve hartojnë në një kopje mendimin (për VNM), i cili dërgohet elektronikisht në adresën e drejtuesit të institucionit, për t"u nënshkruar elektronikisht dhe për tu ngarkuar më tej në sistemin e e-leje. Si pasojë e sulmit kibernetik të ndodhur në Shqipëri në muajin korrik 2022, cdo korrespondencë në formë elektronike (korrespondenca specialistë-titullar institucioni) para kësaj periudhe është fshirë (konfirmuar me e-mail nga adresa armfier@akm.gov.al, në datë 20 shkurt 2024).
**Kriteri:** Ligji Nr.9880, datë 25.2.2008 "Për nënshkrimin elektronik", Ligji Nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike", Neni 17/b.
**Ndikimi/Efekti:** Nuk jep garanci për cilësinë e dokumentit elektronik
**Shkaku:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk ka zbatuar detyrimet ligjore për të aplikuar për nënshkrim elektronik për specialistët e lejeve dhe VNM-ve.
**Rëndësia:** E mesme

**2. Mendimet për leje mjedisi Tipi A/B kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion .**
**Situata:** Nga auditimi i 43 praktikave për leje mjedisi Tipi A/B, rezulton se në 43 aplikime janë konstatuar mangësi në dokumentacion. Por nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, mendimet për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit kanë qenë pozitive.
**Kriteri:** VKM nr.419, datë 25.06.2014 dhe rregullorja e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr. 120 prot., datë 12.01.2021 ,kreu II.V pika 1 , 3, faqe 89-90.
**Ndikimi/Efekti:** Si pasojë e mos-shqyrtimit të dokumentacionit për leje mjedisi Tipi A/B, nuk është parandaluar, pakësuar dhe mbajtur nën kontroll ndotja e shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.
**Shkaku**: Moszbatim i legjislacionit në fuqi
**Rëndësia:** E lartë
**3. Situata.** Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për periudhën janar 2021- dhjetor 2023 ka dhënë mendime për VNM paraprake/ të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B, duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk ka marrë

informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.
**Kriteri:** Regullorja e brendshme e Agjencisë Kombëtare e Mjedisit me nr. 120 prot., datë 12.01.2021 ,kreu II.V, pika 9 , faqe 90.
**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e një databaze të përditësuar për lejet e mjedisit në juridiksionin territorial, sjell një anomali në planifikimin e inspektimeve.
**Shkaku**: Moszbatim i legjislacionit në fuqi
**Rëndësia:** E lartë
**4. Situata:** Nga auditimi i 43 praktikave për leje mjedisi Tipi A/B, rezulton se në 17 aplikime është tejkaluar afati 10 ditor për dhënien e mendimit.
**Kriteri:**VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja ", kreu III, pika 2.
**Ndikimi/Efekti:** Shkelja e afateve kohore për dhënien e mendimeve leje A/B , konsiderohet mendim pozitiv në heshtje.
**Shkaku:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi
**Rëndësia:** E lartë
**5.Situata:** Nga auditimi u konstatua se raporti i posacëm(procesverbali)nga ana e specialistëve të ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk është regjistruar në sekretari në ditën që është zhvilluar dëgjesa me publikun , por është regjistruar pas 10-20 ditësh nga zhvillimi i procedurës.
**Kriteri:** Rregulloren nr.1, datë 03.03.2017 të Agjencisë Kombetare të Mjedisit "Për zbatimin e procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore" pika 10.
**Ndikimi/Efekti:** Mospërmbushja e detyrave funksionale
**Shkaku:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi
**Rëndësia:** E lartë
**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**
D. V., me detyrë drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër
B. F., me detyrë specialist i lejeve mjedisore dhe VNM ;
F.Z., me detyrë specialiste e lejeve mjedisore dhe VNM;
T. Z., me detyrë specialist i lejeve mjedisore dhe VNM;
J. V., me detyrë specialist i lejeve mjedisore dhe VNM ( i deleguar);
K. R., me detyrë specialiste e VNM dhe lejeve mjedisore( e deleguar);
G. Zh., me detyrë specialist i VNM dhe lejeve mjedisore( i deleguar);
A. G.,me detyrë specialist e VNM dhe lejeve mjedisore( i deleguar);
S. S., me detyrë specialiste e VNM dhe lejeve mjedisore( e deleguar);
E. B., me detyrë ish-përgjegjëse e lejeve mjedisore ;
P. A., me detyrë ish specialiste e lejeve mjedisore dhe VNM;
N. S., me detyrë ish specialist i lejeve mjedisore dhe VNM.

**2.4. Auditimi i planeve të inspektimit, monitorimeve , kontrolleve të kryera nga Sektori i Inspektimeve të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore (Ujëra )në Agjencinë Rajonale** Mjedisit **Fier Vlorë, Gjirokastër.**
Për auditimin e pikës 4 u **shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**
**1.Planet mujore dhe vjetore,** për viti 2021-2022 dhe vitin 2023 ku përfshihen.
**2.**Programet mujore të miratuar nga Drejtori i ARM-së dhe programet vjetore të miratuara nga Inspektorati Qëndror dhe Ministri i Mjedisit dhe Turizmit.
**3.**Raportet mujore e raportet vjetore të Sektorit të inspektimit të Mjedisit dhe Sektorit të Inspektimit të Ujërave.

**4**.Autorizimet, Procesverbalet e inspektimit, korrespondenca zyrtare me institucionet e tjera, evidencat e mbajtura për vendimet administrative, për inspektimet e kryera dhe dëmet e konstatuara.
Për periudhen objekt auditimi 2021-2022-2023 nga Sektori i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore (Ujërat), janë hartuar dhe janë miratuar nga Drejtori i ARM-së dhe nga Inspektoriati Qendror Tiranë, planet vjetore dhe mujore të inspektimit. Përvec inspektimeve të planifikuara janë kryer dhe inspektime të pa programuara kur ka qenë e nevojshme si në rastet e ankesave, të kërkesës të Bashkisë Fier Vlorë Selenice etj, në raste denoncimesh apo informacioni nga të tretët/në raste rishikimesh etj.Organizimi dhe realizimi i inspektimeve është bërë në bazë të planit mujor dhe autorizimeve, ku këto të fundit janë zbatuar në bazë autorizimesh.

Autorizimet e miratuara për realizimin e inspektimeve nga inspektorët e Sektorit të Mjedisit janë bazuar në ligjin nr.10433 datë 16.06.20011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Sektori i Inspektimit në Mjedis dhe ujrave ka filluar kontrollet në terren për zbatueshmërinë e kushteve të lejeve mjedisore dhe legjislacionit mjedisor në fuqi, në muajin Qershor 2021, 2022,2023, referuar Planit Vjetore mujore të miratuar nga titullari i institucionit.

-Për periudhën objekt auditimi

<u>**Vitin 2021**</u>

Në kuadër të misionit dhe qëllimit të tij Sektori i Inspektimit Mjedisor në përmbushje të kërkesave ligjore
-Vitin 2021, Inspektimet kanë filluar në Qershor 2021, të miratuara rast pas rasti nga Drejtori i Përgjithshem i AKM-së, ka realizuar 148 inspektime**.**
**-Vitin 2022** Inspektimet on-line për sektorin e Mjedisi, janë kryer vetëm 6 muajt e fundit të vitit 2022, pasi nuk janë miratuar planet nga AKM,gjithsej kryer 69 inspektime ,
-Vitin 2023, Inspektimet on-line për sektorin e Mjedisit, gjithesej kryer 119 inspektime.
Janë hartuar plane mujore të inspektimit, por jo të mbështetura në metodologjinë e vlerësimit të riskut duke përcaktuar numrin e akteve të inspektimit dhe subjektet e inspektimit, si dhe të krijojë bazë të dhënash të plota të subjekteve, të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit. Për vitin 2021-2023. Janë përcaktuar dhe tematikat e inspektimeve por nuk është përcaktuar treguesi sasior i inspektimeve, kjo parashikuar në nenin 4 të urdhrit nr 5 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për programimin e inspektimeve" Nuk është kryer analizimi mujore mbi realizimin e inspektimeve sanksionet e vendosura të cilat duhen dërguar brenda dt. 5 të çdo muaji në DIK si dhe brenda dt 20 në Ministri dhe IQ.

Nga Drejtori dhe përgjegjësit e sektorit të Mjedisit dhe Ujërave nuk është bërë analiza për numrin e inspektimeve ,

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se:
**1.** ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk disponon një data bazë për gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në Qarkun Fier, Vlorë, Gjirokastër, të plotësuara me të dhënat si: licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetit, lejet mjedisore etj. Janë bërë përpjekje për marrje të këtij informacioni nga Faqja zyrtare në internet e Qendrës Kombëtare të Biznesit, i cili nuk jep informacion të plotë në lidhje me aktivitetin që ushtron subjekti aktualisht nga gjithë veprimtaritë e regjistruara, adresat si dhe licencat që disponon subjekti. Gjithashtu nuk është bërë e mundur të kryhet korrespondence zyrtare me DRT Fier, për informacion më të detajuar. Për këtë arsye programet vjetore nuk i kanë shërbyer në masë të plotë realizimit të objektivave të institucionit për identifikimin e subjekteve pa leje mjedisore.
-<u>Sektori i Inspektimit Mjedisit dhe Ujërave nuk ka krijuar dosje të përhershme të inspektimit për çdo subjekt të inspektuar kërkesë kjo e Urdhrit të Inspektoratit Qendror Nr.13 datë 23.04.2015"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë" si dhe portalit unik e-Inspektimi", kreut III urdhritnr.432, datë 28.9.2016, "Për</u>

disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.15/2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit e-Inspektimi";

**2.** ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut të subjekteve në sektorin e mjedist dhe të burimeve natyrore (ujrat) që do të inspektohen, me qëllim përcaktimin e subjekteve që kanë risk më të lartë dhe frekuencën e inspektimit gjatë një viti;

-Sipas kërkesave të manualit të inspektimit,sektorët e inspektimit duhet të mbajnë një dosje të përhershme për çdo subjekt, dosje të cilës i referohet për çdo inspektim që do të kryhet, e cila duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo inspektimi me qëllim që të sigurohet përditësimi i përmbajtjes së saj. E cila është edhe pjesë e sistemit elektronik "e-inspektimi", *e cila jo në çdo ratë është plotësuar nga Inspektorët, për inspektimet që kanë kryer në terren.*

**3.**Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër, për relacionet raportet e realizimit të inspektimeve, nga Sektorët Mjedisit dhe Ujërave, ku nga raportimet mujore konstatojmë se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të tabeluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore, veprime në kunsdershtim me ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nenin 7 dhe neni 16 "Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror" pika 2 germat "b" dhe "c" dhe me VKM nr. 568 datë, 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.23, datë 03.02.2020 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" *Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për 6/mujorin e dytë 2020 ,2021dhe vitin 2022.*

**4.** Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacionin i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të të gjitha mangësive të konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. Detyrat që lihen nuk janë të lidhura me konstatimet konkrete të situatës në terren të kryera nga specialistë të fushës së mjedisit. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3, neni 45, ligji nr.10433, datë 16.06.2011 Neni 45, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" në disa raste objekti i inspektimit është i përgjithshem dhe jo sipas objektit të inspektimit të subjektit.

**5.** Përzgjedhja e subjekteve për tu inspektuar nuk kryhet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis, pasi nuk kanë një listë subjekteve të pajisura me leje mjedisore, nga praktikat e përzgjedhura subjektet janë me ndikim të ulët ose të mesëm në mjedis. Veprime që bien në kundërshtim me udhëzimit nr.5 datë 19.02.2015"Rregullat e përgjithshme mbi bazë programimi" i ndryshuar.

**6.** Në shume raste inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet, se nuk gjendet në adresën e dhëne, ose nuk kryen aktivitet. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit "dhe me Ligjin nr.10433 "Inspektimi në Republiken e Shqipërisë".

-Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së ,nuk është zbatuar neni 11"Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi" të ligjit nr. 10431,datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera.

Në formularin e Inspektimit, në paragrafin I "Të dhënat të përgjithshme të subjektit", pika 3 "Lloji i aktivitetit ekonomik" gjenerohet nga sistemi e plotësuar me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet. Gjithashtu nuk janë përcjellë shkresa AKM-së, për subjektet të cilat nuk ushtrojnë aktivitet që të merren masa për pezullim apo revokim të lëjës mjedisore.

-Nga Inspektorët nuk janë kryer në çdo rast veprimet sipas urdhrit nr.26, datë 07.03.2017,"Formati Standard I vërtetësisë së Inspektimit" kap III pika 3,6.

**7.** Sektori i Inspektimit Mjedisor dhe Burimeve të Ujrave në Qarkun e Fier,Vlorë Gjirokastër, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun e Fierit Vlorës Gjirokastrës, ku në bazë të këtyre të dhënave të bëhej identifikimi i subjekteve me risk të lartë me ndikim në mjedis, në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë" dhe nr. 4, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut.

Me poshtë tabela me inspektimet e kryera,si dhe praktikat e audituara.

**<u>Sektori i inspektimit të Mjedisit për vitin 2021-2023,</u>**

Tabela nr. 19 e inspektimeve me plane të mirtatuara dhe të realizuara për vitët 2021-2023

| **Plani i inspektimeve** | **Plani 2021** | **Fakt** | **Plan 2022** | **Fakt 2022** | **Plan 2023** | **Fakt2023** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qershor | 27 | 23 | - | - | 10 | 10 |
| Korrik | 22 | 21 | - | - | 13 | 12 |
| Gusht | 25 | 22 | 2 | 2 | 20 | 18 |
| Shtator | 17 | 18 | 12 | 12 | 24 | 26 |
| Tetor | 20 | 17 | 8 | 8 | 20 | 16 |
| Nëntor | 20 | 21 | 22 | 22 | - | - |
| Dhjetor | 18 | 18 | 1 | 1 | 35 | 45 |
| Totali | 148 | 140 | 69 | 69 | 122 | 119 |

Në vitin 2021,2022,2023, janë miratuar dhe realizuar inspektime, sipas e-maileve të përcjella nga AKM Tiranë,inspektimet kanë filluar, në muajin Qershor sipas vitetve të cilat janë hedhur në sitemin e –inspektimit të miratuar sipas e-malie të përcjella nga AKM.

Nga auditimi me zgjedhje i praktikave në sistem u konstatuan parregullsi, në dokumentacion bashkëlidhur si më poshtë.

**1.** Nga auditimi i kryer në subjeket me veprimtari minerare të hedhura në sitemin unik e-inspektimi, nga 38 praktika të audituara, rezultuan pa rregullësi në dokumentacionin bashkëlidhur në sistem si më poshtë.

- Përkatësisht në 5 raste:

subjektet me veprimtari gurore me shfrytëyim në qiell të hapur,

-në 3 praktika,subjekti nuk ka të miratuar Planin e Rehabilitimit Mjedisor.

-në 2 raste raporetet e monitorimit dhe të vtemonitorimit janë bashkëlidhur në sistem, por nuk kanë nr.e prot.pranë AKM –së, veprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10448 "Për Lejet e Mjedisit", datë 7/14/2011 i ndryshuar, neni 29, Pika 1, Ligjin nr.10463, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", datë 22.09.2011 ,i ndryshuar, nenin 21, pikat 9, 10, dhe nenit 57, si dhe VKM nr. 229, datë 23.4.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit", (ndryshuar me VKM nr. 1031, datë 16.12.2020).

Ligji nr. 10433, datë, 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë",

Urdhri nr. 13, datë , 23.04.2015, Inspektorati Qendror pranë Këshillit të Ministrave,

"Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit" pika 4-6 e manualit të përgjithshëm.

*Tabela nr. 20 me rastet përkatëse*

| **Nr** | **Emërtimi iSubjektit** | **NIPT** | **Aktiviteti** | **Data e inspektimit** | **Insdpektuar nga** | **Problematikat e konstatuara/ detyrat e lena (afatet)** | **Viti 2021-2022 inspektime** | **Viti 2023 inspektime** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A. G. | **L...U** | Industri minerare | AKM-FR-2021000093 06/07/2021 | 1.E. H.2.A. N. | Ne sistem i gjithe dokumentacioni është pa prot të AKM si d, ndaj subj nuk është mamrrë masë | -FR-2022-000018 - 2 Datë: 24/02/2022, A.C., L. I. | Nuk është inspektuar, |
| 2 | C.R | K...D | | Nr. AKM-FR-2021-000184 24/09/2021 | A. H., L. I. | Në ceke liste janë plotesuar të gjitha rubrikat që subjekti plotëson të gjitha kushtet e lm nderkoh,në sistem është shkersa | Nr.AKM-FR-2022-000008,E. Z. A. C.,. *Në sistem mungon pali i rehabilitimit,ndaj* | . --------- |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | nr 1753/1 datë 25.08.2021,miratimprogrami vjetore të punës AKBN, drejtuar CORMIR SHPK, | *subjektit nuk është marrë masë për mos zbatim të kushteve , në këto raste* mospërmbushja e kërkesave të pikës 8 të nenit 50 të këtij ligji, | |
| 3 | M. | J...J | Industri minerare | AKM-FR-2021-000033 - 2 /06/2021 | A.H.<br>L. I. | Në sistem plani i përpuethshmërisë, programi i menaxhimit pa prot të AKM –se, si dhe mungon plani i rehabilitimit i miratuar nga akm. | ---- | M-FR-2023-000056 - 2/1 Datë: 14/08/2023, A. C,. A. H., mungon plai i rehabilitimit i miratuar nga akm. |
| 4 | N.-2010 | | Industri minerare | Nr. AKM-FR-2021-000177 - 17/09/2021 | E. Sh.<br>E. Z. | Në sistem mungon plani i perpuethshmërise, Plani i menaxhimit të mbetjeve si dhe mungon plai i rehabilitimit i miratuar nga AKM, në pv dhe vendim përfundimtarë ndaj subjektit nuk janë marrë masa administrative për shkeljet e konstatuara | FR-2022-000020 - 2/1 Datë: 10/03/2022, nuk ka shkelje të kërkesave ligjore është ok procedura | Nuk është inspektuar, |
| 5 | A. | K.....I | Industri minerare | AKM-FR-2022-000019 | D. V.<br>E. Z. | Ne sistem mungon Plani i rehabilitimit i miratuar nga akm ne pv dhe vendim perfundimttarë nuk janë marre masa administrative | 08/03/2022<br>D.V.,E.Z.<br>Ne sitem raport vet monitorimit19/07/2020deri 19/06/2021pra subj nuk ploteson kushtet e lejes mung plani i rehabilitimit ne pv' Parajlajmrim'' | Nuk është inspektuar |

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të Urdhërit Nr.25 datë 07.02.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në territor", në zbatim të pikës 5.4 të VKM-së Nr.568, datë 17.7.2019,"Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", gjatë periudhës Shkurt – Mars 2022, ka planifikuar dhe realizuar inspektime në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me fokus në aktivitetin e shfrytëzimit të karrireave (gurore) në qiell të hapur, për të verifikuar zbatimin e planeve të rehabilitimit për sipërfaqet e shfrytëzuara.

-Nga ku ka rezultuar se në 28 subjekte të inspektuara në 7 raste, subjekteve është lënë Masa ***Paralajmërim,*** për plotësim dhe paraqitjen pranë AKM-së, të planit të rehabilitimit, por nga ish-titullari nuk janë hartuar progame pune për ri-inspektim të subjeteve për detyrat e lëna, këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin Nr.10 433, datë 16.6.2011"Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV rregulla të përgjithshme për programimin dhe autorizimin e inspektimit, neni 26 Kohëzgjatja vjetore e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë pika 1, nenin 45-48 dhe me Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit",neni 29, pika1/ii,"Kundërvajtjet" dhe Urdhrin Drejtori Përgjithshëm Nr. 25 datë 07.02.2022 {Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin e problematikave mjedisore të veprimtarive minerare me karriere (gurore) në territor si dhe Rregulloren e brendshme nr.120, datë 12.01.2021, Detyrat Funksionale të Drejtorit, sipas rregullores të ARM-së nga pika 1, deri në pikën 17 të rregullores, për të cilët mbajnë përgjegjësi, ish- Drejtoritë të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, si dhe ish/përgjegjësja e sektorit Mjedisit F.B. , për periudhën Janar 2021 deri në 30 Prill 2022.

*Tabelë nr. 21 Subjektet si më poshtë.*

| Nr | Emërtimi i Subjektit | NIPT | Aktiviteti | Data e inspektimit | Insdpektuar nga | Problematikat e konstatuara/ detyrat e lëna Viti 2022 (afatet) | Viti 2023 inspektime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **F.** | **K...M** | **Industri minerare** | AKM-FR-2022-000021 | D.V.<br>A. H. | Subjekti duhet te paraqesi pranë AKM planin e rehabilitimit per miratim dhe te filloje rehabilitimin e objektit minerar.<br>Dënim administrativ kryesor: **Paralajmërim** | ---- |
| 2 | A. | K...I | Industria minerare | AKM-FR-2022-00001908/03/2022 | D. V.<br>E.Z. | Ne sistem mungon Plani i rehabilitimit i miratuar nga AKM NE PV DHE VENDIM PERFUNDIMTTARË nuk janë marre masa | ---- |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | administrative , **Parajlajmrim''** | |
| 3 | N. E S. P. FIER | K...K | Industria minerare | AKM-FR-2022-000005 | E.Z.<br>E. Sh. | Subjekti duhet të paraqesi pranë AKM planin e rehabilitimit për miratim dhe të fillojë rehabilitimin e objektit minerare.<br>Dënim administrativ kryesor: Paralajmërim | ------ |
| 4 | M.-GJ." SHPK | K...H | AKM-FR-2022-000017 | D. V.<br>E. Z. | **Urdhër nga Drejtori Përgjithshëm Nr 25 datë 07.02.2022 "** | Subjekti duhet te paraqesi pranë AKM planin e rehabilitimit per miratim dhe te filloje rehabilitimin e objektit minerar.,<br>Dënim administrativ kryesor: Paralajmërim | ------ |
| 5 | "SH. 07" | K...Ë | Industria minerare | **A.C., E. B.** | -FR-2022-000191 - 15/09/2022 | Subjekti duhet të paraqesi pranë AKM planin e rehabilitimit per miratim dhe te filloje rehabilitimin e objektit minerar.,Dënim administrativ kryesor: Paralajmërim | Është inspektuar ne sitem dhe rezulton që ka plotësuar kushte e lejes Mjedisore, |

*Burimi: Sektori mjedisit ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër*

**2.** Nga të dhënat dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion në ARM Fier Vlorë, Gjirokastër, në 8 subjekte me veprimtari të ndryshme konstatohet se nuk kryejnë aktivitet, por në sistem online, mungon dokumentacion informues dhe vërtetues. Veprime jo në përmbushje të Nenit 36- *Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d";* me Ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", për të cilët mbajnë përgjegjësi, *Drejtori i Agjencisë Rajonale, si dhe përgjegjësi i sektorit ë Mjedisit F. B..*
Tabela nr.22 Subjektet me aktivitet të ndryshme, të cilat nuk ushtrojnë aktivitet sipas inspektimeve.

| **Nr** | **Emërtimi i Subjektit** | **NIPT** | **Aktiviteti** | **Data e inspektimit** | **Insdpektuar nga** | **Problematikat e konstatuara/ detyrat e lena (afatet)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | K.. 2018 | K...E | Industri minerare | 25.02.2022 | 1.A. C.<br>2.L. I. | Nuk ushtron aktivitet,ne sistem mungon dokumentacioni që vertetue psh (Foto te subjektit ) |
| 2 | P. | K...E | Industri minerare | AKM-FR-2022-000015-225/02/2022 | 1.D. V.<br>2.E. Z. | Subjekti nuk u kontaktua dhe nuk u paraqit asnje person pergjegjes. Makinerite ishin te fikura, në sistem nuk kishte foto te subjektit per të vertetuar që subjketi nuk ushtron aktivitet në vendim përfundimtare nuk jane marrë masa administraive |
| 3 | A. | J...K | Prodhim dhe tregtim materiasle ndërtimi | M.Hoxha<br>A.Xhkaj<br>I.Maze | AKM-FR-2021-000066-1 | Nuk ushtron aktivitet |
| 4 | G... 2 Shpk | K...M | Material Inert | A.Xhakaj<br>M.Hoxha<br>I.maze | AKM-FR-2021-000067-1 | Nuk ushtron aktivitet |
| 5 | E.....s | K.....A | Material Inert | M.Hoxha<br>A.Xhakaj<br>I.Maze | AKM-FR-2021-000071-1 | Nuk ushtron aktivitet. |
| 6 | P.. | K...E | Industri minerare | AKM-FR-2022-000015 | D. V.<br>E. Z. | Gjate momentit te inspektimit ne subjektin PIRALI nuk u kontaktua dhe nuk u paraqit asnje person pergjegjes. Makinerite ishin te fikura. Subjekti ne momentin qe do te filloj të ushtroj aktivitetin duhet nje njoftoj ARM Fier Vlore Gjirokaster per fillimin e tij. |
| 7 | R.. | K..E | Industri minerare | AKM-FR-2021-000286 | E.B.<br>E. Z. | Pas kontrollit ne terren subjekti me kete vendodhje nuk u arrit. te gjendej.Pasi kontaktuam me nje pergjegjes,na shpjegoj qe subjekti eshte mbyllur . . |
| 8 | B. A. | L...P | Industri minerare | AKM-FR-2023-000051 | E. Z.<br>E. Sh. | Nuk ka komunikim me perfaqesues te subjektit, subjekti nuk ka mare njoftim me ane te sherbimit postar. Nga inspektoret nuk eshte gjetur rruge alternative komunikimi me asnje perfaqsues te subjektit.Subjekti i lihet per detyre qe te shlyej detyrimet qe lindin nga leja mjedisore dhe me pas te heqin dore nga leja qe disponon ne rast te mos kryerjes te aktivitetit si edhe ne rast te rifillimit te aktivitetit detyrimet mjedisore duhen te jene te shlyera. dhe te njoftoje AKM dhe ARM Fier Vlore |

**3.** Me Urdhrin nr.108, datë 20.05.2022 "Për ngritjen e grupeve të punës (taksë forcë) për përballimin e sezonit turistik veror 2022, mbi monitorimin e menaxhimin e mbetjeve urbane,

evidentimin e mbetjeve të ngurta pranë akseve rrugore kombëtare dhe atyre që të çojnë në destinacione turistike dhe parandalimin dhe monitorimin e shkarkimeve të Ujërave të patrajtuara në mjedisin ujor, liqenor dhe krijimin e bazës së të dhënave për cilësinë e Ujërave larës.

Në kuadër të këtij urdheri titullari ka hartuar autorizime dhe grupet e punës për inspektimet e subjekteve të cilat kanë ndikim në Mjedis, si dhe për përballimin e sezonit turistik.

**4**. Nga auditimi i praktikave, programeve si dhe të urdhërit të Drejtoritë AKM–së, për subjektet me veprimtari të ndryshme rezutoi se në 5 raste u konstatuan pa rregullësi nga të cilat .

-në 3 raste raportet e vetmonitorimit/monitorimit, janë të paraqitura në sistem e-inspektimit, por nuk ka nr., prot nga AKM, në kundërshtim me urdhërin nr.3462, datë 02,07,2020, ‘’Për procedurën e dorëzimit/të pranimit të Raporteve dhe vetmonitorimit’’, pranë AKM-së.

- Në 2 raste tjera mungon dokumentacioni bashkëlidhur në sistem, veprime që bien në kundërshtim me Ligjin nr.10431 datë 09.06.2011“Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me Ligjin nr. 10433 datë16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” Neni 29, pika1/i, “Kundërvajtjet”.

Tabelë nr. 23 Veprimtari të ndryshme

| Nr | Emërtimi i Subjektit | NIPT | Aktiviteti | Data e inspektimit | Insdpektuar nga | Problematikat e konstatuara/ detyrat e lena (afatet) | Inspektimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | L. I. | L...D | Aktivitete te tjera | Nr. AKM-FR-2021-000028-1 01/06/2021 | F.B.,E. B. | Në pv është lënë mangësi në Plotesimindisadokumentacioneve mjedisore si **RRTSHN**,Plan i menaxhimit të mbetejeve dhe plan menaxhimi të riskut, vendim me Parajlajmrim. | Nuk është inspektuar |
| 2 | L.-09 | K...O | Blegtoria | AKM-FR-2021-000020 11/06/2021 | E. B. F. B. | Dokumentacioni në sistem është i vitit 2020, nuk përkonn me periudhen e inspektimit , në pv dhe vendim përfundimtare nuk janë marrë masa për mangësi të kushteve të lejes ndaj subjektit . | AKM-FR-2023-000203 08/12/2023 **M. H., B. F.**,në ceklistë Subjektifurnizohet me uje nga sistemi ujesjellesitFiervertet uar nga kontrataefurnizimit, |
| 3 | 2.E.Gaz | Industrite energjitike | K...C | AKM-FR-2021-000010 - 2 22/06/2021 | A. N.,F. B. | I gjithë dokumentacioni pa nr prot në AKM në pv dhe vendim përfundimtarë ndaj subjektit nuk janë marrë masa administrative | --- |
| 4 | B. A. | K...O | Perzierje cimentos | Nr. AKM-FR-2021-000026 - 2/1 03/06/2021 | A. N., F. B. | Në sitem plani i menaxhimit të mbetjeve pa nr prot akm si dhe | Është inspektuar ne sitem dhe rezulton që ka plotësuar kushte elejes Mjedisore |
| 5 | GJ.-D. | J...R | Industrite energjitike | AKM-FR-2023-000106 - 2/1 12/09/2023 | E.Sh. E. H. | Në sistem raport vetmonitorimi , raport menaxhimi,Program i menaxhimit të mjedisit , zhurmave etj pa nr prot ne AKM, ne pv dhe vendim përfundimtarë nuk janë marrë masa ndaj subjektit | Është inspektuar ne sitem dhe rezulton që ka plotësuar kushte e lejes Mjedisore , |

*Burimi ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër*

Nga auditimi i kryer për periudhën objekt auditimi rezultoi se janë inspektuar subjektet të cilat janë në fazë zbatim projekti.

**5.** Nga auditimi i ushtruar rezultoi se në 6 raste, ndaj subjekteve me veprimtari të ndryshme janë dhënë masa administrtive me ‘*’Parajlajmërim”*për mos paraqitje dhe zbatim të kushtit 3.29. Monitorimi, për VNM pranë AKM-së.

*Konkluzion;* Pas afatit 30 ditore të lëniës së vendimit përfundimtare në subjekte hartohen autorizime në muajin pasardhes për rinspektime nëse subjektet kanë plotësuar kushtet e lejes, dhe në të kundërt të mërren masa administrative gjobë sipas legjislacionit në fuqi,

***Tabela nr. 24 me subjekte të ndryshme***

| Nr | Emërtimi I Subjektit | NIPT | Aktiviteti | Data e inspektimit/ inspektoret | Nr. serial i Ceshtjes | Problematikat e konstatuara/ detyrat e lena (afatet) |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | H.S. | K...O | Hotel 3 kate me 2 kate nëntokë, Shqefalesh-Dhërmi | 14.12.2023 A. H. A. C. | AKM-FR-2023-000200 | Subjekti "HOTEL S." Sh.p.k ska raportuar vetëmonitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë fazes së zbatimit të projektit në AKM. Projekti ka perfuduar zbatimin e tij. Mase administrative **paralajmerim** |
| 2 | I./D. | J...D | Ndërtimi i një hoteli 4-katësh dhe bodrum | 12.12.2023 A. H. A. C. | AKM-FR-2023-000199 | Subjekti ka autorizim nga bashkia Sarandë me nr. 28 prot datë 04.11.2022 Për depozitimin e mbetjeve të krijuara nga gërmimi i sheshit të ndërtimit, e shoqëruar me faturë bankare. Subjekti nuk ka respektuar kushtin 3.29. Monitorimi. Mase administrative **paralajmerim** |
| 3 | L. 2002 | K...K | Godinë banimi dhe shërbimesh me 2-8-10 kate dhe 2 kate nën tokë dhe rikonstruksion i objektit ekzistues 3 kate | 12.12.2023 A. H. A. C. | AKM-FR-2023-000199 | Zhvilluesi gjatë fazës së zbatimit të projektit nuk ka raportuar në AKM për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit. Ky projekt nuk ka përfunduar zbatimin e tij. Operatori keshillohet te kryej raportimin në AKM Tirane sipas kushtit të VNM paraprake. Mase administrative **paralajmerim** |
| 4 | M&S K. | L...E | Strukture banimi 3 kate me 1 kat parkim nen toke | 12.12.2023 A. H. A. C. | AKM-FR-2023-000199 | Nuk është zbatuar kushti 3.27. Monitorimi dhe Raportimi në AKM të VNM-së paraprake. Zhvilluesi e ka përfunduar zbatimin e projektit. Masë administrative, **paralajmerim** |
| 5 | B. L. | | PROJEKTI I ZBATIMIT - RIKONSTRUKSIONI I RRUGES "SABRI KOSTURI | 05.12.2023 A. H. A. C. | AKM-FR-2023-000195 | Zhvilluesi i projektit B. L. nuk ka raportuar në AKM në bazë të pikës 3.27. të vendimit për VNM Paraprake për projektin rikonstruksioni i rruges Sabri Kosturi. Ky projekt ka përfunduar zbatimin e tij. Mase administrative paralajmerim |
| 6 | A. M. | K...U | Strukturë me funksion hoteleri me 2 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë. | 15.12.2023 A. H. A. C. | AKM-FR-2023-000191 | Subjekti "A.M." Sh.p.k nuk raportuar vetëmonitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë fazes së zbatimit të projektit në AKM. Operatori sapo ka filluar zbatimin e e projektit. Mase administrative **paralajmerim** |

**6.** Nga auditimi konstatohet se në 18 raste ndaj kompanive me aktivitet industri energjitike (kompanitë e naftë), janë marrë masa administrative, por në 3 raste, nuk janë dhënë dhe masa tjera për dy apo më shumë shkelje të konstatuara,veprime në kundërshtim me ligjin 45, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",Nenit 65, të Ligjit nr. 10431,datë 09.06.2011"Për lejet e mjedisit", nenit14"Vlerat 26 kufi të shkarkimeve",sipas shtojcës "2", bashkëlidhur ligjit, "Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve" të Ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 "Vetë monitorimi"si dhe Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" Seksioni 2 Neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit".

***Tabelë nr. 25 Lisat e Subjekteve me aktivitet industria energjitike (kompanite e naftës)***

| Nr | SUBJEKTI | NR.CESHTJES | INSPEKTORET | Insp | PROBLEMATIKAT/GJETJET E KONSTATUARA | Vendimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A. SHA | AKM-FR-2023-000096 | L. I. A. H. | Brenda Planit | 1. Neni: 29 ,Kundërvajtjet,Ligji: Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e Mjedisit" i ndryshuar . Pika: 1.germa b) Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B apo C nga operatori i një instalim. Komente:Gjatë inspektimit në terren u konstatuan problematika mjedisore, u verejten shkarkime dhe mbetje te lendeve hidrokarbure në siperfaqen e tokës të ushtrimit të`veprimtarsë nuk ka zbatuar:a)kushtin 1.5.17(Të jenë marrë të gjitha masat per mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe erozioni) b)Kushti. 1.5.12 (të jenë marrëte gjitha masat e nevojshme(dokumentimi dhe raportimi të autoriteti kompetent) | Mase administrative 1,000,000, lekë, Subjektit konstatohet se ka 2 shkelje të kërkesave ligjore ndaj subjektit, është marrë vetem një masë duhej gjobë në vlerë **500,000** për mos raportim në AKM dokumentimi dhe raportimi të autoriteti kompetent AKM, |
| 2 | A. SHA | AKM-FR-2023-000230 | L. I. E. H. | Jashte planit | 1. Neni: Neni 29 Kundërvajtjet . Ligji: Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT" i ndryshyar . Pika: 1) germa b) Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A, B.Komente:Është kryer inspektimi në terren ne subjektin A., Bashkia Selenice,jane konstatuar mbetje dhe rrjedhje te ujrave të patrajtuara të dyshuara të ndotura me lendë hidrokarbre të shpërndara në menyre të pakontrolluara,(bashkelidhur foto) Nga operatori nuk janë paraqitur dokuemntacion për matjen e parametrave të tjere mjedisore sipas kushteve të LM | Mase administrative 15,000,000 lekë, |
| 3 | A.SHA nxj naftes | AKM-FR-2023-000162 | E. Sh. L. I. | Jashte planit | Neni 61 Ndalimet . Ligji: Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mmbetjeve"Pika:b) .Komente:.Nga verifikimi në terren në puset nr 25 dhe nr 26 dhe grupit nr.25 të këtij sektori, në tersi është konstatuar një gjendje e amortizuar e puseve, tubacioneve dhe depozitave, Në rast avarie mungonin argjinaturat për kapjenlëndvehidrokarbure,.identifikimi1457/1,epapërditsuar ndryshimet ligjore"Lejet e Mjedisit"Nr.10433Dt 16.06.2011 dhe VKM Nr.419 Date 25.06.2015. | Masë administrative 1,000,000 lekë, |
| 4 | B. P. A. LTD | AKM-FR-2023-000004, autorizimi dt 23.02.2023 | A.C. E.Z. L.I. AKM-FR-2023-000004 - 2 | Jashtëplanit | Neni: 29 . Ligji: Nr. 10 448, datë 14.7.2011 " Për lejet e Mjedisit " i ndryshuarb) LM,nga operatori i një instalimi: i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë; 2. Neni 54 . Ligji: Nr.10 463, datë 22.9.2011 "për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar .Pika: c) masat e sigurisë dhe masat parandaluese që duhen marrë;. | Mase administrative 1,000,000,lekë rporti i vetemonitorimit pa nr prot parqitur pranë AKM duhej marrë masë , 300,000 lekë . |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | A. SHA | AKM-FR-2022-000034 Pv - 5 Datë: 07/10/2022 | A.C.<br>E.S.<br>L.I. | Jashtëplanit | Neni: 24 . Ligji: Nr. 9115 " Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura" datë 24.07.2003 . Pika: 1, gërma c. Komente:Subjektit A. u konstatuan shkarkime të pakontrolluara të Ujërave të ndotura me mbetje hidrokarbure, | Ndaj subjektit është marrë masë 1,000,000 lekë në site raporti monitorimitvetemonitorimit I prot në AKM . |
| 6 | A. O.&GAS | AKM-FR-2022-000031 | E. Z. L. I. A. C. E. Sh. | Jashtë planit | Neni: Neni 24 . Ligji: Nr.9115, " Per Trajtimin Mjedisor te Ujëraveve te Ndotura " date 24.07.2003 . Pika: Pika 1, germa c. Komente:Subjektit u konstatuan shkarkime te pakontrolluara te Ujëraveve te ndotura me mbetje hidrokarbure. | Masë 500,000 lekë , në sistem dokumentacioni pa nr prot AKM ndaj subjektit duhej marre dhe nje masë tjeter minale 300,000 lekë |
| 7 | A. SHA | AKM-FR-2021-000252 | A. N.<br>L. I. | Brenda Planit | Neni: Neni 29 . Ligji: LIGJi Nr.10 448, datë 14.7.2011 "PËR LEJET E MJEDISIT" . Pika: b) Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A | Mase administrative 1,000,000 lekë, |
| 8 | B. P. A. LTD | AKM-FR-2021-000101 | A. H.<br>L. I. | Brenda Planit | Neni: 54 .Ligji nr.10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" i ndryshuar. . Pika: c. Komente:Operatori nuk ka marre masat e nevojshme qe venddepozitimi i mbetjeve te jete i papershkueshem nga lendet e ndotura me hidrokarbure, referuar kushtit 1.5.6 | Mase administrative 1,000,000 lekë, |
| 9 | I. O. | AKM-FR-2021-000105 | A. H.<br>L.I. | Brenda Planit | Neni: 36 . Ligji: Ligji 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar. . Pika: a,b. Komente:a)Subjekti nuk caktoi nje perfaqesues per kominikuar me grupin e inspektimit. b)Subjekti nuk bashkepunoi per kryerje e veprimeve te i inspektimit. 2.. | Mase administrative 500,000 lekë, |
| | A. SHA | AKM-FR-2023-000108 | A. C.<br>E.Z. | Jashtë Planit | Neni: 29 . Ligji: Nr. 10448, datë 14.7.2011 " PËR LEJET E MJEDISIT" i ndryshuar b) i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.: Operatori A. Bashkia Selenice nuk ka zbatuar kushtet e lejes mjedisore, n. Ne aktivitet konstatohen shkarkime te patrajtuara te Ujëraveve te ndotura me lende hidrokarbure ne toke dhe kanalizime. | Mase administrative 2,000,000 lekë |
| 11 | A. SHA | AKM-FR-2023-000109 | E.Z.<br>A. C. | Jashtë planit | Neni: 29 . Ligji: Nr. 10448, datë 14.7.2011 " PËR LEJET E MJEDISIT" i ndryshuar b) i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë , Operatori është njoftuar me shkresë zyrtare nga AKM Tiranë për moszbatim e kushteve të lejes mjedisore dhe për mungesën e dorëzimit të dokumentacionit mjedisor. Gjobe: 300,000- 500,000Lekë. | Mase administrative **5, 000, 000 lekë,** |
| 12 | A. SHA | AKM-FR-2023-000161 | E. Z.<br>A. C. | Jashtë planit | Neni: 29 . Ligji: NR. 10 448, DATË 14.7.2011, “për lejet e mjedisit”, të ndryshuar .Pika: 1 b) i. Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë, | Mase administrative 1,000,000 lekë, |
| 13 | A. SHA | AKM-FR-2021-000274 | D. V.<br>E. S. | Brenda Planit | Neni: 29 Kundërvajtjet ,Ligji: nr. 10448, date 14.7.2011 “Per lejet e mjedisit” I ndryshuar, Subjekti nuk disponon dokumentacion mbi zbatimin e kushtit numer 6 të lejes mjedisore. 2. Neni: 50 Përgjegjësia për dëmin në mjedis. | Mase administrative 500,000 lekë, |
| 14 | B. P. A. LTD | AKM-FR-2021-000185 | A. C.<br>E. B. | Brenda Planit | Neni: 29 . Ligji: 10448 datë 14.07.2011 . Pika: 1. b (ii). Komente: Neni: 4 . Ligji: 10448 datë 14.07.2011 . Pika: 3 b. Komente:Subjekti duhet të kryej rishikimin e kushteve të lejes mjedisore sipas formatit të ri të lejes mjedisore | Mase administrative 500,000 lekë, |
| 15 | B. P.A. | AKM-FR-2021-000174 | A N.<br>E H. | Brenda Planit | Subjekti ushtron veprimtarin me Leje Mjedisore me PN-3629-08-2016, Tipi A. Ne zbatim te shtojces nr.1 te Lgjit nr.10448 " Per lejet e mjedisit" i ndryshuar. Me ID.1.6 | **masë administrative 500,000 lekë.** |
| 16 | B. P. A. | AKM-FR-2021-000131 | A. C.<br>E. B. | Brenda Planit | Neni: 29 . Ligji: Ligji nr 10448 date 14.07.2011 . Pika: 1 b ii. Komente:Mos respektim i kushteve te lejes mjedisore | Mase administrative 1,000,000 lekë , |
| *17* | *B.P. A.* | *AKM-FR-2021-000121* | *F B.j*<br>*A, N.* | *Brenda Planit* | Neni: 29 . Ligji nr 10448 date 14.07.2011 . Pika: 1 b ii. Komente:Mos respektim i kushteve te lejes mjedisore | Mase administrative 1,000,000 lekë , |
| 18 | T.S. | AKM-FR-2021-000083 | D. V.<br>F. B. | Brenda Planit | Neni: 29 "Kundërvajtjet",Ligji nr. 10448 , date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" i ndryshuar | Mase administrative 1,000,000, lekë, |

**7.** Tabela me subjektet e inspektuara për periudhën objekt auditimi, pikat e karburantit që me ndryshimet ligjore,sipas kapaciteteve kanë kaluar në leje të Tipit B, nga auditimi rezultoi se janë inspektuar në 9 subjekte të pajisura me leje Mjedisore të Tipit B, në dy raste është marrë denim kryesor masë ‘*’Paralajmërim’’*.

***Tabelë nr. 26 Lista e subjekteve karburanteve***

| Nr | SUBJEKTI | NIPT | NR.CESHTJES | INSPEKTORET | Inspek | PROBLEMATIKAT/GJETJET E KONSTATUARA | vendimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B. p. P. | K...N | AKM-FR-2023-000093 | L. I.<br>A. H. | Brenda Planit | Nga kontrolli i ushtruar ne terren nuk u konstatuan problematika mjedisore.Operatori ka kryer raportin e vetmonitorimit ,pagesen e tarifes vjetore dhe gjithe dokumentacionit e nevojshem mjedisor dhe e ka dorezuar prane AK | |
| 2 | L. | J...Q | AKM-FR-2023-000079 | E. H.<br>L. I. | Brenda Planit | Operatori ushtron veprimtarine sipas objektit te percaktuar ne Lejen Mjedisore perkatese.Operatori ka kryer pagesen e tarifes vjetore si dhe ka zbatuar kushtet ne lidhje me dokumentacionin e nevojshem per kryerjen e kesaj veprimtarie. Ne momentet e inspektimit nuk u verejten problematika mjedisore. | |
| 3 | O. | J...K | AKM-FR-2023-000094 | A.C.<br>E. Z. | Brenda Planit | Operatori ka kryer raport vetëmonitorimi dhe raport vjetor mjedisi me laborator të licensuar dhe akredituar, dhe e ka dorëzuar në AKM Tiranë me nr. 7110 prot datë 04.09.2023. Ka kryer pagesën e | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | tarifës vjetore të lejes mjedisore për vitin 2023. Gjatë inspektimit në aktivitet nuk u konstatuan shkarkime në ajër, zhurma apo vibracione kjo referuar dhe normave të matura nga laboratori i licensuar dhe akredituar ku vlerat rezultojnë brënda parametrave të lejuara. Operatori për zhvillimin e aktivitetit përdor energjinë elektrike. | |
-***Pika 6.9.*** Inspektorët kanë detyrim të përmbushin çdo kërkesë tjetër sipas parashikimeve përkatëse të Ligjit Nr. 9367 datë 07.04.2005,"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe rregulloren e brendshëm nr.120 datë 12.01.2021,neni 29 "*Parimet të përgjithshme të etikës, nëpunësi i Administratës Publike duhet të respektoje parimet sipas pikës f) të mos lejojë që interesat e tij private të mos bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktet e interesit dhe mos të shfrytëzojë pozitën për interesat e tij privat, si dhe neni 46,konflikti i interesit.*

Gjithashtu, i vërtetuar dhe nga masa që i është dhënë nga AKM.

Për sa më lart, nëpunësi A . Q. është në konflikt, me Ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil ", neni 46, pika 1 "*Nëpunësi civil ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në shërbimin civil"*.

**Situata**; Z. A.Q. *është* emëruar me shkresë nr 535/188 prot., datë 30.06.2020, në detyrë Inspektor në Sektorin e Burimeve Natyrore Ujëra, pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier Vlorë, Gjirokastër,*rezulton të jëtë* ***ortak (pjesëmarrja 100% aksione)*** *tek shoqëria "Comercir" shpk me objekt veprimtari Industri Minerare në qiell të hapur.*

**Kriteri:** Ligji nr.9367,datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" *Urdhër i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 28, datë 17.04.2014 "Për miratimin e kodit të etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë",* ***pika 6.3; pika 6.5 pika 6.8; Pika 6.9.*** Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", neni 46, pika 1. Rregullore e brendshme Nr.120, datë 12.01.2021, neni 29 "***Parimet të përgjithshme të etikës*** *dhe eni 46 Konflikti i Interesit.*

***Ndikimi/Efekti:*** *Qënia e inspektorit si pjësë e institucionit, ARM Fier Vlorë,Gjirokastër, ka ndikuar në inspektim në subjektin që ka kuota apo ortak 100% në biznes.*

***Shkaku:*** *Inspektori ka nënshkruar Autorizimin datë 23.11.2023,në respekt të detyrimit ligjor, sipas Nenit 10 pika 2 dhe Nenit 41 pika 2 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike."*

**Rëndësia:**E lartë

*Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi inspëktorët sipas rasteve të trajtuara .*

- Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Pérfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.1548 datë 06.06.2024, nga z.M. H., z.A. Q., z.B. F., z.A. Xh., z.I. M. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:**

Nga ana e subjektit janë sjellë vetëm komente të bëra mbi aktkonstatimin e mbajtur nga grupi i auditimit, pra nuk ka asnjë dokumentacione vërtetues dhe justifikuese të tjera për të vërtetuar pretendimet. Nga z. A. Q., në lidhje me konfliktin e interesit ka paraqitur vetëm komente referuar bazës ligjore që i është referuar grupi i auditimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit;**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, nuk ka shtesë dokumentacioni justifikues dhe vërtetues, dhe se veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.9115 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", datë 07/4/2003, Ligjin Nr.111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" neni 30 "Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre", neni 23 pika ç. Gjithashtu është paraqitur edhe observacioni për konfliktin e interesit nga Inspektori A. Q., i cili dhe në këtë rast ka bërë vetëm komente të ligjit dhe nuk ka sjellë dokumente justifikuese të reja, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

***2.5. Auditimi i zbatimit të procedurave për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra deri në ekzekutimin e tyre, nga Agjencia Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër.***

Në zbatim të misionit dhe të funksionit të saj, ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër, është përgjegjëse për të gjitha funksionet e inspektimit në fushat përkatëse në përputhje me përgjegjësitë në juridiksionin e sajë për mjedisin dhe burimet natyrore/ujërat, që burojnë nga kuadri rregullator në fuqi Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet Administrative", Ligjit nr. 10433 dt 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 10431, dt 9.6.2011 "Për

mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar, Ligjit nr. 10448 dt 14.7.2011 "Për lejet mjedisore" i ndryshuar, VKM Nr. 568 datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme Nr.120 prot., datë 12.01.2021 "Për Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit".
Dokumentet që u audituan:

- *Data basë e gjobave të mbajtur nga Juristi për Sektorin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore/Ujërave.*
- *Shkresat përcjellëse të sjella nga AKM në rastet e ankimit të kërkuara nga ARM Fier.*
- *Shkresat përcjellëse të paraqitura në AKM për gjobat e vendosura për Sektorin e Mjedisit dhe Burimeve Natyrore Ujerave.*
- *Shkresat përcjellëse të nisura nga Drejtori i ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër; Shkresat përcjellëse të nisura përmbarueseve priva në rastet e kthimit përgjigjes nga Gjykata Administrative Vlorë/Lushnje Tiranë të kthyera në Titull Eekzekutiv.*
- *Shkresa përcjellëse në lidhje me shoqëritë përmbarimore të cilat kanë kontratë të lidhur me AKM Tiranë.*

Për periudhën e audituar theksojmë se AKM Tiranë ka kërkuar me anë të Shkresës Nr. 2849 prot,. datë 08.04.2022 marrja e masave për nisjen dhe ndjekjen e procedurave për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj subjekteve debitore të gjobitur, nga ana e ARM-së Fier/Vlorë/Gjirokastër. Duke vazhduar kështu me procedurën për ekzekutimin e detyrueshëm të dënimeve administrative me gjobë, bazuar në kuadrin ligjor përkatës dhe praktikat e mira të ndjekura.
Në përbërje të strukturës së Inspektimit të ARM-së Fier, për periudhën 2021-2023 janë: Sektori i Inspektimit Mjedisor dhe Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore/Ujërave.
Mbështetur në dispozitat ligjore që janë në fuqi të cilat parashikojnë sanksione administrative dhe Rregullores së Brendshme AKM-së Nr. 120 Prot. datë 12.01.2021, rezulton se sektorët e sipërcituar kanë kompetenca për të vendosur sanksione administrative për shkeljet e dispozitave ligjore në fushën e mjedisit dhe burimeve natyrore/Ujërave.
Arkëtimi i gjobave nga shkelësit e ligjit janë të ardhura nga veprimtaria kryesore e institucionit dhe si të tilla derdhen në buxhetin e shtetit, sipas Shkresës Nr. 2198 Prot. datë 30.03.2023 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit "Mbi lëshimin e faturave për arkëtim nga institucionet në varësi të MTM-së".
Referuar këtyre drejtimeve grupi i auditimit kërkoi të dhëna në drejtim të inspektimeve të kryera, gjobave të vëna si dhe ndjekjes së tyre, për efekt të masave të marra në drejtim të përmirësimit të punës, arkëtimit të gjobave të vëna ndaj shkelësve të ligjit.
Nga grupi i auditimit referuar të dhënave të vëna në dispozicion u arrit në konkluzionin se janë likuiduar vullnetarisht vetëm pesë masa administrative me gjobë në vlerën 2 600 000 lekë. Dhe pse për shlyerjen vullnetare kompetencat nuk e përcaktojnë kryerjen e këtij veprimi nga dega rajonale. Gjithsesi kur ka qenë e mundur në kuadër të mbarëvajtjes së punës ato janë ndjekur për shlyerjen e tyre në mënyrë vullnetare dhe nga dega rajonale mjedisore.
Për periudhën 2021-2023, nga inspektorët e ARM Fier, nga të dy sektorët e inspektimit: Mjedis dhe Burime Natyrore/Ujëra, janë marrë 51 Vendime Përfundimtare Inspektimi (dënime me gjobë) në vlerën 37.640.000 lekë.
Për vitin 2021 janë marrë 20 Vendime Përfundimtare Inspektiminë vlerën 8.090.000 lekë.
Për vitin 2022 janë marrë 11Vendime Përfundimtare Inspektimi në vlerën 4.250.000 lekë
Përvitin 2023 janë marrë 20 Vendime Përfundimtare Inspektimi në vlerën 25.300.000 lekë.
Për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi numrin e Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit (gjoba) të vendosura gjatë vitit 2021, vitit 2022 dhe vitit 2023, nga ARM Fier sipas fushave të inspektimit po japim të dhënat në tabelën Nr. 1 sa më poshtë vijon:
*Tabela nr.33 Vendimet Administrative me gjobë për të 2 Sektorët, për periudhën 2021-2023.*

| ARM Fier | Gjoba nga Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Sektori i Inspektimit tëUjërave | | Totali i gjobave të vëna nga ARM, Fier | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë |
| 2021 | 11 | 6 950.000 | 9 | 1 140.000 | **20** | **8 090.000** |
| 2022 | 7 | 2 650.000 | 4 | 1 600.000 | **11** | **4 250.000** |
| 2023 | 11 | 8 200.000 | 9 | 17 100.000 | **20** | **25 300 000** |
| **Totali** | **29** | **17 800.000** | **22** | **19 840.000** | **51** | **37 640 000** |

Siç shihet nga të dhënat në tabelën më lart ,numri total i Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit të mbajtur nga inspektorët e ARM Fier që kanë dhënë dënim me gjobë është 51 në vlerë totale 37.640.000 lekë.
Nga 51 subjekte ndaj të cilëve janë vendosur sanksione administrative (gjobë) për periudhën 2021-2023, vetëm 28 prej tyre me vlerë 24.500.000 lekë kanë bërë ankim në rrugë administrative pranë Komisionit të Ankimit të AKM-së Tiranë, për të cilat janë marrë dhe vendime nga Komisioni pas shqyrtimit të ankimeve administrative. Nga Komisioni i Ankimit të AKM-së janë lënë në fuqi 21 vendime administrative me vlerë 13.000.000 lek, dhe janë pranuar ankimet për 7 vendime administrative me vlerë 11.500.000 lekë, konkretisht për, Vendimet me Nr:
1.AKM-FR-2021-000129-5 datë 09.02.2021, me vlerë 1,000,000 lekë ndaj subjektit "A.G.O." SHA është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr. 5653 Prot. datë 12.11.2021, me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë;
2. AKM-FR-2021-000083-5 datë 11.12.2021, me vlerë 1,000 ,000 lekë ndaj subjektit "T. S." është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr.240 Prot., datë 18.01.2022, me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë;
3. AKM-FR-2021-000252-5 datë 24.12.2021, me vlerë 1,000,000 lekë ndaj subjektit "A." SHA është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr. 1003 Prot. datë 11.02.2022, me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë;
4. AKM-FR-2022-000009-5 datë 16.03.2022, me vlerë 500,000 lekë ndaj subjektit "E.-Z." SHPK është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr. 3678 Prot. datë 10.05.2022, me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë;
5. AKM-FR-2023-000117-5 datë 31.08.2023, me vlerë 2,000,000 lekë ndaj subjektit "HOTEL BAR RESTORANT N." SHPK është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr. 8631 Prot. datë 17.10.2023, me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë;
6. AKM-FR-2023-000076-5 datë 14.09.2023, me vlerë 1,000,000 lekë, ndaj subjektit "R. B." është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr. 8630 Prot. datë 17.10.2023, me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë;
7.AKM-FR-2023-000156-5 datë 26.10.2023, me vlerë 5,000,000 lekë, ndaj subjektit "T. S." SHA është dhënë Vendimi i Komisionit të Ankimit me Nr. 10162 Prot., datë 06.12.2023,me të cilin pranohet ankimi dhe shfuqizohet dënimi me gjobë.
Nga vendimet e lëna në fuqi nga Komisioni i Ankimit, gjithashtu **2** Vendime me vlerë totale 800,000 lekë, me Nr: 1.AKM-FR-2021-000266-5, datë 10.12.2021 ndaj subjektit "U. K. F." Sha, me vlerë 300,000 lekë; 2. AKM-FR-2022-000031-5 datë 28.9.2022 ndaj subjektit "A. O. & G." SHA me vlerë 500,000 lekë.
Janë shfuqizuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë/Lushnje me Vendim të formës së prerë, duke qenë se vlera e dënimit është më e vogël se 20 fish i pagës minimale dhe për këto vlera vendimet janë të paankimueshme në Gjykatën e Apelit referuar kuadrit ligjor të Gjykatës Administrative.
Pra Vendimet e shfuqizuara janë 7 nga Komisioni i Ankimit dhe 2 nga Gjykata, 9 vendime në tërësi me një vlerë 12,300,000 lekë.

Referuar Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit të cilët janë shfuqizuar, gjendja e 19 Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit që janë lënë në fuqi pas ankimit administrativ dhe shqyrtimit gjyqësor dhe që duhet të arkëtohen është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr.34 Vendimet Administrative të ankimuara administrativisht dhe shqyrtuar gjyqësisht (të mbetura në fuqi),që duhet të arkëtohen.*

| AKMFier | Gjoba nga Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Gjoba nga Sektori i Inspektimit tëUjërave | | Totali i gjobave të vëna nga ARM Fier/Vlorë Gjirokastër | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë |
| 2021 | 5 | 2 600 000 | 1 | 100 000 | 6 | **2 700 000** |
| 2022 | 3 | 1 300 000 | 1 | 300 000 | 4 | **1 600 000** |
| 2023 | 7 | 5 900 000 | 2 | 2 000 000 | 9 | **7 900 000** |
| **Totali** | **15** | **9 800 000** | **4** | **2 400 000** | **19** | **12 200 000** |

Numri dhe vlera në total e Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit që duhet të arkëtohet sipas procedurave të përshkruara në kuadrin ligjor në fuqi është 19, vendime administrative në vlerën totale prej 12,200,000 lekë.

Për periudhën 2021-2023, për këto 19 vendime të ankimuara, ARM Fier, në lidhje me fillimin e procedimit për ekzekutim, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë/Lushnje me kërkesë për nxjerrjen e urdhrit ekzekutiv për 8 vendime të dënimeve me gjobë me vlerë 3,500.000 lekë, për të cilët gjykata ka lëshuar urdhrat ekzekutive, gjithashtu këto vendime janë dërguar për ekzekutim në përmbarim.

Ndërsa 3 vendime janë shlyer vullnetarisht në vlerën1,100,000 lekë.

Ndërsa 8 vendime administrative me vlerë 7,600,000 lekë të vitit 2023 janë në proces dërgimi për urdhër ekzekutimi në gjykatë, brenda afateve ligjore. Në ARM Fier nuk ka asnjë gjobë të parashkruar për periudhën 2021-2023.

*Tabelë nr. 35 Vendimet Administrative të ankimuara në Komisionin e Ankimimeve.*

| **Statusi i Vendimeve Administrative të ankimuara pranë Komisionit te Ankimeve** | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjoba të dërguara në përmbarim** | | **Gjoba në proces për titull ekzekutiv në Gjykatë** | | **Gjoba të shlyera vullnetarisht** | | **Gjoba në shqyrtim gjyqësor , në proces** | | **Gjoba në pritje të mbarimit të afatit përkundërshtim gjyqësor** | | **Gjoba të shfuqizuara** | | **Totali i gjobave të vëna nga ARM Fier/Vlorë Gjirokastër** | |
| | **Nr. Gjoba** | **Vlera leke (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera leke (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera leke (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** |
| Viti 2021 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 800 | 0 | 0 | 1 | 1000 | 10 | **6.000** |
| Viti 2022 | 1 | 300 | 1 | 300 | 2 | 800 | 1 | 300 | 0 | 0 | 4 | 2800 | 6 | **2.600** |
| Viti 2023 | 8 | 3700 | 8 | 3 700 | 1 | 300 | 2 | 1 800 | 0 | 0 | 4 | 8 500 | 12 | **15.900** |
| **Totali** | **9** | **4.000** | **9** | **4.000** | **3** | **1.100** | **5** | **2.900** | **0** | **0** | **9** | **12.300** | **28** | **24.500** |

Të dhënat për vendimet administrative të paankimuara paraqiten në aneksin nr. 2/1 bashkëngjitur këtij procesverbali.

*Tabela nr. 35/1 Gjendja e Vendimeve Administrative që nuk janë ankimuar administrativisht dhe gjyqësisht që duhet të arkëtohen.*

| ARM Fier | Gjoba nga Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Gjoba nga Sektori i Ujërave | | Totali i gjobave të vëna nga ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë | NR. Gjoba | Vlera në 000/ lekë |
| 2021 | 3 | 1 350 000 | 7 | 740 000 | 10 | **2.090.000** |
| 2022 | 2 | 350 000 | 3 | 1 300 000 | 5 | **1.650.000** |
| 2023 | 4 | 2 300 000 | 4 | 7 100 000 | 8 | **9.400.000** |
| **Totali** | **9** | **4.000.000** | **14** | **9.140.000** | **23** | **13.140.000** |

Numri dhe vlera totale e Vendimeve Përfundimtare të Inspektimit që nuk janë ankimuar administrativisht dhe kundërshtuar gjyqësisht dhe që duhet të arkëtohen sipas procedurave të

parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi është 23 vendime administrative në vlerën totale 13,140,000 lekë.
*Përfundimisht për 23 gjoba të vendosura nga ARM Fier, Juristi i institucionit ka ndjekur procedurat administrative ku janë lëshuar urdhërat ekzekutive dhe janë depozituar me kërkesë për ekzekutim në përmbarim sipas rasteve konkrete.*
Për periudhën kohore2021-2023, për 14 vendime administrative me vlerë 3,240,000 lekë, ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Lushnje, Tiranë, me kërkesë për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, të cilët janë lëshuar të gjithë nga ana e gjykatës, dhe i janë dërguar përmbaruesve për ekzekutim. 2 vendime administrative me vlerë 1,500,000 lekë janë shlyer vullnetarisht nga subjektet kundërvajtësve ,ku njëra prej tyre me vlerë 1,000,000 lekë është shlyer gjatë kohës së lëshimit të urdhrit ekzekutiv nga gjykata. Ndërsa 8 vendime administrative me vlerë 9,400,000 lekë të vitit 2023 janë në proces dërgimi për urdhër ekzekutimi në gjykatë, brenda afateve ligjore. Në ARM Fier nuk ka asnjë gjobë të parashkruar për periudhën 2021-2023.
Gjatë periudhës 2021-2023 është kërkuar në Gjykatë dhe lëshimi i urdhrave ekzekutiv për 10 Vendimet për dënimet administrative me gjobë, me vlerë 7,720,000 lekë, që janë dhënë përpara vitit 2021 (ku sipas interpretimeve ligjore dhe jurisprudenciale ishin akoma të vlefshme për vjelje), të cilët për arsye procedurale kanë qenë në shqyrtim gjyqësor deri në marrjen e vendimeve të formës së prerë, etj. Për 8 nga këto vendime dënimi me gjobë me vlerë 7,340,000 lekë, janë lëshuar nga Gjykata urdhrat e ekzekutimit ndërsa për 2 të tjerë me vlerë 380,000 lekë është refuzuar lëshimi. Për të cilët është bërë dhe ankimi në Gjykatën e Apelit, e cila nuk është shprehur akoma mbi to. Ndërsa 1 vendim me vlerë 80,000 lekë është shfuqizuar nga Gjykata pas ekzekutimit nga përmbaruesi.
Nga sanksionet e vendosura nga sektorët e inspektimit në ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër numri i vendimeve të dënimeve administrative të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë/Lushnjë/Tiranë, për t'u shndërruar në urdhër ekzekutiv, paraqitet në tabelën nr. 35/2, sa më poshtë vijon:
*Tabela nr.35/2 Vendimet për Dënim Administrativ të ankimuara dhe të paankimuara, të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë/Lushnje/Tiranë për t'u shndërruar në Urdhër Ekzekutiv për periudhën 2021-2023.*

| **Periudha** | Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Sektori i Inspektimit të Ujërave | | Totali i gjobave të dërguara në gjykatë | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Sek.Ujërave** | **Vlera lek (/000)** | **Totali nr.** | **Ven.Adm gjithsej Vlera lek (/000)** |
| Viti 2021 | 0 | 0 | 0 | | 0 | **0** |
| Viti 2022 | 9 | 3.800 | 1 | 5.000 | 10 | **8.800** |
| Viti 2023 | 11 | 3.220 | 12 | 2.940 | 23 | **6.160** |
| Totali | **20** | **7.020** | **13** | **7.940** | **33** | **14.960** |

-Nga kundërvajtjet administrative të konstatuara në vitin 2021 për të cilat janë mbajtur **15** vendime për dënim administrativ me një vlerë 4,290,000 lekë, të cilat janë lënë në fuqi dhe nuk janë shlyer vullnetarisht ,është kërkuar lëshimi i titullit ekzekutiv për 7 prej tyre me vlerë 3,450,000 lekë gjatë vitit 2022 dhe për 8 vendime të tjera me vlerë 840,000 lekë gjatë vitit 2023, për të cilët janë lëshuar nga gjykata urdhrat ekzekutiv dhe është kërkuar të ekzekutohen nga përmbaruesit.
-Nga kundërvajtjet administrative të konstatuara në vitin 2022 për të cilat janë mbajtur 8 vendime për dënim administrativ me vlerë 2,950,000 lekë, të cilat janë lënë në fuqi dhe nuk janë shlyer vullnetarisht, është kërkuar lëshimi i titullit ekzekutiv për 1 vendim për dënim administrativ me vlerë 50,000 lekë gjatë vitit 2022 dhe për 7 vendime të tjera me vlerë 2,900,000 lekë gjatë vitit 2023, për të cilat janë lëshuar nga Gjykata Urdhrat Ekzekutivë dhe është kërkuar ekzekutimi nga përmbaruesit.
-Nga kundërvajtjet administrative të konstatuara në vitin 2023 për të cilat janë mbajtur 16 vendime për dënim administrativ me vlerë 17,000.,000 lekë, të cilat janë lënë në fuqi dhe nuk

janë shlyer vullnetarisht, janë të gjitha në proces për kërkim të lëshimit të urdhrave ekzekutiv në gjykatë, brenda afateve ligjore, ku 4 prej të cilave me vlerë 3.300.000 lekë janë akoma në proces gjyqësor themeli.

-Numri i vendimeve me dënime administrative për të cilat është pranuar kërkesa dhe është nxjerrë Titull Ekzekutiv nga Gjykatat Administrative të Shkalles së Parë është 31 vendime me dënim administrativ në vlerën 14,580,000lekë.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna për numrin e vendimeve me dënim administrativ për të cilat ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër i është drejtuar me kërkesë për lëshimin e urdhrit ekzekutiv Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë/Lushnje/Tiranë, për të cilat gjykata i ka pranuar kërkesat dhe i ka kthyer në urdhër ekzekutiv:

*Tabela nr. 35/3 Nr. i Urdhrave Ekzekutiv*

| **Nr i Vendimeve me gjobë të kthyera në Urdhra Ekzekutiv nga Gjykata Administrative të Shkalles së Parë Vlorë/Lushnje/Tiranë** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Sektori i Inspektimit të Ujërave | | Totali i Titujve Ekzekutiv | |
| **Viti** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lekë (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Ven.Adm gjithsej** | **Totali vlerë** |
| 2021 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2022 | 9 | 3.800 | 1 | 5.000 | 10 | 8.800 |
| 2023 | 9 | 2.840 | 12 | 2.940 | 21 | 5.780 |
| Totali | **18** | **6.640** | **13** | **7 940** | **31** | **14.580** |

Tabelë nr. 35/4 Numri i vendimeve me dënime administrative të cilat kanë qenë/janë ende në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

| **Vendime administrative në fuqi (Në proces gjyqësorë themeli)** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Sektori i Inspektimit të Ujërave | | Totali i gjobave që janë kundërshtuar në gjykatë | |
| **Viti** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Totali vlerë** | **Ven.Adm gjithsej** |
| Viti 2021 | 1 | 300 | 1 | 100 | 2 | **400** |
| Viti 2022 | 2 | 800 | 1 | 300 | 3 | **1.100** |
| Vit 2023 | 7 | 3.680 | 0 | 0 | 7 | **3.680** |
| **Totali** | **10** | **4.780** | **2** | **400** | **12** | **5.180** |

Sipas nenit 9 "Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative" të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji. Pra për ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrave ekzekutiv të nxjerrë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë lidhet një marrëveshje me shërbimin përmbarimor gjyqësor privat. Në kontratën e shërbimit standard të hartuar nga AKM-ja, Neni 15 citon se: " Çdo njoftim i bërë mes palëve , sipas, kontratës, duhet të bëhet me shkrim në adresën e mëposhtme: a) Kreditori ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër. Rruga "Bishanaka" Lagjja "Sheq i Madh", Fier. b) Kreditori AKM, Rruga "Sami Frashri" Nr. 4, Tiranë."

Në tabelën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur numri i vendimeve me dënim administrativ të shndërruar në Urdhër Ekzekutiv për të cilët i është bërë kërkesë studiove përmbarimore që ofrojnë shërbimin e tyre. Mbi rezultatet e ekzekutimit të vendimit të gjobave përmbaruesit kanë njoftuar ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër dhe AKM Tiranë.

*Tabelë nr.35/4 Vendime të shndërruar në Urdhër Ekzekutiv.*

| **Urdhëra Ekzekutivë për të cilët është kërkuar ekzekutimi nga përmbaruesit privat** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sektori i Inspektimit Mjedisor | | Sektori i Inspektimit të Ujërave | | Tituj të ekzekutuar nga përmbaruesit | | Totali i Titujve dërguar përmbaruesit | |
| **Viti** | **Nr. Gjoba** | **Vleralek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Ven.Adm gjithsej** | **TotaliVlera lek (/000)** |
| Viti 2021 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2022 | 9 | 3.800 | 1 | 5.000 | 0 | 0 | 10 | 8.800 |
| Viti 2023 | 9 | 2.840 | 12 | 2.940 | 16 | 8.810 | 21 | 5.780 |
| **Totali** | **18** | **6.640** | **13** | **7 940** | **16** | **8.810** | **31** | **14.580** |

Për 31 kërkesa të pranuara nga Gjykata Administrative të Shkallës së Parë që janë shndërruar në urdhër ekzekutiv, juristi ju është drejtuar me kërkesë përmbaruesve gjyqësorë privat, të cilët kanë filluar procedurat për ekzekutimin e këtyre vendimeve.
Ku 16 nga këta vendime janë ekzekutuar nga përmbaruesit me një vlerë 8,810,000 lekë.
Një nga këta vendime me vlerë 80,000 lekë është shfuqizuar nga Gjykata pas ekzekutimit nga përmbaruesi.
Një vendim është shlyer nga kundërvajtësi gjatë kohës kur gjykata po lëshonte urdhrin ekzekutiv me vlerë 1,000,000 lekë.
Një tjetër kundërvajtës ka bërë marrëveshje me institucionin për pagesën e detyrimit me vlerë 300,000 lekë me këste e cila deri më tani është shlyer pjesërisht në vlerën 121,000 lekë.
Një tjetër vendim për dënim me gjobë është shfuqizuar nga Gjykata pasi përmbaruesi ka nisur ekzekutimin e urdhrit ekzekutiv me vlerë 500,000 lekë, por nuk është realizuar ekzekutimi.
Ndërsa 12 vendimet e mbetura me një vlerë 4,149,000 lekë, janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit, ku pengesat më të zakonshme që hasen janë mungesa e pasurive nga ana e debitorëve dhe mos lajmërimi në adresat e tyre.
Për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi numrin e vendimeve me dënim administrativ (gjobë) të vendosura gjatë periudhës 2021-2023, nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër sipas, statusit aktual të numrit te vendimeve dhe vlerave të tyre paraqitet në tabelën sa më poshtë vijon:
*Tabela nr.35/5 E përgjithshme e Vendimeve Administrative për periudhën 2021-2023.*

| **Vendime administrative për periudhën2021-2023** | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjoba të dërguara në përmbarim** | | **Gjoba të dërguara për urdhër ekzekutiv në Gjykatë** | | **Gjoba të shlyera vullnetarisht** | | **Gjoba në shqyrtim gjyqësor, në proces** | | **Gjoba në pritje të mbarimit të afatit të kundërshtimit gjyqësor** | | **Gjoba të shfuqizuara** | | **Totali i gjobave të vëna nga ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër** | |
| | **Nr.Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** | **Nr. Gjoba** | **Vlera lek (/000)** |
| Viti 2021 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 400 | 0 | 0 | 3 | 3100 | **20** | **8 090** |
| Viti 2022 | 10 | 300 | 10 | 8.800 | 1 | 500 | 3 | 1.100 | 0 | 0 | 4 | 2800 | **11** | **4 250** |
| Viti 2023 | 21 | 12 820 | 23 | 6.160 | 4 | 2 100 | 7 | 3.680 | 0 | 0 | 7 | 8.960 | **20** | **25 300** |
| **Totali** | **31** | **14.580** | **33** | **14.960** | **5** | **2 600** | **12** | **7 860** | **0** | **0** | **14** | **9 860** | **51** | **37 640** |

Për 31 gjobat të cilat janë kthyer në urdhër ekzekutiv nga Gjykata, ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër i ka kërkuar shoqërive përmbarimorë “B.s. e. H.” shpk,“Zyra e përmbarimit privat g.” shpk., “D. M.” dhe “Td. G.” shpk ekzekutimin e urdhrave të lëshuar nga Gjykata.
Zakonisht raportimi i përmbaruesve ka qenë korrekt, por ka pasur dhe raste mos raportimi për një kohë të gjatë nga ana e tyre. Në këto raste ju është kërkuar informacion me e-mail dhe me shkresë zyrtare derisa kanë dhënë informacionin e kërkuar, me e-mail apo shkresë zyrtare, mbi mbarëvajtjen e procedurave të ekzekutimit për vjeljen e gjobave, duke rakorduar gjithmonë dhe me Thesarin e Shtetit kur ka qenë e mundur.
Nga kundërvajtjet administrative të konstatuara në vitin 2023 për të cilat janë mbajtur **16** vendime për dënim administrativ me vlerë 17,000,000 lekë, të cilat janë lënë në fuqi dhe nuk janë shlyer vullnetarisht, janë të gjitha në proces për kërkimin e lëshimit të urdhrave ekzekutiv në gjykatë, brenda afateve ligjore. Ku 4 prej të cilave janë akoma në proces gjyqësor themeli me një vlerë 3,300,000 lekë.
-Këto 16 vendime renditen si më poshtë:

1. AKM-FR-2022-000177-5 datë 02.02.2023 me vlerë 500,000 lekë, ndaj subjektit “E.-O A.2.” SHPK (Kërkesë Nr. 402 Prot. datë 06.02.2023,Gjykatës për lëshimin e urdhri te kzekutiv);

2. AKM-FR-2023-000004-5 datë 01.03.2023 me vlerë 1.000.000 lekë, ndaj subjektit "B. P. A." LTD; (Kërkesë Nr. 483 Prot. datë 14.02.2023, Gjykatës për lëshimin e urdhrit ekzekutiv);
3. 3.AKM-FR-2023-000005-5 datë 20.03.2023 me vlerë 1,000,000 lekë, ndaj subjektit "A."SHA;
4. AKM-FR-2023-000021-5 datë 29.06.2023 me vlerë 100,000 lekë, ndaj subjektit "R."SHPK;
5. AKM-FR-2023-000027-5 datë 14.07.2023 me vlerë 300,000 lekë, ndaj subjektit "D.& D. I."SHPK;
6. AKM-FR-2023-000065-5 datë 08.08.2023 me vlerë 1,000,000 lekë, ndaj subjektit "A. K.";
7. AKM-FR-2023-000066-5 datë 08.08.2023 me vlerë 1,000,000 lekë, ndaj subjektit "L.B." SHPK;
8. AKM-FR-2023-000067-5 datë 09.08.2023 me vlerë 1,000.000 lekë, ndaj subjektit "K." SHPK;
9. AKM-FR-2023-000109-5 datë 03.10.2023 me vlerë 300.000 lekë, ndaj subjektit "A." SHA;
10. AKM-FR-2023-000096-5datë 04.10.2023 me vlerë1,000,000 lekë, ndaj subjektit "A." SHA;
11. AKM-FR-2023-000102-5datë 04.10.2023 me vlerë 300,000 lekë, ndaj subjektit "D.E S. F.";
12. AKM-FR-2023-000108-5 datë 05.10.2023 me vlerë 2,000,000 lekë, ndaj subjektit "A." SHA;
13. AKM-FR-2023-000155-5 datë 26.10.2023 me vlerë 5,000,000 lekë, ndaj subjektit "A." SHA;
14. AKM-FR-2023-000157-5 datë 16.11.2023 me vlerë 1,000,000 lekë, ndaj subjektit "A..G. O." SHA;
15. AKM-FR-2023-000161-5 datë 04.12.2023 me vlerë 1,000,000 lekë, ndaj subjektit "A." SHA;
16. AKM-FR-2023-000162-5 datë 21.12.2023 me vlerë 500,000 lekë, ndaj subjektit "A." SHA;

**Situata:** Ndërsa 16 gjoba nuk janë hartuar akoma urdhra për kthim në titull ekzekutiv
**Kriteri:** Ligji nr.10279,datë20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" neni 46,*"Parashkrimi i dënimit administrative".*
**Ndikimi/Efekti**: Mosrealizim i arkëtimit të gjobave
**Shkaku:** Mungesë koordinimi dhe mungesë stafi
**Rëndësia**: Mesme

**2.6.Të tjera gjatë auditimit**

***Veprimet nëpërmjet magazinës.***

Për periudhën e auditimit 01.012021-31.12.2023 rezulton se:
Detyra e magazinierit ka qenë e deleguar përgjatë periudhës audituese si më poshtë:
-Me shkresë nr.897 prot., datë 08.07.2020 Urdhër i brendshëm i Drejtorit Z. A.V. znj. S. J. detyrë specialiste në Sektorin e Monitorimit ngarkohet me detyrë magazinier, e cila nuk e ka ushtruar këtë detyrë.
-Me shkresë nr.1531 prot., datë 19.04.2021 Urdhër i brendshëm i Drejtorit Z. A.V. z. N. S. me detyrë specialist Sektori i Lejeve ngarkohet me detyrë magazinier.
-Me shkresë nr.1851prot.,datë 20.06.2022 Urdhër i brendshëm i Drejtorit Z. A.V. z. A. B. me detyrë specialist në Sektorin e Monitorimit ngarkohet me detyrë magazinier.
-Me shkresë nr.480 prot.,datë 22.02.2023 Urdhër i brendshëm i Drejtorit Z. A.V. z. G. Zh. me detyrë specialist në Sektorin e Monitorimit ngarkohet me detyrë magazinier.
Në Rregulloren Nr.120 prot., datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit" miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, detyra e magazinierit është përfshirë në detyrat funksionale të specialistit të Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivë-Magazinë, ku midis të tjerave ka këto detyra:
Pika 4. Administrimi i mjeteve dhe pajisjeve të disponuara nga institucioni; Është përgjegjës për mbajtjen dhe ruajtjen e informacinit shkresor të ARM sipas përcaktimeve ligjore;
Pika 13. Asiston problemet e ruajtjes së bazës materiale në magazinë, të dokumentave të arkivës dhe bibliotekës, të shfrytëzimit efektiv të mjeteve të transportit, të mirëmbajtjes, pastrimit, ruajtjes fizike të godinës; Mban protokollin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm shkresor të ARM-së.
Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave hyrje-dalje në magazinë konstatohet se:

- Rregjistrimi i dokumentave vërtetuese (fletëhyrje-fletëdalje) nuk bëhej në ditarin e magazinës, në kundërshtim me Nenin 3, pika 1, të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Kreu II Dispozita të Përgjithshme mbi Dokumentet Kontabël dhe Pasqyrat Financiare *"Neni 6, Mbajtja e kontabilitetit..; Neni 7, Dokumenti*

*kontabël;* Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II 2.1 "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 2.2.

- Në fund të çdo periudhe raportuese nuk ka asnjë rakordim dhe as procesverbal të mbajtur midis magazinierit dhe sektorit të financës, në kundërshtim *me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 52.*
- Nga ana e magazinierit nuk mbaheshin kartela për artikujt, *në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve pika/c dhe pika 34,40.*

-Fletëhyrjet për vitin 2021,2022 nuk kishin dokumente shoqëruese si faturë tatimore të shitësit, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit. Në shumë raste fletëhyrjet ishin të firmosur edhe nga NZ, *në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 37.* Kështu për vitin 2021 nga 15 fletëhyrje në 11 raste ka firmosur NZ; për vitin 2022 nga 18 fletëhyrje në 3 raste ka firmosur NZ. Fletëhyrjet e hartuara për vitin 2023 ishin të plotësuara me ekstremitetet e tyre nga magazinieri dhe bashkëlidhur dokumentacion shoqërues si, faturë tatimore shitësi, kontratë.
Pika 37. (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë).
-Fletëdaljet e magazinës për vitin 2021,2022 nuk kishin bashkëlidhur dokumentacion shoqërues dhe në disa raste janë firmosur edhe nga NZ ose vetëm nga magazinieri, pa nënshkrimin e personit që merr mallin. Kështu për vitin 2021 nga 68 fletëdalje në 15 raste ka firmosur edhe NZ, për vitin 2022 nga 25 fletëdalje në 3 raste ka firmosur NZ. Për vitin 2023 ishin hartuar me ekstremitetet e tyre nga magazinieri dhe bashkëlidhur kishin vetëm kërkesën nga personi përkatës të miratuar nga drejtori.Veprimet janë në kundërshtim me *UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 38.*-Veprimet nga ana e NZ në lidhje me nënshkrimin e dokumentave vërtetues si fletëhyrje-fletëdalje janë në kundërshtim *me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 15.*
-Z.N.S., në cilësinë si magazinier edhe si marrës i mallit (naftë), ka tërhequr 738 litra karburant nga magazina në vlerë 130,130 lekë, veprim ky në kundërshtim me *Nenin 22 të Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; UMFE nr. 30, datë 27.12.2011, i ndyshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 36.*-Për të parë rregullshmërinë dhe zbatimin e ligjshmërisë nga personat me përgjegjesi materiale, nga grupi i auditimit u ushtrua një kontroll në ambientet e magazinës pranë ARM Fier, në datë 29.02.2024, ku të pranishëm ishin Z.G.Zh. deleguar në detyrën e magazinierit nga data 22.02.2023 e në vazhdim, NZ z.P..T..
Pas marrjes së deklaratës për veprimet e kryera nga ana e magazinierit u vijua me kontrollin e dokumentacionit dhe të gjendjes fizike të magazinës ku rezultoi se:
-Magazinieri e kishte filluar detyrën pa marrë në dorëzim mallin gjendje në magazinë, si dhe asnjë dokumentacion mbështetës, dhe ka vijuar me veprimet hyrje-dalje nga periudha e vet.
-Nuk kishte rakorduar asnjëherë me zyrën e financës mbi gjendjen e magazinës. Gjithashtu nuk kishte njohje dhe nuk ishte i informuar në lidhje me detyrën e ngarkuar dhe përgjegjësinë mbi mbajtjen e pasqyrimin në dokumentacionin përkatës e të dhënave.
-Fletëhyrjet ishin të shoqëruara me faturën e shitësit dhe fletëdaljet nënshkruheshin nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim i mallit dhe shoqëroheshin me kërkesën firmosur nga personi përkatës të miratuar nga titullari i njësisë. Çdo rregjistrim bëhej në një evidencë në excel të detajuar me artikuj sasi e vlerë.

-Nga NZ u kërkua gjendja kontabël e magazinës në 31.12.2022, rakordimi i financës me magazinën, dokumentacioni i dorëzimit dhe marrjes së detyrës nga secili magazinier dhe dokumenta të tjerë mbështetës, për të cilat nuk patëm asnjë të dhënë kontabël.
-Në përfundim të auditimit mbi bazën e dokumentacionit vërtetues (fletëhyrje-fletëdalje) rezultoi se gjendja kontabël në mbyllje të vitit 2022 paraqitej në vlerën 560,187 lekë, e cila rakordon me gjendjen fizike, por nuk rezulton e pasqyruar në bilanc, si më poshtë:

Çelje 01.01.2022 (Bilanci v.2021) 61,469 lekë
Hyrje (6) deri në 31.12.2022 728,942 lekë
Dalje (23) deri në 31.12.2022 230,224 lekë

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me *UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave* financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" *pika 30 -Aneksi 1, pika 3.1.Trajtimi kontabël dhe fuksionimi i llogarive të klasës 3 "Aktivet afatshkurtra jofinanciare (inventarët).*
(Kjo situatë trajtuar tek analiza e llogarisë 31 "Materiale" në aktiv të bilancit).
*Për shkeljet e konstatuara në lidhje me veprimet e magazinës mban përgjegjësi z.P.T. me detyrë P/Sektorit të Shërbimit dhe Financës .*
**Situata:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier mbi rregullshmërinë e veprimeve në magazinë rezultoi se: detyra e magazinierit prej krijimit të njësisë e në vazhdim me urdhër të titullarit të njësisë i është deleguar 4 punonjësve me pozicion specialistë në Sektorin e Monitorimit dhe të Lejeve, *në moszbatim me Rregulloren Nr.120 prot.,datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit"* e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së z.E.K., pika 4,13, ku përcakton qartë se detyra e magazinierit është përfshirë në detyrat funksionale të specialistit të Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivë-Magazinë.
Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave hyrje-dalje në magazinë rezultoi se:
-Regjistrimi i dokumentave vërtetuese (fletëhyrje-fletëdalje) nuk bëhej në ditarin e magazinës, *në kundërshtim me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Neni 6,7; Udhëzimi MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II 2.1 "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 2.2.*
-Nga ana e magazinierit nuk mbaheshin kartela në magazinë, *në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve pika/c dhe pika 34,40.*
-Në fund të çdo periudhe raportuese nuk ka asnjë rakordim dhe as procesverbal të mbajtur midis magazinierit dhe sektorit të finances, *në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 52.*
- Fletëhyrjet dhe Fletëdaljet e magazinës për vitin 2021,2022 nuk kishin bashkëlidhur dokumente justifikuese si faturë tatimore të shitësit, procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, *në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 37,38.*
-NZ në disa raste ka firmosur fletëhyrje dhe fletëdalje *të magazinës, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 15.*
Nga sondazhi i ushtruar në ambientet e magazinës pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër rezultoi se: gjendja fizike në mbyllje të vitit 2022 paraqitej në vlerën 560,187 lekë, e cila rakordoi me gjendjen kontabël dhe nuk rezulton e pasqyruar në bilanc, veprime *kundërshtim UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes*

*dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30.*

-Magazinieri e kishte filluar detyrën pa marrë në dorëzim mallin gjendje në magazinë, si dhe pa asnjë dokumentacion, dhe ka vijuar me veprimet hyrje-dalje nga periudha e vet dhe se nuk kishte rakorduar asnjëherë me zyrën e financës mbi gjendjen e magazinës, në *kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", pika 52.*

-Fletëdaljet shoqëroheshin jo me dokumentacionin e plotë dhe të duhur, *në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 38*:

**<u>Kriteri:</u>** Ligji Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Neni 6 Mbajtja e kontabilitetit, Neni 7 Dokumenti kontabël; Udhëzimi MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II 2.1 "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik".

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"i ndryshuar pikat 15, 34,40, 37, 38.UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pikat 30, 52.

Rregullore Nr120 prot.,datë 12.01.2021"Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit"pika 4,13.

**<u>Ndikimi/Efekti:</u>** Institucioni përballet me riskun e mosmenaxhimit dhe keqpërdorimit të aktiveve, duke mos vërtetuar cilësinë dhe gjendjen fizike të aktiveve në kohën e duhur.

**<u>Shkaku:</u>** Mosnjohja dhe mosrespektimi i kuadrit ligjor, lidhur me veprimet në magazinë.

**<u>Rëndësia:</u>** E lartë

***Testim i llogarisë 600 "Pagat dhe shpërblime", zbatimi i strukturës organizative.***

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër është e organizuar dhe funksionon mbi Vendimin Nr.568, datë 17.7.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"; të Urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*", Rregullores së *nr.120 prot, datë12.01.2021, nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së z.E.K.*. dhe ka në organikën e saj <u>48 punonjës të përbërë në 9 sektorë</u>.

Nga 48 pozicione pune në strukturë, 46 pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohen me Ligjin nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar dhe 2 pozicione (shofer, punonjëse pastrimi) i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995"*Kodi i Punës*", i ndryshuar.

Nga auditimi në lidhje me zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2023, rezulton se struktura dhe kategoria e pagave të punonjësve të ARM Fier, paraqitet si më poshtë:

<u>Për vitin 2021</u> numri i punonjësve në fakt sipas strukturës është 42 punonjës, ose në krahasim me numrin e planifikuar paraqitet me realizim në masën 87,5%. Gjatë vitit kanë ardhur 7 punonjës dhe janë larguar 4 prej tyre. Numri i vendeve të lira 6, i përbërë nga 5 përgjegjës sektori dhe 1specialist jurist.

*Pra, numri faktik i punonjësve në vitin 2021 është 42 punonjës,ose me mosrealizim në masën 13%, ndërsa 6 është numri i vendeve të lira.*

<u>Për vitin 2022</u> numri i punonjësve në fakt sipas strukturës është 36 punonjës ose në krahasim me numrin e planifikuar paraqitet me realizim në masën 75%. Gjatë vitit kanë ardhur 4

punonjës dhe janë larguar 10 prej tyre (larguar drejtuesi). Numri i vendeve të lira 12 i përbërë nga 3 përgjegjës sektori dhe 9 specialistë.
*Pra, numri faktik i punonjësve në vitin 2022 është 36 punonjës, ose me mosrealizim në masën 25%, ndërsa krahasuar me vitin 2021numri i të punësuarve paraqitet me trend në ulje. Numri i vendeve të lira është rritur dyfish (12), krahasuar me vitin e kaluar.*
Për vitin 2023 numri i punonjësve në fakt sipas strukturës është 33 punonjës ose në krahasim me numrin e planifikuar paraqitet me realizim në masën 69%. Gjatë vitit ka ardhur 1 punonjës dhe janë larguar 3 prej tyre. Numri i vendeve të lira 15 i përbërë nga 1 drejtor, 3 përgjegjës sektori dhe 11 specialistë.
*Pra, numri faktik i punonjësve në vitin 2023 është 33 punonjës ose me mosrealizim në masën 31%. Numri i vendeve të lira vijon me trend rritje, është rritur 31% krahasuar më numrin total të planifikuar. Pra, kjo drejtori ka vepruar vetëm me rreth 77% të kapacitetit.*
Rekrutimet kryhen sipas procedurës e cila fillon me kërkesë të drejtuesit të ARM-së drejtuar AKM-së, shpalljen e pozicioneve të lira në faqen e ëeb-it dhe konkurimit në DAP deri në shpalljen e fituesit.
Largimet nga puna, referuar dokumentacionit në dispozicion, janë kryer me dëshirën e tyre, dhe nuk ka vendime apo procese gjyqësore.
Kategoria e pagës është përcaktuar për çdo pozicion pune me miratimin e strukturës dhe të numrit të punonjësve.
Aktualisht pozicioni i drejtorit është i komanduar, pa afat, mbahet nga z. D.V. me Urdhër të brendshëm Nr.88, datë 04.05.2022 nga AKM: pozicioni sipas organikës - Specialist (Inspektor) Sektori i Inspektimit Mjedisor, Me shkresë nr.1341 prot, datë 09.05.2022 është depozituar firma si NA pranë Degës së Thesarit Fier, duke tejkaluar kriterin e periudhës së komandimit në një pozicion pune.

***Testim* mbi *dokumentacionin e dosjeve të personelit.***

Bazuar në detyrat e përcaktuara në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë,Gjirokastër si dhe në Ligjin Nr. 152/2013 Për Nëpunësin Civil, ndryshuar, specialisti i burimeve njerëzore, protokoll-arkivë-magazinës ka detyrë krijimin dhe përditësimin e dosjeve të personelit të institucionit. Për të audituar administrimin e dokumentacionit të dosjeve të personelit, në raport me kërkesat e Lidhjes 1 "Të dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit" të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit" ku përcaktohet: *Dosja dhe regjistri i personelit, pika 1.*
Në bazë të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit": *II. dosja e personelit pika 3.*
Për të parë rregullshmërinë e dosjeve të personelit nga grupi i auditimit u përzgjodhën 15 dosje, ku rezultoi se në të gjitha dosjet e personelit mungonte:
- Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar sipas lidhjes nr. 2; çertifikata personale dhe çertifikata e gjendjes familjare; raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, ose rezultonte që në përiudhën më të hershme, atë të fillimit të punës në mosrespektim të kërkesave të Vendimit Nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar, Kreu III Lirimi nga Shërbimi Civil, pika *23.*
- Në 13(trembëdhjetë) raste nuk ndodheshin të gjitha formularët e vlerësimit 6 mujor, ndërsa 1 punonjës ndodhej në periudhë prove, në kundërshtim me Ligjin Nr. 152/2013 Për Nëpunësin Civil, ndryshuar Kreu X i Vlerësimi i Nëpunësit Civil *Neni 62.*
-Nga 15 dosje të përzgjedhuara, 4 prej tyre kishin përshkrimet e punës dhe se përputheshin me përcaktimin e kritereve të përgjithshme dhe të posaçme.
-Në 1(një) rast punonjësi z. V.G nuk kishte në dosjen personale librezën e punës, por vetëm fotokopje të saj të panoterizuar.
-Dosjet personale të të punësuarve pasqyrohen në sistemin HRMIS që administrohet nga DAP nga drejtoria e burimeve njerëzore së AKM-së, dhe jo nga specialisti i caktuar në këtë detyrë,

në mosrespektim të Rregullores së Rregullores *nr.120 prot, datë 12.01.2021, nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së z.E.K.*.
-Nga 4 dosje të përzgjedhur për punonjësit e larguar, asnjë tyre nuk kishin të inventarizuar aktin e dorëzimit të dokumentacionit dhe punës përpara largimit.
-Po kështu u konstatua se dosjet e personelit nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen sipas inventarit si edhe mënyrës së mbajtjes pranë zyrë së Burimeve Njerëzore.
*Për shkeljet e konstatuara në lidhje me krijimin dhe përditësimin e dosjeve të personelit të institucionit mban përgjegjësi zj.P.V. me detyrë specialiste e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivë-Magazinë prej datës 04.02.2021.*
**Situata:** **a)** Nga verifikimi i të dhënave, në lidhje me strukturën e miratuar sipas Urdhërit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*", Rregullores nr.120 prot, datë12.01.2021, nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së z.E.K. rezulton se nuk ka gjetur zbatim, pasi ndër vite numri i vendeve të lira ka rezultuar me trend në rritje, konkretisht:
Në fund të vitit 2021, struktura paraqitet me realizim në masën 87,5% dhe numri i vendeve vakante 6 **;** në fund të vitit 2022, struktura paraqitet me realizim në masën 75% dhe numri i vendeve të lira 12**;** në fund të vitit 2023 struktura paraqitet me realizim në masën 69% dhe numri i vendeve të lira 15, *pra kjo drejtori ka vepruar vetëm me rreth 77% të kapacitetit të saj, duke sjell ulje të efektivitetit dhe eficencës në punë për njësinë.*
**b)** Në lidhje me auditimin e ushtruar për plotësimin e dosjeve të personelit, u përzgjodhën 15 dosje ku rezultoi se dosjet e personelit nuk kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit" *II.* Dosja e personelit.
-nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen sipas inventarit si edhe mënyrës së mbajtjes pranë zyrë së Burimeve Njerëzore.
-Për punonjësit e larguar mungonte akti i dorëzimit të dokumentacionit dhe punës përpara largimit.
**Kriteri:** Urdhërit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", Ligji Nr. 152/2013 Për Nëpunësin Civil, ndryshuar Kreu X i Vlerësimi i Nëpunësit Civil Neni 62; VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit" 1 Dosja dhe regjistri i personelit; pika 3 e Rregullores nr.120 prot, datë12.01.2021, nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së z.E.Konomi; Vendimi Nr. 124, datë 17.02.2016, i ndryshuar, Kreu III Lirimi nga Shërbimi Civil, pika 23.
**Ndikimi/Efekti:** 1. Cënohet performanca e institucionit në tërësi si dhe përmbushja e misionit për pozicionet e punës që rezultojnë të paplotësuara me staf.
2. Mangësitë në plotësimin e dosjeve të personelit sjellin mangësi edhe në azhornimin e të dhënave të të punësuarve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
**Shkaku:** Moskryerja e procedurave të rekrutimit në raport me pozicionet e lira të punës. Moszbatimi i kërkesave ligjore të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit*".
**Rëndësia:** E Lartë.

**Administrimi i pagave dhe rregullshmëria në kryerjen e pagesave të tjera.**

I.Marrëdhëniet e punës në ARM Fier rregullohen përmes Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar(për 2 punonjësit shërbimit mbështetës).
Pagat e punonjësve janë trajtuar sipas pozicioneve dhe kualifikimeve të përcaktuara në VKM-të përkatëse.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë në 000/lekë

| Nr. Emërtimi | VITI 2021 | | | Viti 2022 | | | Viti 2023 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Plan | Fakt | % | Plan | Fakt | % | Plan | Fakt | % |
| Fondi pagave | 26,000 | 24,504 | 94 | 29,000 | 21,930 | 91 | 28,700 | 28,337 | 99 |
| Sig.Shoq | 5,200 | 3,970 | 76 | 5,020 | 3,655 | 91 | 4,900 | 4,730 | 97 |
| Fondi vecantë | | | | 570 | 570 | 100 | | | |

Burimi i të dhënave: Sektori Shërbimit, zyra financës ARM Fier-Vlorë-Gjirokastër.

Në total për vitin 2021 shpenzimet për paga art. 600-601 janë planifikuar në shumën 31,200 mijë lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 28,474 mijë lekë, me një realizim në 91%.
Në total për vitin 2022 shpenzimet për paga art. 600-601 janë planifikuar në shumën 34,020 mijë lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 25,585 mijë lekë, me një realizim në 75%.
Në total për vitin 2023 shpenzimet për paga art. 600-601 janë planifikuar në shumën 33,600 mijë lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 33,067 mijë lekë, me një realizim në 98%.
Për secilin vit buxhetor shpenzimet rezultojnë të rakorduara me situacionet vjetore me Degën e Thesarit.
Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e periudhës (Janar, Qershor dhe Dhjetor për çdo vit 2021, 2022, 2023) dhe rezultoi se:
▪Për muajt e përzgjedhur të vitit 2021 dhe vitit 2022 listëprezencat nuk plotësoheshin konform rregullave të përcaktuara, pasi nuk janë të nënshkruara nga përgjegjësi ose menaxheri i sektorit përkatës. Për vitin 2023 listëprezencat janë plotësuar nga përgjegjësi i sektorit. Listëpagesat janë të firmosura nga NA dhe NZ. Është përgatitur përmbledhësja e listëpagesave e cila nuk është nënshkruar nga menaxheri i burimeve njerëzore, *në kundërshtim me përcaktimet në pikën* ***69*** *të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.*
▪Listëprezencat janë të shoqëruara me raporte mjeksore, në raste të mungesës shëndetësore të punonjësit, për punonjësit që janë me raport mjekësor për paaftësi të përkohëshme në punë deri në 14 ditë që paguhen nga punëdhënësi, por në disa raste ka aplikuar masën 70% të mesatares 6 mujore të pagës për punonjësit që kanë më pak se 10 vite punë, në referencë të pikës 1, të nenit 23, dhe nenit 25 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipësrisë", por duhet sqaruar se ky ligj i referohet periudhës që do të mbulohet nga Sigurimet Shoqërore dhe jo periudhës deri në 14 ditë që duhet të justifikohet me raport mjeksor dhe paguhet nga punëmarrësi Ligji nr. 7703, datë 11/05/1993, i ndryshuar.
Në lidhje me llogaritjen e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar me raport mjeksor deri në 14 ditë, Ligji nr 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e shqipërisë" i ndryshuar, në pikën 1 të nenit nr.130, përcakton se: "*Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo më pak se 80% e pagës, për një periudhë prej 14 ditësh, të pambuluara nga Sigurimet Shoqërore*", si dhe me Nenin 25, të Ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993, të ndryshuar.
*Për shkeljet e konstatuara në lidhje me listëprezencat mbajnë përgjegjësi z.P.T. me detyrë P/Sektorit të Shërbimit dhe Financës z. D. V. me detyrë drejtor i komanduar prej 04.05.2022 e në vazhdim.*
**<u>Situata:</u>** Nga auditimi mbi rregullshmërinë e pagave, shtesave në pagë, kontributit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe disa pagesa të tjera ka rezultuar përllogaritje të gabuara dhe jo sipas rregullave dhe kërkesave ligjore përkatëse, si më poshtë**:**
-Për vitin 2021, 2022 liste prezencat nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit përkatës, ndërsa për vitin 2023 janë nënshkruar korrekt nga përgjegjësi i sektorit përkatës. Përmbledhësja e liste pagesave gjithashtu nuk është nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, duke shkelur përcaktimet në pikën 69 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.20211, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

-Llogaritja e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar me raport mjekësor deri në 14 ditë, në disa raste nuk është bërë me 80%, *sipas Nenit nr.130 pika 1 të Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenit 25, të ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993, të ndryshuar.*

**Kriteri:** të Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Neni nr.130 pika 1 dhe Ligji nr. 7703, datë 11/05/1993, të ndryshuar; Nenit 25 në të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.201. "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 69.

**Ndikimi/Efekti:** Mos administrimi i drejtë i fondeve buxhetore për pagesat për paaftësi të përkohshme në punë deri në 14 ditë.

**Shkaku**: Mangësi në zbatimin konform kuadrit ligjor në fuqi të kryerjes së pagesave për paaftësi të përkohshme në punë deri në 14 ditë.

**Rëndësia:** E mesme

**Në lidhje me rregullshmërinë e kryerjes së pagesave te tjera.**

**Situata:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë e pagave, shtesave në pagë dhe disa pagesa të tjera kanë rezultuar përllogaritje të gabuara dhe jo sipas rregullave dhe kërkesave ligjore përkatëse, si më poshtë**:**

**1**. Në shumën e përllogaritjeve për pagën e z. M. H., rezulton se është paguar 16,398 lekë më shumë se sa duhet. Kjo diferencë duhet të rikthehet në llogarinë e institucionit, në mosrespektim me Udhëzimin Nr. 1 datë: 21/05/2021 "Për formën, elementët dhe plotësimin e liste pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 13.

**2.** Në periudhën 2021-2023, janë likuiduar gjoba në shumën e 80,000 lekë (16x5,000 lekë) për deklarim të vonuar të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik i tatimeve. Shuma prej 80,000 lekë ka rënduar padrejtësisht buxhetin e institucionit, pasi vjen si rezultat i neglizhencës së NZ dhe duhet të kthehet në llogarinë e institucionit, veprim ky në kundërshtim me Nenin 35 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

**3.** Janë likuiduar detyrime të prapambetura për energji elektrike për periudhën 2020-2023 në shumën 614,107 lekë, nga e cila shuma prej 139,532 lekë rezulton kamatë. Likuidimi i tyre është rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve ligjore për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, siç parashikohet në pikën 151 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", dhe në Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", pika 3. Shuma e kamatës 139,532 lekë, konsiderohet dëm dhe duhet kthyer në llogarinë e institucionit përgjegjësi e së cilës janë drejtori komanduar z. D. V., dhe Përgjegjësin e Financës, z. P. T..

**4.** Janë likuiduar detyrime për qira në shumën 66,000 lekë (56,600 lekë detyrim+9,900 lekë Tatim i mbajtur në burim) sipas Kontratës së qirasë nr.1036 prot., datë 28.07.2020 për një ambient, mjedis pune në Bashkinë Gjirokastër, i cili nuk përmbush elementët ligjorë të një kontrate të vlefshme, pasi nuk është nënshkruar nga pala qiradhënëse, në kushte të mosrespektimit të nenit 801 të Kodit Civil. Gjithashtu likuiduar edhe tatim i mbajtur në burim, ndërsa neni 11 i kontratës e përcakton si detyrim të palës qiradhënëse. Nuk konfirmohet të jetë lidhur kontratë tjetër pas kësaj dhe pagesa nga zyra e financës ka vazhduar deri në vitin 2021.

**5.** Janë paguar shpenzime udhëtimi në shumën 137,800 lekë si pasojë e mënyrës së llogaritjes gabim dhe mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (pa akt kontroll/procesverbal konstatimi), në kundërshtim me nenin 4, pika 26 e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit.

**<u>Kriteri:</u>** Udhëzimin Nr.1 datë 21/05/2021 “Për formën, elementët dhe plotësimin e liste pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 13; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Neni 35; Udhëzimi nr.9 , datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 151; Kodit Civil neni 801; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar nenin 4, pika 26; Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, e, dhe pika 36;
Vendimin nr.254 datë 28.12.2021 të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimin me nr.1769, datë 28.12.2021.
**<u>Ndikimi/Efekti:</u>** Shpenzime dëmi.
**<u>Shkaku:</u>** Mangësi në njohjen dhe zbatimin e ligjit për menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe të legjislacionit tatimor.
**<u>Rëndësia:</u>** E lartë

*Në lidhje me menaxhimin e konsumit të karburantit për mjetet e transportit pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, për periudhën 01 Janar 2021 – 31 Dhjetor 2023.*

Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, justifikues të magazinës dhe praktikave të fletudhëtimeve për periudhën e auditimit 2021-2023 rezultoi si më poshtë:

Për vitin 2023 nuk është i caktuar personi përgjegjës për përdorimin e sistemit elektronik të karburantit, në kundërshtim me përcaktimin në pikën 3.7 të kontratës.

-Struktura organizative e miratuar përfshin një shofer të caktuar (z.B.D.) për përdorimin e automjetit. Megjithatë, nuk ka urdhër nga titullari për të autorizuar personat e tjerë për përdorimin e automjeteve. Autorizimi për përdorimin e automjeteve dhe caktimi i targave duhet të përputhet me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar, pika 35, - dokumentet autorizuese.

-Për periudhën 2021 dhe 2022, me shkresë nr. 908 prot., datë 18.02.2021, të titullarit të njësisë, është dërguar kërkesë për pajisjen me kartë për furnizimin me karburant për automjetet me targat: A..E, T...J, T..A tek kontraktuesi BOE "K. shpk" dhe "K. G.". Në vend të kësaj, furnizimi u bë në një targë tjetër, A...G, duke shkelur përcaktimet në pikat 3.5 dhe 3.9 të kontratës. Ndërsa fletudhëtimet janë hartuar sipas automjeteve, çka nuk mund të rakordohen me sasinë e shpërndarë nga sistemi elektronik.

-Sasia totale e kërkuar për furnizimin me karburant për periudhën audituese nuk është dokumentuar me shkresa zyrtare të firmosur dhe të vulosur nga titullari, të cilat duhet t’i dërgohen kontraktuesit në mënyrë zyrtare, përmes e-mail -it, postës, ose personit të autorizuar. Nga auditimi rezulton se kërkesa është bërë drejtpërdrejt në email-in e kontraktuesit, me urdhër verbal nga drejtuesi, duke shkelur përcaktimet në pikat 3.6 dhe 3.9 të kontratës.

Tabelë nr. 40 Krahasimi i gjendjes së karburantit (naftë), midis magazinës dhe sistemit elektronik të përdorimit të kartave, për periudhën 2021-2023.

| Nr. | Periudha | Magazinë | | Sistem Elektronik | | Gjendja në fundvit | | Gjendja në Sist.Elek |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Hyrje | Dalje | Hyrje | Dalje | Magazinë | Sist.Elektr. | |
| | | Sasi | Sasi | Sasi | Sasi | Sasi | Vlerë | |
| 1 | Viti 2021 | 4,200 | 4,181 | 4,200 | 4,120 | 19 | 80 | 78 |
| 2 | Viti 2022 | 4,200 | 495 | 4,200 | 3,820 | 3,705 | 380 | |
| 3 | Viti 2023(Sasia pas përfundimit të.afatit) | | | | 382 | - | (382) | |
| 4 | Viti 2023 | 2,600 | 1,699 | 2,600 | 1,699 | 901 | 901 | 217 |
| 5 | Viti 2024(vazhdim i Kontratës V.2023) | | 684 | | 684 | (684) | (684) | |

***Burimi: Sipas të dhënave nga Zyra e Financës e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, përpunuar nga grupi i auditimit.***

***Në mënyrë të përmbledhur rezulton se për vitet 2021-2023:***

-Ka mospërputhje midis fletëdaljeve të magazinës për karburantin (naftë) dhe përdorimit të tij nga programi i kartave elektronike. Konkretisht:

-<u>Për vitin 2021</u>, nga magazina janë bërë dalje më shumë në sasinë 61 litra se sa nga programi i kartave elektronike**.**
-<u>Për vitin 2022</u>, nga magazina janë bërë dalje më pak në sasinë 3,525 litra se sa nga programi i kartave elektronike**.**
Gjithsej sasia e kërkuar për <u>vitin 2021, 2022</u> nga AK dhe e ngarkuar në sitemin elektronik është 8,400 litra dhe shpërndarë 8,323 litra, pra sasia e mbetur 78 litra duhej të ishte gjendje pas përfundimit të planit të shpërndarjes.
<u>Për vitin 2023</u>, nga magazina janë bërë dalje gjithsej 2,383 litra, e cila rakordon me daljet nga sistemi elektronik, si dhe me fletudhëtimet e dorëzuara, sasia e papërdorur është 217 litra, bërë dalje në janar 2024. Nga auditimi i praktikave të mbajtjes së dokumentacionit në lidhje me karburantin, rezultoi se:
- Nuk mbahen kartela për karburantit (naftë), në kundërshtim me pikën 40 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar* pika 40.
-Për vitin 2021, 2022 fletëdaljet e magazinës janë të hartuara vetëm në sasi, pa përcaktuar edhe targat përkatëse të automjeteve dhe nuk kanë të bashkëlidhur asnjë dokument justifikues, që vërteton lëvizjen e karburantit, gjurmën e menaxhimit të tij sipas përgjegjësive, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar* ***pika*** **38** si dhe me <u>Rregulloren</u> e organizimit dhe funksionimit të ARM
II. X Detyrat funksionale të përgjegjësit të sektorit-Detyrat funksionale të specialistit të financës. Ndërsa fletudhëtimet janë hartuar sipas targave të automjetit dhe personave udhëtues, sipas përcaktimit në autorizimin e lëshuar nga titullari.
- Për periudhën nga 19.04.2021- 20.06.2022 z.N.S., me Urdhër nr.1531 prot., datë 19.04.2021 me detyrë specialist i Sektorit të Lejeve dhe VNM-ve i është deleguar detyra e magazinierit ku rezulton se ka tërhequr nga magazina 738 litra karburant (naftë). Fletëdaljet janë të paplotësuara në vlerë e të nënshkruara prej z.N.S. edhe si magazinier edhe si marrës i mallit (naftë).

| Fletëdalje Magazinë | Sasi | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|
| 23.09.2021 | 210 | 168 | 35,280 |
| 29.10.2021 | 238 | 175 | 41,650 |
| 26.11.2021 | 160 | 183 | 29,280 |
| 16.12.2021 | 130 | 184 | 23,920 |
| **TOTALI** | **738** | | **130,130** |

Sasia e tërhequr nga sistemi elektronik i përdorimit të kartave nuk përputhet me asnjë datë të daljeve nga magazina. Referuar çmimeve të furnizimeve nga sistemi për këto data, del se sasia 738 litra është në vlerën 130,130 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 22 pika 3 Veprimtaritë e kontrollit të Ligjit nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; UMFE nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 36.
Sa më sipër për veprime në kundërshtim me Ligjin Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin mbajnë përgjegjësi z.N.S. i ngarkuar me detyrën e magazinierit.
-Nga krahasimi i fletë udhëtimeve të dorëzuara me sasinë e karburantit të marrë sipas sistemit elektronik të përdorimit të kartave konstatohen diferenca, si më poshtë:
Tabelë nr. 41 Krahasimi i Fletë Udhëtimeve me daljet nga sistemi elektronik, viti 2021.

| Tipi Automjetit | Sasi sipas FletëUdhëtimit, në Litra | Dalje nga Kontraktuesi) Sistemi Elekt) Litra | Dalje nga Kontraktuesi)Sistemi Elekt) Lekë | Diferenca Kontraktues-F.Udhetime, në Litër | Diferencë në Vlerë |
|---|---|---|---|---|---|
| T...J | 3321 | | | | |
| A..E | 326 | | | | |
| A...S | 544 | | | | |
| **Total** | **4,191** | **4,120** | **691,997** | **-71** | **95,722** |

Burimi: Të dhëna nga sistemi elektronik i përdorimit të kartave, fletudhëtimet, ARM Fier, përpunuar G.A
-Sic shihet, për vitin 2021, sasia e karburantit (naftë) e justifikuar me fletudhëtime, rezulton për 71 litra më shumë, çka tregon për një mos akordim të daljeve nga magazina, sistemit elektronik të përdorimit të kartave e plotësimit të fletë udhëtimeve.

Tabelë nr. 42 Krahasimi i Fletë Udhëtimeve me daljet nga sistemi elektronik, viti 2022

| Tipi Automjetit | Sasi sipas FletëUdhëtimit, në Litra | Dalje nga Kontraktuesi)Sistemi Elekt) Litra | Dalje nga Kontraktuesi)Sistemi Elekt) Lekë | Diferenca Kontraktues-F.Udhetime, në Litër | Diferencë në Vlerë |
|---|---|---|---|---|---|
| T...J | 591 | A...G | | | |
| A...S | 1839 | A..G | | | |
| **Total** | **2,430** | 4202 | 930,420 | 1,772 | **420,794** |

Burimi: Të dhënanga sistemi elektronik i përdorimit të kartave, fletëudhëtimet, ARM Fier, përpunuar G.A

Tabelë nr.43 Karburant(naftë) i pajustifikuar me Fletë Udhëtimeve, viti 2022

| **Furnizime nga Sistemi Viti 2022** | | | **Justifikuar me FLetëUdhëtimi** | | **Diferenca Sitemi-FletëUdhëtime** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muaji** | **Sasia** | **Vlerë** | **Sasi Targa T..J** | **Sasi Targa A..S** | **Sasi** | **Vlerë** |
| Janar | 495 | 90,645 | 202 | 229 | (64) | (11,712) |
| Shkurt | 366 | 69,956 | 38 | 485 | 157 | 29,987 |
| Mars | 242 | 55,024 | 168 | 203 | 129 | 29,025 |
| Prill | 196 | 45,680 | | 255 | 59 | 13,747 |
| Janar-Prill 2022 | 1,299 | 261,305 | 408 | 1172 | 281 | 61,047 |
| Maj | 404 | 95,636 | 183 | 285 | 64 | 15,104 |
| Qershor | 468 | 119,556 | | | (468) | (119,556) |
| Korrik | 407 | 95,683 | | | (407) | (95,683) |
| Gusht | 457 | 103,014 | | | (457) | (103,014) |
| Shtator | 310 | 70,506 | | | (310) | (70,506) |
| Tetor | 251 | 59,704 | | | (251) | (59,704) |
| Nentor | 106 | 25,000 | | | (106) | (25,000) |
| Dhjetor | 118 | 23,482 | | | (118) | (23,482) |
| Maj-Dhjetor 2022 | 2,903 | 669,115 | 183 | 285 | (2,053) | (481,841) |
| **Totali 2022** | **4,202** | **930,420** | **591** | **1457** | **(1,772)** | **(420,794)** |

Burimi: Të dhënanga sistemi elektronik ipërdorimittë kartave, fletëudhëtimet,ARM Fier, përpunuar G.A

- ✓ Për vitin 2022 rezulton se sasia e karburantit (naftë) 1,772 litra në vlerën 420,794 lekë është e pajustifikuar me dokumentacion vërtetues, fletudhëtim. Personat përgjegjës për këtë periudhë janë z.D. V. në cilësinë NA prej datës 04.05.2022, z. P. T. në cilësinë NZ dhe z. B. D. me detyrë shofer në strukturën organizative, veprime në kundërshtim me pikën 36 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- ✓ Për vitin 2023 nuk rezultojnë diferenca në plotësimin e fletudhëtimeve dhe daljeve nga sistemi elektronik i përdorimit të kartave dhe fletëdaljeve të magazinës.
- ✓ Nuk ka asnjë rregullore të brendshme për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, për administrimin dhe përdorimin e karburantit.
- ✓ Nuk ka kontrolle të shpenzimeve të fondit për karburant që të verifikojnë nëse fondet publike shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër.
- ✓ Urdhërin për ngritjen e komisionit të testimit të harxhimit të karburantit me shkresë nr. 3434 prot, datë 24.11.2023 i titullarit nuk shpjegon se si është caktuar z.D.A.ing. mek. person i jashtëm dhe nuk ka bashkëlidhur ndonjë licence apo diplomë që të sigurojë në mënyrë profesionale raportin e këtij komisioni.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar Neni 9, pika1. Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues Neni 9, pika 4 gërma "f" s*i dhe me* UMFE nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

*Z. D.V. me detyrë drejtor i ARM Fier për periudhën nga 04.05.2022 e në vazhdim dhe z.P.T. me detyrë P/Sektorit të Shërbimit dhe Financës.*

**Situata:** Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur për furnizimin me karburant në ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër për periudhat 2021-2022 rezultuan problematika si më poshtë:

-Mosrespektimi i kërkesave për kartat e personalizuara për furnizimin me karburant për çdo automjet, por të bërë në një targë të vetme, është *në kundërshtim me përcaktimin në pikën 3.5 dhe 3.9 të kontratës dhe Ligjit nr.10296, datë 078.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe*

*kontrollin", i ndryshuar, Neni 12 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues pika 2 gërma "dh" dhe gërma "f".*
-Mungon shkresa zyrtare firmosur dhe vulosur nga titullari, për sasinë totale të kërkuar për furnizimin me karburant për periudhën audituese, duke shkelur *pikat 3.6 dhe 3.9 të kontratës(vitit 2021) dhe pikën 3.7(vitit 2023).*
-Mospërputhja midis raportimit të karburantit në fletëdaljet e magazinës dhe sistemit elektronik të kartave, (për vitin 2021 është 61 litra më shumë, për vitin 2022 është 3,820 litra më pak) shfaq mungesë të kontrollit, transparencës si dhe mungesë të gjurmës së menaxhimit të tij sipas përgjegjësive, *në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar pika 52,54,58,59 si dhe me Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të ARM*
*II. X Detyrat funksionale të përgjegjësit të sektorit-Detyrat funksionale të specialistit të financës.*
-Mungesa e dokumentacionit të plotë vërtetues dhe të rregullt (fletëhyrje dhe fletëdalje) si dhe të pashoqëruara me dokumente justifikuese është në kundërshtim me kërkesat ligjore në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësite sektorit Publik", i ndryshuar pika 37,38.
-Nuk mbahen kartela karburant, në kundërshtim me *UMF nr. 30, datë27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar pika 40.*
-Urdhrat për ngritjen e komisioneve të testimit të konsumit të karburantit janë dhënë, personave të jashtëm pa dokumentacionin dhe përgjegjësinë e duhur, duke shkelur ligjin dhe rregullore të përgjegjësisë menaxheriale të punonjësve.
-Z.N.S., në cilësinë si magazinier edhe si marrës i mallit (naftë), ka tërhequr 738 litra karburant nga magazina në vlerë 130,130lekë, veprim ky në kushte të paligjshmërisë dhe në kundërshtim me Neni 22 Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; UMFE nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 36.
-Për vitin 2022, sasia 1,772 litra karburant (naftë), në vlerë 420,794 lekë, është e pajustifikuar me dokumentacion vërtetues, fletudhëtim. Personat përgjegjës për këtë periudhë janë z.D. V. në cilësinë NA prej datës 29.04.2022, z. P. T. në cilësinë NZ dhe z. B.D. me detyrë shofer në strukturën organizative, veprime në kundërshtim me pikën 36 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", duke shkaktuar dëm financiar dhe duhet kthyer në buxhetin e shtetit.
**Kriteri**: Ligji nr.10296, datë 078.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 9, pika1. pika 4 gërma "f", *Neni 12 pika 3 gërma"dh";* Neni 22 Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin
UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar pika 40, pikat 36, 37, 38, 40, pikat 52,54,58,59 si dhe me Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të ARM II. X Detyrat funksionale të përgjegjësit të sektorit-Detyrat funksionale të specialistit të financës.
**Ndikimi/Efekti:** Moszbatimi i dispozitave ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit të fondeve buxhetore sjell dëme/efekte negative në buxhetin e shtetit.
**Shkaku:** Kontroll i dobët në menaxhimin e aktiveve të institucionit; Mungesa e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit dhe planifikimit të shpenzimeve ka çuar në rrezikun e keqpërdorimit dhe menaxhimit të aktiveve.
**Rëndësia:** E lartë

***Në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.***
ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, në cilësinë e AK, mbështetur në Neni 33 pika 1/c e Ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" Neni 11, 1/c si dhe Udhëzimin Nr.5 datë 25.06.2021 "*Mbi*

*përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", ka përdorur procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, konkretisht:
**Për vitin 2021** ka realizuar 8 procedura prokurimi, me vlerë totale 1,082,137 lekë me tvsh, ndër të cilat:
1. Procedurë prokurimi "Prokurim me vlerë të vogël", në total 1 procedurë prokurimi me vlerë 687,600 lekë me tvsh.
2. Procedurë prokurimi "Prokurim nën 100,000" në total 7 procedura prokurimi me vlerë 394,537 lekë me tvsh.
**Për vitin 2022** ka realizuar 8 procedura prokurimi, me vlerë totale 1,170,131 lekë (me tvsh), ndër të cilat:
1. Procedurë prokurimi "Prokurim me vlerë të vogël", në total 1 procedurë prokurimi me vlerë 288,000 lekë me tvsh.
2. Procedurë prokurimi "Prokurim nën 100,000" në total 7 procedura prokurimi me vlerë 882,131 lekë me tvsh.
**Për vitin 2023** ka realizuar 7 procedura prokurimi, me vlerë totale 1,848,654 lekë me tvsh, ndër të cilat:
1. Procedurë prokurimi "Prokurim me vlerë të vogël", në total 3 procedura prokurimi me vlerë 1,604,700 lekë me tvsh.
2. Procedurë prokurimi "Prokurim nën 100,000" në total 4 procedura prokurimi me vlerë 243,954 lekë me tvsh.
Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua se:
a) Në vitin 2021 për 5 procedura në shumën 266,066 lekë dhe në vitin 2022 për 8 procedura në shumën 576,342 lekë AK ka përdorur procedurën e prokurimit <u>me vlerë nën 100,000 lekë</u> (pa TVSH) për blerje malli, të cilat nuk janë kryer konform kuadrit rregullator për prokurimet me vlerë të vogël:
b) Nga 13 procedura të realizuara në vitin 2021 dhe vitin 2022, në 6 prej tyre në vlerën 320,326 lekë, në dosjen fizike mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim, ndërsa në raste të tjera nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim.
c) Komisioni i prokurimit për blerjet e vogla në 4 raste për vitin 2021 dhe në 4 raste për vitin 2022 ka përzgjedhur gabim procedurën e prokurimit në formë shkresore. Kështu për vitin 2021 janë prokuruar 4 procedura për materiale pastrimi në vlerën 136,390 lekë dhe në vitin 2022 janë prokuruar 4 procedura për materiale kancelari në vlerën 383,942 lekë, duke copëzuar kontratën për blerje materiale pastrimi dhe kancelari, në kundërshtim me Nenin 34 të LPP - Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit; Neni 12 Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës të VKM nr.285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z.P.T. me detyrë P/Sektorit të Shërbimit dhe Financës dhe komisioni marrjes në dorëzim të vitit 2021 përkatësisht: z.A. Q. (kryetar), zj, S.Th. (anëtar), z. E.Z.(anëtar) dhe komisioni marrjes në dorëzim të vitit 2022 përkatësisht: z. E.Z. (kryetar). Zj. S. T. (anëtar), z. E. Sh. (anëtar).*
<u>**Situata:**</u> Në auditimin e dokumentacionit shoqërues për procedurat e prokurimit nën 100,000 u përzgjodhën 13 dosje, ku rezultoi se janë realizuar në kushtet jo korrekte të zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, përkatësisht:
Në vitin 2021 për 5 procedura në shumën 266,066 lekë dhe për vitin 2022 për 8 procedura në shumën 576,342 lekë.
-Nga 13 procedurat e realizuara, në 6 prej tyre në vlerën 320,326 lekë në dosjen fizike mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim, ndërsa në raste të tjera nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, *në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, pikat 43,47,54.*

-Për vitin 2021 dhe vitin 2022 nga ana e titullarit nuk është caktuar personi përgjegjës për prokurimin, *në kundërshtim me VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 74 pika 1 Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit.*

-Kërkesat për mallra/punë/shërbime nuk janë hartuar nga degët përkatëse, *në kundërshtim me Neni 56, pika 2 e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021.*

-Procesverbali i testimit të tregut dhe përllogaritjes së fondit limit në disa raste është bazuar në ofertat ekonomike në vlerë totale dhe jo të detajuar sipas zërave që do të prokurohen dhe me çmimet për njësi, *në kundërshtim me VKM-së nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 13, pika 7 Studimi paraprak i tregut; Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 pika 7.*

-Nuk janë hartuar deklaratat e konfliktit të interesit nga të gjithë personat përgjegjës të caktuar në komision të prokurimit, në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 73.*

-Në të gjitha dosjet e procedurës së prokurimit të përzgjedhura mungon paraqitja e vetë deklaratës me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit, *në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 26 Formulari përmbledhës i vete deklarimit.*

-Në të gjitha dosjet e procedurës së prokurimit të përzgjedhura nuk është hartuar Relacioni përmbledhës, *në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar neni 2 Dokumentimi i procesit dhe Neni 84 Raporti Përmbledhës:*

-Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit dhe me nenin 74, pika 1 paragrafi 2 e VKM nr.285, datë 9.05.2021.

-Komisioni i prokurimit për blerjet e vogla në 4 raste për vitin 2021 dhe në 4 raste për vitin 2022 ka përzgjedhur gabim procedurën e prokurimit në formë shkresore. Kështu për vitin 2021 janë prokuruar 4 procedura për materiale pastrimi në vlerën 136,390 lekë dhe në vitin 2022 janë prokuruar 4 procedura për materiale kancelari në vlerën 383,942 lekë, duke copëzuar kontratën për blerje materialë pastrimi dhe kancelari, në kundërshtim me Nenin 34, pika 2 të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" - Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit; Neni 12, pika 3 Metoda të zbatueshme në përllogaritje*n e vlerës së kontratës të VKM nr.285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*

**Kriteri:** *Ligji Nr.162/2020 "Për prokurimin publik" pika 2 e Nenit 34;* UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 15,43,47,54;

VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", pika 1 e Nenit 74 dhe paragrafi 2 i tij; pika 2 e Nenit 56; pika 7 e Nenit 13; Neni 26; Neni 73, Neni 2 dhe Neni 84; pika 3 e Nenit 12; Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, pika 7.

**Ndikimi/Efekti***:* Devijim nga procedurat dhe rregullat e prokurimit publik.

**Shkaku**: Mosnjohje e legjislacionit dhe kontrolle të dobëta në procesin e prokurimit.

**Rëndësia:** E Lartë

Procedura e prokurimit blerje me vlerë të vogël, kryer në sistemin elektronik të prokurimit me objekt: "Blerje pjesë këmbimi për automjetin tip Hynday Tucson me targë A...S" me vlerë 687,600 lekë me Tvsh, është kryer në shkelje të kërkesave të ligjit të prokurimeve dhe akteve ligjorë të dalë në zbatim të tij, si më poshtë:

Procedura e prokurimit: "Blerje pjesë këmbimi për automjetin tip Hynday Tucson me targë A...S".

| | | |
|---|---|---|
| **Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 13, datë 30.07.2021 ( nr. 2978 prot., datë 30.07.2021) | **Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël.**<br>Urdhër nr. 2879 prot, datë 26.07.2021<br>Z. P. T. | -Vlera fituese 573.000 lekë pa TVSH<br>-Vlera kontratës ose faturës: |

| | | |
|---|---|---|
| **Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>" Blerje me vlerë të vogël" | Zj. F. B.<br>Z. E. Z. | Fatura tatimore nr. 33, datë 19.08.2021 me vlerë 687.600 lekë me TVSH. USH nr.55, datë 13.09.2021 me vlerë 687,600 lekë, Fletëhyrje nr.10, datë 19.08.2021. |
| **Fondi Limit (pa tvsh)** 575,000 lekë | **Oferta fituese (pa tvsh)**<br>"S." shpk | **Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>2,000 lekë |
| **Data e hapjes së tenderit:**<br>03.08.2021 | **Burimi Financimit**<br>Fondet e ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër | **Operatoret Ekonomike**<br>Pjesëmarrës në tender: 7 OE<br>b) S' kualifikuar: 5 (OE)<br>c) Kualifikuar: 2 (OE) |
| **11. Ankimime**<br>Ankim në lidhje Verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të audituara | **12. Përgjigje Ankesës nga AK**<br>Kthyer përgjigje nga AK me shkresë nr. 3681 prot., datë 18.10.2021 | **13.Përgjigje Ankesës nga KKP**<br>Dërgim Vendimi nga APP Nr.84, datë 10.12.2021<br>Me shkresën nr. 5980/4, datë 10.12.2021 |

Procedura e prokurimit është kryer nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik ku rezulton se procedura e parë është anulluar sipas procesverbalit të anullimit të tenderit me nr.2964 prot., datë 29.07.2021 nga komisioni i prokurimit dhe miratuar nga drejtori z. A. V.. Theksojmë se arsyeja e anulimit, sipas komisionit të prokurimit, ka qënë një gabim teknik në procedurë gjatë përdorimit në SPE.

**Situata:** Nga auditimi i realizimit të procedurës së prokurimit për blerje me vlerë të vogël me objekt: "Blerje pjesë këmbimi për automjetin tip Hynday Tucson me targë A...S" nga subjekti "S.." sh.p.k, rezultoi se:

**1.** Nga ana e AK nuk është përdorur baza ligjore e ndryshuar (si mungesë përvoje), ndërkohë që Ligji 162/2020 ka hyrë në fuqi nga data 31.03.2021; VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ka hyrë në fuqi nga qershor 2021; Udhëzimi nr.5, datë 25.6.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

**2.** Specifikimet teknike në procesverbalin 2978/1 datë 30.07.2021, nuk janë të argumentuara, *në kundërshtim me Nenin 78, pika 2 e VKM-së nr.285, datë 09.06.2021 - Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit.*

**3.** Vërtetimi i IBAN-it dhe llogarisë bankare *nuk përbën kriter të specifikimit teknik, në kuptim të ligjit të Prokurimit Publik.*

**4.** Kriteri që subjekti duhet të operojë në rrethin e Fierit, për shkak se në rast defekti të mundshëm, për pjesët e këmbimit të vendosura, mund të rriten shpenzimet e transportit nga vendndodhja deri në serverin e firmës jo më larg se 20 km nga qyteti i Fierit, nuk është i argumentuar, pasi AK në ftesën për ofertë duhet të përcaktojë që shpenzimet e transportit të përballohen nga OE. Gjithashtu vet AK është *në kundërshtim me pikën 12 te Kriteret e përgjithshme ku përcakton se: Subjekti të ushtroj aktivitetin brenda territorit të RSH-së.*

**5.** Përcaktimi i fondit limit është bërë bazuar vetëm në një çmim referues, duke mos qenë kështu koherent me çmimet reale të tregut dhe duke mos iu krijuar mundësi pjesëmarrje më shumë OE, *në kundërshtim me Nenin 56, 76 Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit të VKM-së nr.285, datë 09.06.2021.*

**6.** Nga AK në kriteret e përgjithshme janë kërkuar licenca, dëshmi, kontrata me institucione të licencuara si: Licenca e Auto riparimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove sipas Udhëzimit nr.1546, datë 29.03.2019. Kodi VII3.B.1 (++++); Kodi VII.3.B.3; Leje mjedisore Tipi C ose B. Kontrata me një institucion të Licensuar Kodi III.2.B për shkarkimin e vajrave të përdorur; Kontrata me një institucion të Licensuar për shkarkimin e gomave të përdorur; *Kontrata me një institucion të Licensuar për shkatërrimin e mbetjeve metalike, për të cilat nuk është argumentuar asnjë prej tyre dhe nuk janë hartuar nga specialist të fushës dhe se nuk kanë lidhje me realizimin e objektit të prokurimit, në kundërshtim me Neni 77 pika 1 e LPP; Nenin 78 pika 2 e VKM nr.285, datë 09.06.2021.*

**7.** Ftesa për ofertë nuk ka të përcaktuar afatin e paraqitjes së operatorit ekonomik fitues, i cili minimalisht është 24 orë nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit, *në kundërshtim me pikën 12 të Udhëzimi nr.5, datë 25.6.2021.*
**8.** Nga KVO nuk rezulton të ketë raport përmbledhës për titullarin ku të njoftojë për ecurinë e procesit të vlerësimit, të problematikave dhe shpalljen e ofertuesit fitues, *në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 84 Raporti Përmbledhës.*
**9.** Dokumentacioni i dorëzuar rezulton të jetë i noterizuar, *por vula nuk është shumë e dallueshme.*
**10**. AK vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse është në përputhje me kërkesat e specifikimet e përcaktuara nga ajo vet, pa rënë ndesh me nenin 38 të Ligjit 162/2020. Pra, AK *është në kushtet e mosrespektimit të Nenit 92 pika 3, Shqyrtimi i ofertave dhe Neni 77 pika 1 e Ligjit 162/2020.*
Pra, subjekti "S." sh.p.k, Sh.P.K nuk plotëson kriteret e vendosur në Ftesën për ofertë dhe në këto kushte, Njësia e prokurimit nuk duhej të kishte kualifikuar OE dhe nuk duhej t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. Përvec kësaj janë vendosur kritere, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik , të cilat nuk janë argumentuar asnjë prej tyre dhe nuk janë hartuar nga specialist të fushës dhe se nuk kanë lidhje me realizimin e objektit të prokurimit. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Njësinë e prokurimit e përbërë nga: z. P.T. (kryetar), znj. F.B. dhe z. E. Z.(anëtar).
**Kriteri:** Nenin 78, pika 2 e VKM-së nr.285, datë 09.06.2021; Nenin 56, 76 Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit të VKM-së nr.285, datë 09.06.2021; me Neni 77 pika 1 e LPP; Nenin 78 pika 2 e VKM nr.285, datë 09.06.2021; Neni 84 Raporti Përmbledhës i VKM nr.285, datë 19.05.2021"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"; Nenit 92 pika 3, Shqyrtimi i ofertave dhe Neni 77 pika 1 e Ligjit 162/2020;
Pikën 12 të Udhëzimi nr.5, datë 25.6.2021.
**Ndikimi/Efekti:** Devijim nga procedurat dhe rregullat e prokurimit publik.
**Shkaku:** Mangësi në njohjen dhe zbatimin e ligjit për prokurimin publik.
**Rëndësia:** E lartë

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, rezultoi se nuk janë dërguar Kërkesat buxhetore PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025 në Ministrinë përgjegjëse për financat, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kundërshtim me Nenin 24, 27 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.Udhëzimin plotësues nr.28, datë 10.07.2020 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023", neni 27 dhe Udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 28.02.2022 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025", pika 4, 9 e tij.,
-Kërkesat buxhetore për **PBA 2022-2024** nuk janë dërguar në mënyrë elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS); nuk janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, si dhe dërguar jashtë afateve ligjore të përcaktuara (40 ditë më vonë), në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit plotësues nr. 8, datë 26.02.2021 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024", pika 4, 9, 10 si dhe me Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm" 2.5. Përgjegjësitë e

Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 7-8-18-15 të Raportit të Auditimit).*
**1.1.Rekomandimi**: Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të marri masa të hartojë Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetur në shqyrtimin e shpenzimeve të mëparshme dhe në përcaktimin e nevojave për të ardhmen në bazë të aktivitetit të planifikuar.

***Në vijimësi***

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër është paraqitur kërkesë për shpenzime për investime për shumën 3,770 mijë lekë në PBA 2022-2024, e cila nuk është miratuar në buxhetin vjetor të shpenzimeve. Mosmiratimi i fondeve për investime çon në mos ushtrimin e mos funksionimin normal dhe me efektivitet të aktivitetit të institucionit.
-Nga auditimi rezulton se NA dhe NZ, për të tre vitet objekt auditimi, nuk janë dërguar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, të cilat dërgohen në MTM. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cënojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 14-15 të Raportit të Auditimit)*
**2.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të identifikojë prioritetet kryesore për investime në bazë të një analize të detajuar për të siguruar që ato të jenë të përshtatshme dhe të qëndrueshme në shërbim të aktivitetit të institucionit.
**2.2.Rekomandimi;** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të marrë masa të hartojë raportet e monitorimit 4, 8 dhe 12 mujore, të realizimit të treguesve në raport me parashikimet pritshme si dhe në raportin 8 mujor të ofrojë informacion shtesë në përputhje me planin fillestar të parashikuar.

***Në vijimësi***

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër, mbi pasqyrat financiare rezultoi si më poshtë:
1.Pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Fier nëpërmjet sistemit C@ts, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*" i ndryshuar, pika 3.12. "*Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit*" në lidhje me depozitimin on-line të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës.
2.Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin, në mosrespektim të kërkesave të Nenit 3, pika 1 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Kreu II Dispozita të Përgjithshme mbi Dokumentet Kontabël dhe Pasqyrat Financiare Neni 6, Mbajtja e kontabilitetit, Neni 7 Dokumenti kontabël; Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu II 2.1 "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 2.2; Kreu III Paragrafi 43.
-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjikë në excel me vlera, por nuk janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës, etj, në të cilat regjistrohen të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të marra nga dokumentet bazë të bankës, magazinës; nuk janë mbajtur parti taret për llogaritë kreditore e debitorë.
-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin

vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël, të cilat shërbejnë si bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të marra nga dokumentet vërtetuese.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 17 të Raportit të Auditimit)*
**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të sigurojë regjistrimin e të gjitha transaksioneve financiare në kohë dhe me saktësi, për të siguruar kronologjinë dhe gjurmët e veprimeve ekonomike në informacionin financiar të raportuar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e bërë për saktësinë e paraqitjes së llogarisë 31 "Materiale" rezultoi se në mbyllje të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar në vlerën 61,469 lekë, krahasuar me periudhën e mëparshme.
-Nga verifikimi dhe kontrolli i dokumentacionit vërtetues (fletëhyrje dhe fletëdalje) rezultoi se, në mbyllje të vitit 2022 gjendja kontabël e llogarisë 31 "Materiale" paraqitet në vlerën 560,187 lekë, vlerë e cila rakordoi me gjendjen fizike të materialeve gjendje në magazinë, bazuar në kontrollin e ushtruar në magazinën e institucionit, dhe se kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar në bilanc.
-Nuk ka akt akordim në fund të çdo muaji/viti të mbajtur midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës për gjendjen për çdo zë të këtyre aktiveve, duke ndikuar kështu në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar të klasës 3, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 pika 52, 53.
-Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese në lidhje me këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikat që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimin e tyre, ashtu siç përcaktohet në SKK 4 (Inventarët). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 18-19 të Raportit të Auditimit)*
**4.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për të evidentuar gjendjen reale të llogarisë 31 "Materiale" dhe llogarisë 32 "Inventari i imët" dhe të reflektojë këtë vlerë në kontabilitet nëpërmjet veprimeve korrigjuese.

***Menjëherë***

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" del se, në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 është 0 lekë. Nga verifikimi i bërë dhe nga analizimi e kësaj llogarie rezulton se në mbyllje të bilancit vjetor 2020 është 83,180 lekë dhe paraqet detyrimin e dëmit ekonomik lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018 dhe i përket 2 ish punonjësve (2x 41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para periudhës 2018 dhe konfirmohet se janë detyrime të pa likuiduara edhe gjatë periudhës së auditimit. Si rrjedhim vlera e detyrimit nga të tretët rezulton e hequr padrejtësisht nga kontabiliteti i njësisë dhe duhet pasqyruar në periudhën në vijim. Veprimi *në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 19-20 të Raportit të Auditimit)*
**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të ri paraqesë në llog.468 "Debitorë të ndryshëm" vlerën 83,180 lekë, e cila nuk është paraqitur në pasqyrat financiare të viteve 2021-2022 dhe të marrë masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës.

***Menjëherë***

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 212 "Ndërtime konstruksione" rezultoi se, përbëhet nga vlera e 5 godinave në kosto historike në total për 9,512,610 lekë marrë nga ISHMPUT Fier nga procesi i ristrukturimit sipas Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së "Kalim në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM" dhe se nuk është pasqyruar realisht vlera e aktiveve në pronësi të subjektit pasi:
a) Në gjendjen e llogarisë 212 "Ndërtime e konstruksione" përfshihen tre godina në kosto historike vlerë 5,652,686 lekë, të cilat duhet t'i kishin kaluar IKMT-së, në zbatim të Urdhrit

Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së. Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër janë bërë kërkesa për kalimin e 3 godinave, referuar Urdhrit të Ministrit të MTM-së, por nuk është sqaruar përfundimisht.

Nga ana e Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk është insistuar më për sqarimin me ministrinë përgjegjëse nga ajo varet, me MTM, në lidhje me zbatimin e Urdhrit të Ministrit të MTM-së Nr.54 datë 24.02.2020, në mosrespektimin me UMF nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, Kreu (II), pika (16): Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik pika 16.*

b) Nga verifikimi i titujve të pronësisë të këtyre aktiveve, rezultoi se nuk ka certifikata për vërtetim pronësie e për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK).*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 21-22 të Raportit të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të saktësojë dhe kalojë në pronësi të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, tre godina me kosto historike në vlerën 5,652,686 lekë, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, duke bërë dhe sistemimin kontabël të kësaj vlere në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione".

**6.2.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të ngrejë grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi e në përdorim dhe të realizojë regjistrimin e pronave në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

***Menjëherë***

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e vlerës së Llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" rezulton se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv pasi: -Vlera kontabël e këtij zëri në aktiv të bilancit paraqitet më pak në total në shumën 50,969 lekë, diferencë që vjen nga paraqitja gabim në çelje në kosto historike e vlerës së këtij zëri (paraqitur më shumë për 110,304 lekë) në Formatin 7/b, "Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Vlerë neto)", krahasuar me paraqitjen e tij në Formatin 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Kosto historike)" dhe e përdorimit gabim të normës së amortizimit (në shumën 161,273 lekë), gjë e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" pika 36. E analizuar sipas tabelës nr.4.

- Nuk është llogaritur amortizimi (11,030 lekë) për shtesat e vitit 2022 me vlerë 110,304 lekë, marrë aktive pa pagesë nga transferimet e brendshme, me Urdhër të brendshëm nr.155, datë 12.07.2022 të Drejtorit të përgjithshëm të AKM-së.

-Një pjesë e aktiveve të regjistruar në këtë llogari janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë, të cilat duhet të kalojnë në llogarinë 218 "Inventar ekonomik", pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është përllogaritur drejt me normën 25 % dhe jo 20%, duke mos iu referuar kështu nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik (sipas tabelës anekse nr.5 të RPA). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 22-23 të Raportit të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për ri paraqitjen e saktë të llogarisë 214 *"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* dhe të bëhet korrigjimi në klasifikimin e zërave me kosto historike 1,399,746 lekë e cila duhet të paraqitet në llog. ek. 218 "Inventar ekonomik".

***Menjëherë***

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e vlerës së llogarisë 215 "Mjete Transporti" rezultoi se, në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë e aktivit për automjetin i kaluar tek Administrata

e Zonave të Mbrojtura Divjakë, në mos respektim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Në llogarinë 215 "Mjete transporti" nuk është shtuar vlera (për pjesë këmbimi-motor për automjetin A...S), që rezulton nga shërbimi i përgjithshëm i kryer në vitin 2021, në shumën 362,400 lekë, sipas Faturës tatimore nr.33 datë 19.08.2021 dhe Fletëhyrjes nr.10 datë 19.08.2022, në kundërshtim me SKK Nr. 5 – Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale - Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja, paragrafi 4 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2019 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, "Aktivet afatgjata", përbërja dhe trajtimi kontabël, gërma *"b". ".(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 24-25 të Raportit të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për saktësimin e procedurës ligjore të automjetit me targë T...H tip Land Rover defender, që ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe të bëhet sistemimi kontabël në llogarinë 215 "Mjete Transporti".

***Menjëherë***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i vlerës së llogarisë 218 "Inventar ekonomik" rezulton të jetë paraqitur me vlerë më pak për 110,304 lekë.
-Pakësimet në vlerën 241,920 lekë të cilat janë ç'regjistruar nga kontabiliteti, më parë se nga data e bërjes dalje të këtij aktivi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 32; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 39.
-Nga llogaria 218 "Inventar ekonomik" janë transferuar (pa pagesë) aktive në shumën 769,424 lekë tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, të cilat sipas listës rezultojnë në kontabilitetin e njësisë, nuk janë bërë dalje, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, në kundërshtim me pikat 34, 39,43,55.
-Një pjesë të aktiveve të regjistruar në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë të cilat janë përllogaritur drejt me 25%, por jo në llogarinë 218 "inventar ekonomik". Gjithashtu në këtë zë të aktivit rezultojnë pajisje kompjuterike në vlerën prej 3,328,098 lekë, për të cilat nuk është zbatuar norma e amortizimit 25%, por janë llogaritur në grup me 20%, në mosrespektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2. faqet 25-27 të Raportit të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për ri paraqitjen e saktë të llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*".

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër,në 5 raste u konstatuan pa rregulluesi në sistemin E-inspektim, në dokumentacionin bashkëlidhur, konkretisht:
-2 subjekte mungon plani i rehabilitimit,
-1 rast raportet e vet monitorimit/monitorimit vjetor,
-2 raste dokumentacioni bashkëlidhur pa nr. protokolli pranë AKM-së, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" Seksioni 2 Neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me Ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4,2. faqet 57-58- të Raportit të Auditimit).*

**<u>10.1. Rekomandimi:</u>** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, Sektori i Mjedisit të hartojë programe inspektimi për subjektet që nuk kanë paraqitur dokumentacionin bashkëlidhur në sistem dhe në rast mosplotësimi të marrë masa administrative me gjobë ndaj subjekteve.

***Menjëherë***

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Sektorin e Mjedisit u konstatua se në 6 subjekte, nga të cilat 4 subjekte te për nxjerrjen e mineraleve, rërës argjilës nga karrierat në qiell të hapur dhe nga guroret si dhe 2 subjekte me veprimtari të ndryshme, inspektorët në procesverbal kanë cituar se: "subjekti u gjend i mbyllur", ose nuk kryen aktivitet, Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit,

- Nuk ka verifikime të dokumentuara ne sistemin e QKB-së,

-Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe me institucione të tjera. Veprime jo në përmbushje të Nenit 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d"; me Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" Seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Nenin 45-48; Nenin 11 "Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi" të Ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011"Për Mbrojtjen e Mjedisit". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2, faqe nr.60-62, të Raportit të Auditimit).*

**<u>11.1. Rekomandimi:</u>** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB me qëllim që të hartojnë dhe nxjerrjen e autorizimeve për kryerjen e inspektimeve ndaj subjekteve, nëse janë aktiv si subjekte ose, në të kundërt të merren masa administrative (gjobë) sipas legjislacionit në fuqi.

***Menjëherë***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, për 3 subjekte nuk janë hartuar vendimet përfundimtare sipas procesverbaleve të shkeljeve të konstatuar, në kundërshtim me Ligjit NR.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar si dhe Nenin 23 të Ligjit nr. 9115/2003 ''Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të ndotur'' Neni 42-46 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.66-67 të Raportit të Auditimit).*

**<u>12.1. Rekomandimi:</u>** Sektori i inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) për shkeljet e konstatuara të hartojnë vendimet përfundimtare për subjektet: K. me Nipt K...A; A.Me. me Nipt L...B; L.K. me Nipt L...G, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

***Menjëherë***

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Mjedisit, në 6 raste ndaj subjekteve me veprimtari të ndryshme ka dhënë masa administrative me dënim kryesore *Paralajmërim*, për mosparaqitje dhe zbatim të kushtit 3.29. Monitorimi, për Vlerësim me Ndikim në Mjedis NM pranë AKM-së, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.61 të Raportit të Auditimit).*

**<u>13.1.Rekomandimi:</u>**Sektori Mjedisit të planifikojë inspektime për zbatimin e detyrave të lëna për plotësimin e kushteve të lejes mjedisore, për subjektet: Hotel S. Nipt K..O; I. Nipt J.D; L. Nipt K..K; M. K. Nipt L..E; B.L. Nipt K..L; A. M.. Nipt K..U**.**

***Menjëherë***

**14. Gjetje nga auditimi:** Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të gjitha mangësitë e konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton

kushtet e lejes mjedisore, konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në plotësim të dokumentacionit, si dhe kryerjen e dërgimin e vet monitorimeve, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe 56-59 të Raportit të Auditimit).*

**<u>14.1. Rekomandimi:</u>** Inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të marrë masa që në çdo inspektim të kryer në terren të plotësojnë sipas formatit procesverbalin e inspektimit, mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore.

***Menjëherë***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore (Ujëra) nuk ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna**.** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2,4, faqe 62-64 të Raportit të Auditimit).*

**<u>15.1. Rekomandimi:</u>** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier Vlorë Gjirokastër, te marri masa që në çdo fund muaji të hartojnë dhe të paraqesin periodikisht pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, me qëllim miratimin e planeve mujore për verifikimin e detyrave të lëna**.** ***Menjëherë***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nga inspektorët nuk janë plotësuar në çdo rast listë verifikimet sipas nenit 39,41, të Ligjit nr.10433 dt.16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe Ligjit nr.52/2020 "Për Lejet e Mjedisit " shtojca 4.1 etj...sipas aktiviteteve që kryejnë subjektet. *Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe. 62-64 të Raportit të Auditimit).*

**<u>16.1. Rekomandimi:</u>** Inspektorët e Sektorit të Mjedisit dhe Sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra) të marrin masa që në çdo inspektim të plotësojnë të gjitha rubrikat që përmban listë-verifikimi për identifikimin e veprimtarisë që kryen subjekti sipas ligjit të sipërcituar.

***Menjëherë***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut. në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2, nenet 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit". Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën e inspektimit gjatë një vetitë subjekteve që do të inspektohen (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2.faqe nr. 63-66 të Raportit të Auditimit).*

**<u>17.1.Rekomandimi:</u>** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim me sektorin e Mjedisit dhe të sektorit të Burimeve Natyrore Ujëra, të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt në sistem, e-Inspektimit.

***Menjëherë***

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektori i Burimeve Natyrore (Ujëra) u konstatua se:
-Në 5 subjekte nuk janë kryer inspektimet për asrsye pengimi nga subjekti i inspektuar
-Në 3 subjekte nuk është finalizuar me marrje e masës për mbyllje të aktiviteti, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 "Për Trajtimin Mjedisor të (Ujëra) të ndotura", Neni 23, ç; Ligji 111/2012, datë 11/15/2012,"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, Nenit 97 pika 1

Shkarkimi në mjedis i Ujërave të përdorura. (*Më hollësisht trajtuar në pikën,4.2. faqe nr.67-67 të Raportit të Auditimit).*

**<u>18.1.Rekomandimi:</u>** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Natyrore të inspektojnë 5 subjektet për të cilat janë marrë masa administrative (gjobë) për pengim të inspektimit si dhe të njoftojnë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Tabela me subjekte e e penguara ne inspektim

| Nr | Emri i subjektit | Aktiviteti | Vlera e gjobës 000/në lekë | Nr.Seri sipas Proc.Verb. të dënimit me gjobë | Data e Vendimit të dënimit me gjobë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | D. F. | Prodhim dhe tregtim të materialeve inerte | 10,000 | AKM-FR-2021-000057 | 30/06/2021 |
| 2 | T.A. | Mbarështimi i kafshëve në fermat | 100,000 | AKM-FR-2021-000045 | 09/06/2021 |
| 3 | E. | Ndërtim dhe rikonstruksion | 10,000 | AKM-FR-2021-000061 | 21/06/2021 |
| 4 | K.K. | Akuakultur | 100,000 | AKM-FR-2021-000146- | 18.10.2021 |
| 5 | M. E. | Hec | 100,000 | AKM-FR-2021-000146- | 13.08.2021 |

***Menjëherë***

**19.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, në sistemin E-inspektim on-line mungon dokumentacion i duhur ligjore për 33 subjekte të konstatuara me shkelje, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 "Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotura", datë 07.04.2003, Ligjin Nr.111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" 30 "Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.67-70 të Raportit të Auditimit).*

**<u>19.1.Rekomandimi:</u>**Drejtori i Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra) të nxjerrë autorizimet për inspektimin 33 subjekteve të trajtura në Raport, të cilat nuk kanë dokumentacionin e plotë ligjorë në sistemin E-inspektimit .

***Menjëherë***

**20.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nga Sektori i mjedisit dhe Burimeve Natyrore Ujërat në 19 subjekte të inspektuara, nuk ushtrojnë aktivitet, dhe se në sistemin online nuk është hedhur dokumentacioni informues dhe vërtetues, si rezultatet të marra nga QKB statusi (foto) etj., këto veprime bien në kundërshtim me Nenin 36-*Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d" të* Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*" Seksioni 2 Neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me Ligjin Nr.10433 datë 16.06.2011"*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*". Neni 42-46, *Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr. 70-72 të Raportit të Auditimit).*

**<u>20.1.Rekomandimi</u>:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të verifikojnë statusin e subjekteve që inspektohen në QKB si dhe në Degët Rajonale të Tatimeve, përpara hartimit të planeve të punës dhe në rastet kur ato nuk ushtrojnë aktivitet t'i përcillen Agjencisë Kombëtarë së Mjedisit, për heqje të lejeve mjedisore.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**21.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë Gjirokastër, rezultoi se kemi të bëjmë me konflikt interesi të punonjësit A.Q. pranë Agjencinë Rajonale të Mjediset Fier, Vlorë, Gjirokastër, Sektori i Burimeve Natyrore (Ujëra), veprime që bien në kundërshtim me Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005"Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" *Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm nr.28, datë 17.04.2014" Për miratimin e kodit të etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë",* pika 6.3-6.5-6.8-6.9*;* Ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil ", me nenin 46, pika 1-Rregullores së Brendshme nr.120, datë 12.01.2021, Neni 29 pika f), (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.73-74 të Raportit të Auditimit).*

**<u>21.1.Rekomandimi:</u>** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, në bashkëpunim

me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të largojë nga puna inspektorin z. A. Q. për konfliktin e interesit në punë dhe të njoftojë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Institucionin e Parandalimit dhe Konfliktit të Interesit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

***Menjëherë***

**22.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për dhënien e mendimit të VNM-ve paraprake/të thelluar u konstatua se mendimi dërgohet elektronikisht nga specialisti në adresën e drejtuesit të institucionit për t'u nënshkruar elektronikisht dhe për t'u ngarkuar më tej në sistemin E-Leje. Si pasojë e sulmit kibernetik të ndodhur në Shqipëri në muajin korrik 2022, çdo korrespondencë në formë elektronike (specialistë-titullar institucioni) para kësaj periudhe është fshirë (konfirmuar me e-mail nga 20 shkurt 2024), veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike", Neni 17/b. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.36-38 të Raportit të Auditimit).*

**22.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër , të marrë masa që specialistët e lejeve mjedisore të aplikojnë në sistemin e-albania, për tu pajisur me nënshkrim elektronik, me qëllim plotësimin e strukturës së dokumentit elektronik.

**23.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 43 praktikave për leje mjedisi Tipi A/B, janë dhënë mendime pozitive nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të përcjella Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe pse rezultojnë me mangësi në dokumentacion.
-Gjithashtu për 17 aplikime është tejkaluar afati 10 ditor për dhënien e mendimit, veprime në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" , Kreu III, pika 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.38-52 të Raportit të Auditimit).*

**23.1.Rekomandimi:** Sektori i Lejeve pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të rishqyrtojë dokumentacionin për dhënie mendimi Leje Mjedisore të Tipit A/B, për 43 rastet e trajtuara në Raport, në respektim të kritereve dhe afateve të legjislacionit në fuqi dhe në përfundim të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**24.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për periudhën janar 2021- dhjetor 2023 ka dhënë mendime për VNM paraprake/ të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B, duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk ka marrë informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, veprime në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr. 120 prot., datë 12.01.2021, kreu II.V pika 9 , faqe 45-56. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.39-47 të Raportit të Auditimit).*

**24.1.Rekomandimi**: Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të kërkojë informacione periodike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për vendimet e marra për VNM paraprake/të thelluar të Tipit A/B dhe të bëjë përditësimin e tyre në Regjistrin elektronik të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**25.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 32 raste raportet e posaçëm (procesverbali) nga ana e specialistëve të ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastër, nuk është mbajtur në ditën që është zhvilluar dëgjesa më publikun, por është dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit , pas 10-20 ditësh nga zhvillimi i procedurës, veprime në kundërshtim me Rregulloren nr.1, datë 03.03.2017 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "Për zbatimin e procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" pika 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.57-60 të Raportit të Auditimit).*

**25.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, të marrë masat për respektimin e afateve kohore, në përgatitjen e raportit të dëgjesës me publikun.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore u konstatua se, për asnjë vit të periudhës audituese nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastër, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr.32-39 të Raportit të Auditimit).*

**26.1.Rekomandimi:** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fi34er, Vlorë, Gjirokastër në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim më përgjegjësin e Sektorit të Shërbimit dhe Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, dhe paraqitjen e saktë të tyre në pasqyrat financiare të njësisë. Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrit të aktiveve të institucionit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**27.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, mbi rregullshmërinë e veprimeve në magazinë rezultoi se: detyra e magazinierit prej krijimit të njësisë e në vazhdim me urdhër të titullarit të njësisë i është deleguar 4 punonjësve me pozicion specialistë në Sektorin e Monitorimit dhe Lejeve, në moszbatim me Rregulloren Nr.120 prot.,datë 12.01.2021", pika 4,13 ku përcakton qartë se detyra e magazinierit është përfshirë në detyrat funksionale të specialistit të Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivë-Magazinë.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave hyrje-dalje në magazinë rezultoi se gjendja fizike në mbyllje të vitit 2022 paraqitej në vlerën 560,187 lekë, e cila rakordon me gjendjen kontabël (të bërë sipas fletëhyrje-fletëdalje të vitit 2022) dhe nuk rezulton e pasqyruar në bilanc, veprime në kundërshtim UMF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" pika 30. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.82-84 të Raportit të Auditimit).*

**27.1.Rekomandimi:** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, të ngarkojë me detyrën e magazinierit specialistin e Burimeve Njerëzore ose të Protokoll-Arkiv si dhe dokumentimi i hyrjeve-daljeve në magazinë të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të kontabilitetit në menaxhimin e aktiveve.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**28.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i të dhënave, në lidhje me strukturën e miratuar sipas Urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*", Rregullores *nr.120 prot, datë 12.01.2021,* rezulton se:Në fund të vitit 2021, struktura paraqitet me realizim në masën 87,5% dhe numri i vendeve të lira 6**;** në fund të vitit 2022, struktura paraqitet me realizim në masën 75% dhe numri i vendeve të lira 12**;** në fund të vitit 2023 struktura paraqitet me realizim në masën 69% dhe numri i vendeve të lira 15, pra kjo drejtori ka vepruar vetëm me rreth 77% të kapacitetit të saj, duke sjell ulje të efektivitetit dhe eficencës në punë për njësinë.

**b)** Në lidhje me auditimin e ushtruar për plotësimin e dosjeve të personelit, u përzgjodhën 15 dosje ku rezultoi se dosjet e personelit nuk kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit" *II.* Dosja e personelit.-Nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen sipas inventarit si edhe mënyrës së mbajtjes pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

-Për punonjësit e larguar mungonte akti i dorëzimit të dokumentacionit dhe punës përpara largimit.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.85-89 të Raportit të Auditimit).*

**28.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrin masa për plotësimin e vendeve të lira të punës si dhe specialisti i burimeve njerëzore, të plotësojë mangësitë e dosjeve të personelit.

***Në vijimësi***

**29.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë e listë prezencave, si dhe i përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë rezultuan parregullsi në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse, si më poshtë**:**

-Për vitin 2021, 2022 listë prezencat nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit përkatës, ndërsa për vitin 2023 janë nënshkruar korrekt nga përgjegjësi i sektorit përkatës. Përmbledhësja e listë pagesave gjithashtu nuk është nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, duke shkelur përcaktimet e pikës 69 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.20211, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

**-**Llogaritja e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar me raport mjekësor deri në 14 ditë, në disa raste nuk është bërë me 80% , sipas nenit nr.130 pika 1 të Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenit 25, të ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993, të ndryshuar.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 , faqe nr.85-87 të Raportit të Auditimit).*

**<u>29.1.Rekomandimi:</u>** Sektori i Financës të përllogarisë saktë përfitimet për paaftësi të përkohshme në punë, për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar kjo me raport mjekësor deri në 14 ditë, në çdo rast.

***Në vijimësi***

**30.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 14 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në 13 prej tyre, të realizuara në rrugë shkresore kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion:

-në 6 raste mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim, ndërsa në 7 raste të tjera procesverbalet përkatëse nuk janë të nënshkruara, nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, kjo në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.*2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 43,47,54.*

Si edhe 1 procedurë e prokurimit publik e realizuar në sistemin elektronik rezultoi se kriteret e përgjithshme dhe specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 162/2020 *"Për prokurimin publik"* si dhe të VKM-së nr.285 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".

**<u>30.1.Rekomandimi:</u>** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër, të ngrejë grup pune për analizimin e 14 rasteve në shkelje të proceduarve të prokurimit me blerje të vogël, nëpërmjet rivlerësimit të dokumentacionit, për të siguruar në vijueshmëri përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret në fuqi dhe të propozoj masa konkrete për anëtarët e komisionit të prokurimit.

**<u>30.2.Rekomandimi:</u>**Titullari i Institucionit të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve që zhvillon ASPA, me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit për hartimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave konform rregullave të prokurimit publik.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 gërma (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nga Titullari i Institucionit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, sipas rasteve. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të bëjë sistemimet e veprimeve ekonomike për detyrimet e dëmit në *vlerën 860,524* lekë**,** e cila vjen nga**:**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve me bankë kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi të kuadrit ligjor përkatësisht, si më poshtë**:**

**1**. Në shumën e përllogaritjeve për pagën e z. M. H., rezulton se është paguar 16,398 lekë më shumë se sa duhet. Kjo diferencë duhet të rikthehet në llogarinë e institucionit, në mosrespektim me Udhëzimin Nr. 1 datë 21.05.2021 "Për formën, elementët dhe plotësimin e liste pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" pika 13.

**2.** Në periudhën 2021-2023, janë likuiduar gjoba në shumën e 80,000 lekë (16x5,000 lekë) për deklarim të vonuar të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik i tatimeve. Shuma prej 80,000 lekë ka rënduar padrejtësisht buxhetin e institucionit, pasi vjen si rezultat i neglizhencës së NZ dhe duhet të kthehet në llogarinë e institucionit, veprim ky në kundërshtim me Nenin 35 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. (sipas tabelës anekse nr.36).

3. Janë likuiduar detyrime të prapambetura për energji elektrike për periudhën 2020-2023 në shumën 614,107 lekë, nga e cila shuma prej 139,532 lekë rezulton kamatë vonesë. Likuidimi i tyre është rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve ligjore për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, siç parashikohet në pikën 151 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", dhe në Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", pika 3, Shuma e kamatës 139,532 lekë, konsiderohet dëm dhe duhet kthyer në llogarinë e institucionit, përgjegjësi e së cilës janë drejtori aktual, z. D. V. dhe përgjegjësi e financës, z. P. T..

4. Janë likuiduar detyrime për marrje ambienti me qira në shumën 66,000 lekë (56,600 lekë detyrim+9,900 lekë Tatim i mbajtur në burim) sipas Kontratës së qirasë nr.1036 prot., datë 28.07.2020 për një ambient, mjedis pune në Gjirokastër, e cila nuk përmbush elementët ligjorë të një kontrate të vlefshme, pasi nuk është nënshkruar nga pala qiradhënëse, në kushte të mosrespektimit të nenit 801 të Kodit Civil. Gjithashtu likuiduar edhe tatimi i mbajtur në burim, ndërsa neni 11 i kontratës e përcakton si detyrim të palës qiradhënëse. Nuk konfirmohet të jetë lidhur kontratë tjetër pas kësaj dhe pagesa nga sektori i financës ka vazhduar deri në vitin 2021. *(*sipas tabelës anekse nr.37).

5.Janë paguar shpenzime udhëtimi në shumën 137,800 lekë si pasojë e mënyrës së llogaritjes gabim dhe mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (pa akt kontroll/procesverbal konstatimi), në kundërshtim me Nenin 4, pika 26 e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, (sipas tabelës anekse nr.39).(*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.88-89 të Raportit të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të arkëtojë detyrimet për z. M. H. në vlerën 16,398 lekë; z. P. T. në vlerën 215,766 lekë; z. D. V. në shumën 69,766 lekë dhe vlerën prej 137,800 lekë (19 persona sipas tabelës anekse) të cilat në total arrijnë në vlerën prej 439,730 lekë.

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për furnizimin me karburant në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për periudhat 2021-2022 rezultuan parregullsi si më poshtë:

-Mungesë e dokumentacionit të plotë vërtetues dhe të rregullt (fletëhyrje dhe fletëdalje) si dhe të pashoqëruara me dokumente justifikuese, në kundërshtim me kërkesat ligjore në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësite sektorit Publik", i ndryshuar, pikat 37,38.

-Për vitin 2022, sasia 1,772 litra karburant (naftë), në vlerë 420,794 lekë, është e pajustifikuar me dokumentacion vërtetues, fletë udhëtim, veprime në kundërshtim me pikën 36 të UMFE nr.

30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public, duke shkaktuar dëm financiar dhe duhet kthyer në buxhetin e shtetit.(sipas tabelës Anekse nr. 43), (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.89-92 të Raportit të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër të arkëtojë shumën në total 420,794 lekë për përdorim të karburantit (naftë), e pajustifikuar me dokumentacion vërtetues, fletudhëtim, nga z. D. V. në cilësinë NA, z. P. T. në cilësinë NZ dhe z. B. D. me detyrë shofer në strukturën organizative.

***Menjëherë***

# V. ANEKSE

Tabelë nr. 5 Pajisje kompjuterike, përfshirë gabim në llog.214 që duhet të kalojnë në llog.218, lekë

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Çmimi | Sipas të dhënave kontabël | | Sipas të dhënave të inventarit | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sasia | Vlera | Sasia | Vlera |
| 1 | Printer skaner 2 | copë | 27,840 | 1 | 27,840 | 1 | 27,840 |
| 2 | Printer | copë | 17,550 | 1 | 17,550 | 1 | 17,550 |
| 3 | Printer + skaner | copë | 23,934 | 1 | 23,934 | 1 | 23,934 |
| 4 | Kompjuter hp 400pc | copë | 94,461 | 1 | 94,461 | 1 | 94,461 |
| 5 | Kompjuter hp pc | copë | 61,600 | 1 | 61,600 | 1 | 61,600 |
| 6 | Kompjuter kompakt | copë | 65,424 | 2 | 130,848 | 2 | 130,848 |
| 7 | Kompjuter kompakt | copë | 151,000 | 1 | 151,000 | 1 | 151,000 |
| 8 | Printer | copë | 42,561 | 1 | 42,561 | 1 | 42,561 |
| 9 | Faks printer | copë | 22,029 | 1 | 22,029 | 1 | 22,029 |
| 10 | Kompjuter | copë | 66,590 | 2 | 133,180 | 2 | 133,180 |
| 11 | Kompjuter HP pc printer | copë | 231,581 | 3 | 694,743 | 3 | 694,743 |
| | **TOTALI** | | | | | | **1,399,746** |

Tabelë nr. 8 Pajisje kompjuterike që janë në përbërje të llog.218 “Inventar Ekonomik” lekë

| Nr | Emërtimi | Njësia | Çmimi | Sipas te dhënave kontabël | | Sipas te dhënave te inventarit | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Sasia | Vlera | Sasia | Vlera |
| 1 | Laptop Probook 6470 | cope | 154,370 | 4 | 617,480 | 4 | 617,480 |
| 2 | Printer Hp office | cope | 62,971 | 4 | 251,884 | 4 | 251,884 |
| 6 | Pershtates printeri | cope | 2,000 | 1 | 2,000 | 1 | 2,000 |
| 7 | Kompjuter | cope | 120,000 | 1 | 120,000 | 1 | 120,000 |
| 8 | Printer.Skaner.Fotokopje | cope | 22,000 | 1 | 22,000 | 1 | 22,000 |
| 9 | Fujitsu kompjuter | cope | 99,000 | 1 | 99,000 | 1 | 99,000 |
| 11 | UPS trust | cope | 17,000 | 1 | 17,000 | 1 | 17,000 |
| 12 | Njesi kompjuteri | cope | 84,000 | 1 | 84,000 | 1 | 84,000 |
| 13 | Monitor crt-17 | cope | 19,000 | 1 | 19,000 | 1 | 19,000 |
| 14 | Printer scaner fotokopje | cope | 20,000 | 1 | 20,000 | 1 | 20,000 |
| 16 | Komjuter Pc acer Laxret | cope | 65,424 | 2 | 130,848 | 2 | 130,848 |
| 17 | Kompjuter Hp 400 PD | cope | 75,426 | 1 | 75,426 | 1 | 75,426 |
| 18 | Monitor Hp ë 1972 a | cope | 19,035 | 1 | 19,035 | 1 | 19,035 |
| 19 | Printer | cope | 11,280 | 1 | 11,280 | 1 | 11,280 |
| 20 | Printer scaner fotokopje | cope | 16,848 | 1 | 16,848 | 1 | 16,848 |
| 21 | Printer Samsung 1665 | cope | 12,000 | 1 | 12,000 | 1 | 12,000 |
| 22 | Printer Samsung 1660 | cope | 12,000 | 1 | 12,000 | 1 | 12,000 |
| 23 | Printer skaner Laxret | cope | 27,840 | 1 | 27,840 | 1 | 27,840 |
| 24 | Kompjuter Hp 400Pd | cope | 75,260 | 1 | 75,260 | 1 | 75,260 |
| 25 | Monitor HPË 1972 a | cope | 19,035 | 1 | 19,035 | 1 | 19,035 |
| 26 | Printer | cope | 11,280 | 1 | 11,280 | 1 | 11,280 |
| 27 | Scaner Hp Lazerjet | cope | 12,645 | 1 | 12,645 | 1 | 12,645 |
| 28 | Kompjuter Hp 300 | cope | 106,604 | 1 | 106,604 | 1 | 106,604 |
| 29 | Printer Lexmark | cope | 26,347 | 1 | 26,347 | 1 | 26,347 |
| 30 | Printer skaner 204A | cope | 27,840 | 1 | 27,840 | 1 | 27,840 |
| 31 | Kompjuter Pc ACER | cope | 98,136 | 1 | 98,136 | 1 | 98,136 |
| 32 | UPS | cope | 12,000 | 1 | 12,000 | 1 | 12,000 |
| 34 | Stori Hard disk | cope | 14,756 | 1 | 14,756 | 1 | 14,756 |
| 35 | U.P.S 600 VA | cope | 13,500 | 1 | 13,500 | 1 | 13,500 |
| 36 | U s.p Triple 750 | cope | 8,004 | 2 | 16,008 | 2 | 16,008 |
| 37 | H.P.D.V.2203A MONITOR | cope | 132,852 | 1 | 132,852 | 1 | 132,852 |
| 38 | UP LYE PRINT 1080 | cope | 16,800 | 1 | 16,800 | 1 | 16,800 |
| 39 | U.P.S 12 | cope | 14,760 | 1 | 14,760 | 1 | 14,760 |
| 40 | Laptop Hp | cope | 154,370 | 4 | 617,480 | 4 | 617,480 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 41 | Printer Hp office | cope | 62,971 | 4 | 251,884 | 4 | 251,884 |
| 42 | Kompjuter | cope | 60,750 | 1 | 60,750 | 1 | 60,750 |
| 43 | Kompjuter | cope | 60,750 | 1 | 60,750 | 1 | 60,750 |
| 44 | Printer Lexmark | cope | 12,500 | 1 | 12,500 | 1 | 12,500 |
| 46 | Printer OKI | cope | 46,080 | 1 | 46,080 | 1 | 46,080 |
| 47 | Kompjuter esprimo | cope | 103,680 | 1 | 103,680 | 1 | 103,680 |
| 48 | Printer hp 3420 | cope | 19,510 | 1 | 19,510 | 1 | 19,510 |
| | **TOTALI** | | | | **3,328,098** | | **3,328,098** |

Tabelë nr. 43 Karburant(naftë) i pajustifikuar me Fletë Udhëtime, viti 2022, lekë .

| **Furnizime nga Sistemi Viti 2022** | | | **Justifikuar me FLetëUdhëtimi** | | **Diferenca Sitemi-FletëUdhëtime** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Muaji** | **Sasia** | **Vlerë** | **Sasi Targa T..J** | **Sasi Targa A...S** | **Sasi** | **Vlerë** | |
| Janar | 495 | 90,645 | 202 | 229 | (64) | (11,712) | |
| Shkurt | 366 | 69,956 | 38 | 485 | 157 | 29,987 | |
| Mars | 242 | 55,024 | 168 | 203 | 129 | 29,025 | |
| Prill | 196 | 45,680 | | 255 | 59 | 13,747 | |
| Janar-Prill 2022 | 1,299 | 261,305 | 408 | 1172 | 281 | 61,047 | |
| Maj | 404 | 95,636 | 183 | 285 | 64 | 15,104 | |
| Qershor | 468 | 119,556 | | | (468) | (119,556) | |
| Korrik | 407 | 95,683 | | | (407) | (95,683) | |
| Gusht | 457 | 103,014 | | | (457) | (103,014) | |
| Shtator | 310 | 70,506 | | | (310) | (70,506) | |
| Tetor | 251 | 59,704 | | | (251) | (59,704) | |
| Nentor | 106 | 25,000 | | | (106) | (25,000) | |
| Dhjetor | 118 | 23,482 | | | (118) | (23,482) | |
| Maj-Dhjetor 2022 | 2,903 | 669,115 | 183 | 285 | (2,053) | (481,841) | |
| **Totali 2022** | **4,202** | **930,420** | **591** | **1457** | **(1,772)** | **(420,794)** | |

Burimi: Zyra e Financës ARM Fier/Vlorë/Gjirokastër, përpunuar nga G.A.

Tabelë nr.39 Dëmi ekonomik për shpenzime udhëtime. (lekë).

| **Nr** | **Emër Mbiemër** | **Paguar me dokumentacion financiar të parregullt** |
|---|---|---|
| 1 | E.B. | 11,000 |
| 2 | P. A. | 11,000 |
| 3 | F. Z. | 1,000 |
| 4 | B. F. | 15,000 |
| 5 | P.T. | 2,000 |
| 6 | B. D. | 5,000 |
| 7 | D. V. | 12,000 |
| 8 | E. Z. | 16,500 |
| 9 | V. G. | 1,500 |
| 10 | N. S. | 8,000 |
| 11 | V. Z. | 3,500 |
| 12 | T. Z. | 7,000 |
| 13 | P. V. | 7,000 |
| 14 | A.C. | 5,000 |
| 15 | A. Gj. | 13,800 |
| 16 | M. H. | 9,000 |
| 17 | S. S. | 2,000 |
| 18 | E. D. | 1,500 |
| 19 | E. Sh. | 6,000 |
| | **Totali** | **137,800** |

Burimi: Zyra e Financës ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, përpunuar nga G.A.

Tabelë nr. 38 Pagesa me vonesë ndaj FSHU, për periudhën 2020-2023, lekë

| **Urdhër Shpenzimi** | **TOTALI** | **PRINCIPALI** | **KAMATA** | **Periudha** |
|---|---|---|---|---|
| USH Nr 5, datë 07.01.2022 | 334,815 | 254,484 | 78,030 | viti,2018,2019,2020, 2021 |
| USH Nr 52, datë 14.7.2022 | 92,335 | 52,298 | 39,637 | viti 2021, janar-qershor 2022 |
| USH Nr 86, datë 21.11.2022 | 17,026 | 15,679 | 1,047 | dhjetor 2020, korrik-tetor 2022 |
| USH Nr 7, datë 20.02.2023 | 33,697 | 33,229 | 468 | 11/202; 12/2022; 01/2023 |
| USH Nr 17, datë 27.03.2023 | 11,150 | 8,840 | 2,310 | 01.01.2021-31.12.2021; 01.01.2022-31.12.2022; 01/2023; 02/02/2023 |
| USH Nr 16, datë 27.03.2023 | 11,502 | 9,180 | 2,322 | 01.01.2021-31.12.2021; 01.01.2022-31.12.2022; 01/2023;02/2023 |
| USH Nr 15, datë 27.03.2023 | 31,013 | 19,503 | 11,510 | 05/2019;03.2020-12.2020;01.2021-31.12.2021;01.01.2022-31.12.2022; 01/2023; 02/2023 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| USH Nr 14, datë 27.03.2023 | 17,182 | 17,117 | 65 | 11/2022; 02/2023 |
| USH Nr 69, datë 30.08.2023 | 22,620 | 21,366 | 1,254 | 03.2023-07.2023 |
| USH Nr 91, datë 03.11.2023 | 33,007 | 30,118 | 2,889 | 03.2023-09.2023 |
| SHUMA | **614,107** | **461,814** | **139,532** | |

Burimi: Zyra e Financës ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, përpunuar nga G.A.

Tabelë nr. 36 Gjoba në sistemin e Tatim Taksa viti 2021,2022,2023, lekë

| **Gjobë** | **Data** | **Vlera** | **Lloji i tatimit** |
|---|---|---|---|
| Gjobë | 21.11.2020 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 05.03.2021 | 5,000 | Kontr. Sig. Shoq Shënd. |
| Gjobë | 22.07.2021 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.08.2021 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.09.2021 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.10.2021 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 23.11.2021 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.04.2022 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.05.2022 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.01.2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.03.2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 21.04.2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | 23.05.2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | Dhjetor 2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | Shtator 2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| Gjobë | Gusht 2023 | 5,000 | Tatimi i mbajtur në burim |
| | **Totali** | **80,000** | |

Tabelë nr. 37 Shpenzimet për Pagesë sips Kontartës së Qerasë Nr, 1036, datë 28.07.2020

| **Shpenzim Urdhër** | **Detyrim Qira** | **Tatim i mbajtur në Burim** |
|---|---|---|
| USh nr.39, 02.09.2020 | 18700 | |
| USh nr.41, 04.09.2020 | | 3,300 |
| USh nr. 61, 03.12.2020 | | 3,300 |
| USh nr.60, 07.12.2020 | 18,700 | |
| USh nr.12, 09.02.2021 | 18,700 | |
| USh nr.18, 02.03.2021 | | 3300 |
| **Total 66,000 lekë** | **56,100** | **9,900** |

Burimi: Zyra e Financës ARM Fier,Vlorë,Gjirokastër, përpunuar nga G.A.

# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT